



# **RAPORTI MBI MONITORIMIN E PROCESEVE GJYQËSORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

## **Nga Teoria në Praktikë**

Vlerësimi i Efektivitetit të Reagimit të Gjyqësorit ndaj  
Kriminalitetit të Rëndë të Organizuar dhe Korrupsionit

Periudha e Rishikimit: Korrik 2021 - Mars 2024





Ky publikim është prodhuar nga projekti ekstra-buxhetor **"Projekti Rajonal i Monitorimit të Proceseve Gjyqësore - Luftimi i Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Ballkanin Perëndimor"** në kuadrin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Financuar nga Bashkimi Evropian.

---

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OSBE-së dhe nuk i reflekton domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Për Bashkimin Evropian, emërtimi i Kosovës është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e OKB-së 1244/1999 dhe me Opinionin e GjND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi, pikëpamjet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura këtu janë të autorëve dhe kontribuesve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të OSBE-së dhe shteteve të saj pjesëmarrëse. Megjithatë OSBE-ja ka investuar kujdesin maksimal në zhvillimin e këtij publikimi, ajo nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacionit, udhëzimeve dhe këshillave të dhëna, as për gabime teknike. Për këto arsye, nuk mund të bëhet asnjë pretendim kundër OSBE-së në lidhje me pasojat e mundshme që mund të lindin nga informacioni ose konkluzionet e përfshira në këtë publikim.



**REGIONAL TRIAL MONITORING PROJECT**  
COMBATting ORGANIZED CRIME AND CORRUPTION  
IN THE WESTERN BALKANS

---

AUTORËT:

**Eirini Patsea** (koordinatore e projektit)

**Radu Cotici, Meagan Smith Hrle, Emir Kamenica, Kakhramondzhon**

**Sanginov, Franz Petutschnig** (udhëheqësit e ekipeve të misioneve në terren)

Ekspertët ligjorë që kontribuan:

Francesco de Sanctis, Blerta Ahmeti, Ornela Bela, Sabina Bosovic, Azra Gavrankapetanovic Omerika, Arita Gërxhaliu Rama, Andri Gjini, Adela Gjoshi, Sejla Haracic-Cajlakovic, Blerta Ibërdemaj, Dina Kardovic, Etleva Kelmendi Shabani, Hana Komic, Ljubica Mishevaska, Ksenija Misovic, Alisa Nikezic, Alida Radoncic, Senada Rexha, Nadica Serafimovska, Aleksandar Vanchoski, Elona Xhepa

**[osce.org/westernbalkanstrialmonitoring](https://osce.org/westernbalkanstrialmonitoring)**

Qendra për Parandalimin e Konfliktit, Sekretariati i OSBE-së

Wallnerstrasse 6

A-1010 Vienë, Austri

[pm-cpc@osce.org](mailto:pm-cpc@osce.org)

[osce.org/cpc](https://osce.org/cpc)

# Përmbajtja

## Hyrje

Parathënie.....	5
I. Përmbledhje ekzekutive.....	6
II. Historiku i projektit.....	7
III. Trendet Rajonale.....	14
IV. Rruga para nesh.....	18

## Juridiksionet

V. Shqipëria.....	20
VI. Bosnja dhe Hercegovina.....	44
VII. Kosova* .....	70
VIII. Mali i Zi.....	103
IX. Maqedonia e Veriut.....	134

\*Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë territorit, institucioneve apo popullsisë, duhet të kuptohen në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

# Lista e shkurtesave

DB BiH	Distrikti i Brqkos Bosnje dhe Hercegovinë
GJTHP	Gjykata Themelore Penale në Shkup
BeH	Bosnje dhe Hercegovinë
ZPTHP	Zyra e Prokurorisë Themelore Publike (Maqedonia e Veriut)
KP	Kodi Penal
KKGJE	Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
SMIL	Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (Kosovë)
KPP	Kodi i Procedurës Penale
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
DP FNZ	Drejtoria e Përgjithshme e BE-së për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
FBeH	Federata e Bosnje dhe Hercegovinës
NJIF	Njësia për Intelgjencë Financiare
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor (Shqipëri)
KLJGP BeH	Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Bosnjës dhe Hercegovinës
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë (Shqipëri)
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
ADK	Akademia e Drejtësisë së Kosovës
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
BJN	Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
MD	Ministria e Drejtësisë
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë (Shqipëri)
MNPF	Marrëveshjet e Negociuara për Pranimin e Fajësisë
KOK	Krim i Organizuar dhe Korrupsion
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PFN	Pranimi i Fajësisë i Negociuar
SML	Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve (Mali i Zi)
RS	Republika Serbe
GjSKKO	Gjykatat e Specializuara për Korrupsion dhe Krim të Organizuar (Shqipëri)
MVH	Masat e Veçanta të Hetimit
SPAK	Prokuroria e Specializuar (Shqipëri)
ZPS	Prokuroria Speciale (Mali i Zi)
PSRK	Prokuroria Speciale (Kosovë)
ZPLSH	Zyra e Prokurorisë së Lartë të Shtetit (Mali i Zi)
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
BP	Ballkani Perëndimor

# Parathënie

Projektet e kësaj natyre nuk kanë të bëjnë vetëm me identifikimin e sfidave; ato kanë të bëjnë me krijimin e mënyrave për t'i kapërcyer ato. Ky raport i monitorimit të proceseve gjyqësore në Ballkanin Perëndimor e shënon një moment historik të rëndësishëm në rrugëtim, i mundur me mbështetjen e BE-së si donator i projektit, për të ndihmuar në ndërtimin e sistemeve më të qëndrueshme të drejtësisë penale të cilat mund të reagojnë në mënyrë efektive ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ky raport i nxjerr në pah problemet sistematike që i hasin sistemet gjyqësore në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke filluar nga mungesa e burimeve dhe llogaridhënies, pengesat mund të duken shqetësuese. Në vend që thjesht t'i katalogojë problemet, raporti e përshkruan shtegun për adresimin e tyre përmes analizave të bazuara në prova dhe rekomandime të zbatueshme.


Duke e promovuar transparencën, fuqizimin e kapaciteteve dhe inkurajimin e ndryshimeve, ne mund t'i thyejmë ciklet të cilat e minojnë besimin e publikut dhe sundimin e ligjit. Edhe pse rruga përpara do të jetë sfiduese, pengesat nuk janë të pakapërcyeshme. Prioritetet e përshkruara në këtë raport e ofrojnë një kornizë të fuqishme për progresin, i cili tashmë është në rrugëtim e sipër në të gjitha juridiksionet.

Ne do të dëshironim që ta shprehim vlerësimin tonë



Catherine FEARON

Drejtoreshë në Qendën për Parandalimin e Konfliktit dhe Zëvendës Drejtoreshë e Sekretariatit të OSBE-së



Amb. Brian AGGELER

Shef i Misionit, Misioni në Bosnje dhe Hercegovinë



Amb. Dominique WAAG

Shefe e Misionit, Misioni në Mal të Zi

të thellë për partnerët tanë në Drejtorinë e Përgjithshme të BE-së për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DP FNZ) dhe delegacionet e BE-së në terren për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre në këtë nismë të rëndësishme. Gjithashtu u jemi mirënjohës palëve të interesit nga këshilli gjyqësor dhe ai prokurorial, gjykatave, prokurorive dhe Ministrive të Drejtësisë në të gjitha juridiksionet. Ata janë konsultuar paraprakisht lidhur me gjetjet e raportit, duke ofruar kontekst të çmueshëm dhe duke na ndihmuar të trekëndojmë analizën tonë; ata kanë pranuar shumicën e rekomandimeve, duke i inkorporuar tashmë një numër prej tyre në kornizat e reformave.

Vetëm përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe angazhimit të përbashkët mund të shpresojmë që t'i thyejmë barrierat e drejtësisë. Ky raport është një hap i rëndësishëm në një përpjekje të qëndrueshme të OSBE-së, së bashku me partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë, për ta mbështetur pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Ne e kemi një mundësi për t'i transformuar sistemet e drejtësisë penale, për të krijuar qëndrueshmëri shoqërore ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për ta bërë drejtësinë të paanshme dhe të qasshme për të gjithë qytetarët.

Ne qëndrojmë të vendosur me të gjithë ata që janë të përkushtuar për këtë punë thelbësore.



Amb. Michel TARRAN

Shef i prezencës, Prezenca në Shqipëri



Amb. Michael DAVENPORT

Shef i Misionit, Misioni në Kosovë



Amb. Kilian WAHL

Shef i Misionit, Misioni në Shkup

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Trajtimi efektiv i krimit të rëndë të organizuar dhe i korrupsionit (KOK) është jetik për përmirësimin e sundimit të ligjit. Nevojitet një zbatimi i fuqishëm i një agjende të qëndrueshme të reformës në sektorin e drejtësisë dhe një udhëheqje vendimtare gjyqësore dhe prokuroriale për ta krijuar një histori të besueshme në të gjithë Ballkanin Perëndimor (BP) dhe për t'i përmbushur objektivat kryesore strategjike të juridiksioneve përkatëse.

Komuniteti ndërkombëtar, duke përfshirë Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ka bërë thirrje për përmirësimin e performancës në rastet e KOK dhe i ka identifikuar fushat që kanë nevojë për reforma urgjente. Pavarësisht përkushtimit të gjyqësorit dhe disa retorikave politike të cilat e mbështesin reformën, reagimi i gjyqësorit ndaj KOK në BP ka vend për përmirësime, posaçërisht pasi besimi i publikut tek gjyqësori vazhdon të bjerë, pjesërisht, për shkak të rezultateve jo të mjaftueshme në rastet e KOK.

Ky raport rajonal, i përgatitur nga OSBE "Projekti Rajonal i Monitorimit të Proceseve Gjyqësore - Luftimi i KOK në Ballkanin Perëndimor" ([Projekt<sup>1</sup>](#)), i prezanton gjetjet dhe rekomandimet kryesore për adresimin e çështjeve të identifikuara gjatë monitorimit të proceseve gjyqësore nga korriku 2021 deri në mars 2024. Ai është gjithashtu produkt i konsultimeve me bartësit e funksioneve gjyqësore për raporte jo-publike, specifike për juridiksionin, të cilat janë shkëmbyer me homologët përkatës në nëntor 2023.

Në Kapitullin II, raporti e përshkruan metodologjinë e monitorimit të Projektit dhe të dhënat e mbledhura; në Kapitujt III & IV i prezanton tendencat e përbashkëta në të gjitha juridiksionet lidhur me efektivitetin e reagimit gjyqësorë ndaj KOK dhe rrugën para nesh; dhe në Kapitujt V deri në IX i ngre çështjet në secilin juridiksion dhe jep rekomandime lidhur me to.

<sup>1</sup> <https://www.osce.org/BalkaniPerendimorMonitorimiiProceseveGjyqesore>



## II. HISTORIKU I PROJEKTIT

### Objektivat e projektit

Projekti, i financuar nga Komisioni Evropian (KE) dhe i zbatuar nga OSBE në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut,<sup>2</sup> synon që ta mbështesë një reagim më efektiv të gjyqësorit ndaj KOK në BP, ku KOK i nivelit të lartë është një kërcënim ndaj stabilitetit dhe prosperitetit afatgjatë. Projekti i mbështet këto juridiksione në trajtimin e rasteve të rënda të KOK duke punuar

drejt ngritjes së pavarësisë, cilësisë dhe efikasiteti të sistemeve të tyre gjyqësore. Që nga korriku i vitit 2021, projekti e ka aplikuar monitorimin e proceseve gjyqësore si një mjet diagnostikues shumë planësh dhe sistematik për rastet e ndërlidhura, me synimin kryesorë për krijimin e një kuadri të bazuar në prova për reformën. Tabela më poshtë e ofron një pasqyrë të teorisë së projektit për ndryshim.

<b>NDIKIMI</b>	Besimi i publikut në sistemin gjyqësor		Niveli i ulur i krimit të rëndë të organizuar dhe korrupsionit		
<b>VIZIONI</b>	Një sistem i qëndrueshëm i drejtësisë penale që mund të reagojë në mënyrë efikase dhe efektive ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit				
<b>REZULTATET E SEKTORIT TË DREJTËSISË</b>	GJYKIM I DREJTË në procedurë		EFIKASITET në procedurë		EFEKTIVITET në procedurë
<b>PRODUKTET E SEKTORIT TË DREJTËSISË</b>	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies	Rritja e pavarësisë	Përmirësimi i alokimit të burimeve	Rritja e kapaciteteve & profesionalizmit	Përshtatshmëri më e madhe
<b>SUPOZIMI BAZË</b>	Qartësia e roleve dhe përgjegjësisë në mesin e institucioneve të sektorit të drejtësisë për hartimin e politikave, zbatimin e tyre, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm				
<b>REZULTATET E MONITORIMIT TË GJYKIMEVE</b>	Të ofrohet një kornizë e bazuar në prova për reformën e ardhshme, e cila i përmbush nevojat reale				

**Tabela 1-** Teoria për ndryshim e Projektit Rajonal për Monitorim të Proceseve Gjyqësore


<sup>2</sup> Serbia do t'i bashkohet projektit nga korriku 2024. Ky raport nuk përmbanë asnjë gjetje që ka të bëjë me Serbinë.

# Metodologjia dhe fusha e grumbullimit të të dhënave

## Metodologjia

Metodologjia e projektit, e zhvilluar dhe e përshtatur për projektin nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut (ODIHR) bazuar në Manualin e saj të Monitorimit të Proceseve Gjyqësore dhe duke u mbështetur në përvojën e gjerë të Operacioneve në Terren të OSBE-së lidhur me monitorimin e rasteve të KOK, e përfshin monitorimin e proceseve gjyqësore nga konfirmimi i aktakuzës deri në aktgjykimin përfundimtar dhe detyrues. Rastet janë përzgjedhur në bazë të tre kriterëve kyçe të cilat e pasqyrojnë: 1) peshën e veprës penale, 2) statusin e të akuzuarit dhe 3) nëse rastet e kanë tërhequr vëmendjen e konsiderueshme mediatike. Rastet janë kategorizuar nga e ulëta deri te e larta+, ku me prioritet janë monitoruar rastet e larta dhe të larta+.<sup>3</sup>

Projekti i ka monitoruar seancat dhe i ka analizuar aktet gjyqësore, kryesisht aktakuzat dhe aktgjykimet, në rastet që i



kanë plotësuar këto kriterë përzgjedhjeje. Për ta prodhuar një analizë e cila është e dobishme për peizazhin e politikave lokale dhe e krahasueshme në të gjitha juridiksionet, Projekti e ka miratuar një përkufizim pune të "efektivitetit" në reagimin e gjyqësorit ndaj rasteve të rënda të KOK. Meqenëse nuk ka një përkufizim të pranuar botërisht të efektivitetit gjyqësor në tërësi, ose në fusha të synuara siç është sektori i drejtësisë penale, Projekti e ka përdorur përkufizimin vetanake të efektivitetit, i cili e përkufizon tërë metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe të analizës së tij.

Thelbi i përkufizimit të punës së efektivitetit është si vijon:

**Efektiviteti vlerëson nëse institucionet në fjalë i arrijnë ose jo objektivat të cilat **shoqëria** ua ka përcaktuar atyre.**

<sup>3</sup> E lartë +, sipas Metodologjisë, rezervohet për rastet kur të paktën njëri nga të pandehurit e përfshirë është bartës i rangut të lartë ose është i zgjedhur në poste publike të profilit të lartë. Për shembull, krerët e shteteve ose qeverive, ministra dhe zëvendës ose ndihmësministra; deputetë të parlamentit ose organe të ngjashme legjislative; anëtarët e organeve drejtuese të partive politike; kryetarët e bashkive të kryeqytetit dhe qyteteve të tjera kryesore në secilin vend përfitues të IPA-s; ose zyrtarët më të lartë të njësive federale.

Efektiviteti duhet të trajtohet para së gjithash në lidhje me arsyen e ekzistencës së institucioneve përkatëse të mandatuara për ta reduktuar krimin dhe për të krijuar siguri ligjore. Në të vërtetë, sipas Metodologjisë së Projektit thuhet se “duhet bërë dallimi midis qëllimit të përgjithshëm të sistemit të drejtësisë penale, që është siguri i drejtësisë përmes ndalimit dhe dënimit të fajtorit, mbrojtjes së të pafajshmit dhe të qëllimeve specifike të institucioneve të ndryshme të cilat e përbëjnë sistemin.” Në këtë kuptim, Metodologjia i përfshin edhe

dimensionet thelbësore e edhe ato procedurale të reagimit të gjyqësorit ndaj rasteve të KOK, duke i pas parasysh të drejtat e gjykimit të drejtë, llogaridhënien dhe pavarësinë. Vlerësimi i Metodologjisë shtrihet përtej procedurave në sallën e gjyqit, duke marrë parasysh faktorët e jashtëm si mbulimi mediatik si dhe dizajnin dhe performancën institucionale. Në këtë sfond dhe duke u bazuar në objektivat e projektit, Metodologjia i ka identifikuar katër dimensionet kryesore të mëposhtme për ta vlerësuar reagimin e gjyqësorit ndaj rasteve të KOK:

i. drejtësi

ii. efikasitet

iii. kapacitet/  
performancë

iv. përdorim  
strategjik i  
mjeteve juridike

i. Administrimi i **paanshëm** i drejtësisë, një gur themeli demokratik, është e garantuar si e drejtë e njeriut sipas nenit 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e njohur zakonisht si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) si dhe nga ligjet vendore të cilat e mbrojnë të drejtën për një gjykim të drejtë. Në pajtim me këtë, Projekti vlerëson të drejtën për një gjykim të pavarur dhe të paanshëm, për një seancë dëgjimore publike, të drejtën për tu prezumuar i pafajshëm, për barazinë e palëve dhe për zbatimin uniform dhe të parashikueshëm të ligjeve penale procedurale dhe materiale.

Përveç kësaj, Projekti e ka një qasje më të gjerë ndaj paanshësisë duke i shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë juridike, llogaridhënien dhe transparencën në punën e gjyqësorit.

ii. Sistemet gjyqësore duhet ta zbatojnë drejtësinë në mënyrë **efikase** dhe si pjesë e kërkesës së përgjithshme për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Efikasiteti e rrit besimin e publikut, e garanton sigurinë ligjore dhe të drejtën për një gjykim të paanshëm.<sup>4</sup> Projekti e vlerëson efikasitetin duke e ekzaminuar afatin kohor të procedurave si dhe shpërndarjen efektive të burimeve.

<sup>4</sup> Këshilli i Evropës, Gjyqtarët: Pavarësia, Efikasiteti dhe Përgjegjësitë: Rekomandimi CM/Rec(2010)12 dhe Memorandumi Shpjegues (Strasbourg: Këshilli i Evropës, 17 nëntor 2010), para. 30.

iii. Projekti synon ta vlerësojë profesionalizmin, zellin dhe aftësinë e bartësve të funksioneve gjyqësore, duke u fokusuar në kapacitetin e tyre për t'i ndjekur penalisht dhe për t'i gjykuar rastet në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe të shpejtë.<sup>5</sup> **Kapaciteti** vlerësohet jo vetëm në funksion të performancës së gjykatës, por në mënyrë thelbësore edhe në cilësinë e akteve gjyqësore, duke theksuar arsyetimin koherent dhe bindës si një mbrojtje kundër arbitraritetit. Arsyetimi i mangët, i paqartë ose jo bindës mund të sinjalizojë paaftësi, çështje të kornizës ligjore, mangësi në programet trajnuese të akademisë së drejtësisë ose në shqyrtimet tjera nga ana e gjyqtarit ose prokurorit që mund të derivojnë nga sfidat e pavarësisë së tyre.

iv. Projekti e vlerëson përdorimin e procedurave dhe mjeteve kryesore në trajtimin e rasteve të KOK, duke u fokusuar në sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve. Hetimet financiare e luajnë një rol qendror, së bashku me masat për ngrirjen e asetëve gjatë hetimeve, duke synuar drejtpërdrejt akumulimin e pasurisë – që është nxitësi kryesor i KOK.<sup>6</sup>

Meqenëse monitorimi i proceseve gjyqësore shërben si një *mjet diagnostikues* për identifikimin e simptomave dhe mangësive sistematike, Projekti bënë gjithashtu një sërë vlerësimesh dhe analizash plotësuese të nevojave për t'i kuptuar shkaqet rrënjësore të sfidave të identifikuara.

Këto aktivitete, të cilat e synojnë

vërtetimin e mëtejshëm të gjetjeve, fokusohen në mbledhjen e të dhënave përmes konsultimeve të strukturuar me akterët e sektorit të drejtësisë, përmes takimeve dypalëshe dhe diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta me shumë palë.

### Fusha Metodologjike

Duke e pasur parasysh fokusin e Projektit në identifikimin e çështjeve sistematike, të gjitha produktet analitike – duke e përfshirë këtë Raport – i përcaktojnë tendencat në të gjitha rastet e monitoruara pa i diskutuar apo identifikuar rastet individuale. Për këtë arsye nga ky raport janë hequr të gjitha hollësitë që mund të çojnë në identifikimin e rasteve.

Për më tepër, sipas metodologjisë së tij, projekti i monitoron dhe i analizon rastet pas konfirmimit të aktakuzës. Kjo do të thotë se Projekti nuk ka qasje dhe as nuk i analizon sistematikisht të dhënat nga fazat e hetimit ose nga fazat paraprake. Duke e pasur parasysh këtë fushë, analiza e elementeve të caktuara të trajtimit të rasteve të KOK, si hetimet financiare, bazohet në atë që mund të dallohet nga aktakuza dhe nga gjykimi, si dhe nga konsultimet me palët e interesuara. Përveç kësaj, monitorimi i seancave gjyqësore në përgjithësi e vlerëson tërësinë e procedurave, d.m.th., deri në vendimin përfundimtar dhe detyruet, pasi mangësitë e identifikuara në një fazë të procedurës mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme.

<sup>5</sup> Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e autorëve të Veprave Penal, Udhëzimet lidhur me Rolin e Prokurorëve (Kombet e Bashkuara, 7 shtator 1990, paragrafët 1 dhe 2; Këshilli i Evropës, Rekomandimet për Gjykatësit: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë, paragrafët 59 dhe 65.

<sup>6</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara ndaj Korrupsionit, Neni 31, dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Trans Nacional, Neni 12, bëjnë thirrje për zbatimin e ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

## Aktivitetet kryesore të monitorimit të proceseve gjyqësore në periudhën raportuese

Gjatë periudhës raportuese, korrik 2021 deri në mars 2024, Projekti e ka monitoruar një total prej 264 rastesh në

tërë rajonin me një mesatare prej 52 rastesh të nivelit të lartë dhe të mesëm në secilin juridiksion.

### SHQIPËRIA

- Gjykata e Specializuar e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar
- Gjykata e Specializuar e Apelit për Korrupsion dhe Krim të Organizuar

### BOSNJA DHE HERCEGOVINA

- Gjykata e Bosnjës dhe Hercegovinës
- Gjykata Supreme e Republikës Serbe
- Gjykata e Qarkut në Banja Llukë
- Gjykata Supreme e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës
- Gjykatat Kantonale në Bihaq, Mostar, Sarajevë, Shiroki Brijeg, Tuzla, Zenicë
- Gjykatat Komunale në Bihaq, Cazin, Graçanicë, Sarajevë

### KOSOVA

- Gjykata Supreme e Kosovës
- Gjykata e Apelit e Kosovës
- Gjykatat Themelore në Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Gjilan, Pejë

### MALI I ZI


- Gjykata Themelore në Kotor
- Gjykata e Lartë në Podgoricë
- Gjykata e Apelit e Malit të Zi

### MAQEDONIA E VERIUT


- Gjykata Themelore Penale Shkup
- Gjykata e Apelit Shkup
- Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ilustrimet e mëposhtme e japin një pasqyrë të përgjithshme të llojit të

rasteve që monitorohen, si dhe të fazës procedurale.




**Grafiku 1** - Numri i rasteve të monitoruara nga korriku 2021 deri në mars 2024, të ndara - krimi i organizuar/korrupsioni dhe kriteret e vlerësimit sipas metodologjisë.



**Grafiku 2** - Fazat procedurale të rasteve të monitoruara, të ndara sipas juridiksionit (korrik 2021 deri në mars 2024)

Gjetjet e Projektit i pasqyrojnë të dhënat e mbledhura në seancat dëgjimore të rasteve dhe gjatë shqyrtimit të akteve kryesore gjyqësore

Grafiku i mëposhtëm i ilustron burimet e mbledhjes së të dhënave për rastet e përzgjedhura.



**Grafiku 3** - Ndarja e aktiviteteve të monitorimit të proceseve gjyqësore sipas juridiksionit nga korriku 2021 deri në mars 2024

Siç u cek më lart, Projekti i identifikon çështjet sistematike duke e vlerësuar tërësinë e procedurave. Vlerësimet e tilla synojnë që:

i. T'i identifikojnë ndërvarësitë ndërmjet dështimeve sistematike që manifestohen në aktet kryesore ligjore dhe në faza të ndryshme të procedurës. Vlen të përmendet se dështimet në një fazë të hershme mund të kenë efekte pasuese.

ii. Ta mundësoj zhvillimin e reformës së synuar dhe të qëndrueshme si dhe të ofroj propozime intervenuese

Këto propozime duhet t'i adresojnë shkaqet rrënjësore të çdo problemi, të cilat mund të gjenden në një fazë apo dokument të mëparshëm procedural.

Megjithatë, në kohën e shkrimit, vetëm një numër i kufizuar i rasteve të monitoruara nga Projekti kanë rezultuar me vendim përfundimtar dhe detyrues.

Rastet e reja po shtohen me aq sa e lejojnë burimet. Grafiku 2 e ilustron numrin e rasteve të përfunduara në secilin juridiksion dhe i prezanton disa vëzhgime fillestare mbi rezultatet e këtyre rasteve.

# III. TRENDET RAJONALE

## Sfidat gjithëpërfshirëse institucionale

Monitorimi i proceseve gjyqësore nga ana e Projektit ka identifikuar simptoma të sfidave sistemike në të gjitha juridiksionet në shkallë të ndryshme të cilat nxjerrin në pah çështje që variojnë që nga kapaciteti në nivelin individual deri te kapacitetet në nivelet institucionale, legislative dhe të politikave.

Mbeten sfidat lidhur me drejtësinë, efikasitetin, efektivitetin dhe kapacitetin në trajtimin e rasteve të rënda dhe komplekse të KOK. Shqetësimet vazhdojnë në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e titullarëve dhe institucioneve gjyqësore, kundrejt interesave të akterëve publikë dhe privatë, si dhe praktikat jo konsistente në lidhje me transparencën dhe qasjen në informacion në rastet me interes publik. Procedurat janë disi joefikase, duke përfshirë menaxhimin e rasteve dhe mungesën e disiplinës procedurale. Aktakuzave dhe aktgjykimeve mund të i'u mungojë cilësia dhe konfiskimi i pasurisë mbetet i pashfrytëzuar. Për më tepër, marrëveshjet për pranimin e fajësisë shpesh nuk përdoren në mënyrë strategjike dhe rrallëherë e sigurojnë konfiskimin e përfitimeve të paligjshme. Thënë kështu, ashpërsia e këtyre çështjeve ndryshon në juridiksione të

ndryshme dhe do të diskutohet më në detaje në kapitujt e tyre përkatës. Në këtë seksion, raporti fokusohet në sfidat gjithëpërfshirëse institucionale që duket se i fuqizojnë të gjitha çështjet e tjera të identifikuara në të dhënat e monitorimit të gjykimeve, siç u aludua shkurtimisht më lart. Këto sfida gjithëpërfshirëse nuk manifestohen domosdoshmërisht drejtpërdrejt në seancat dëgjimore ose në aktet gjyqësore, por dalin nga konsultimet me palët kryesore të interesuara në sektorin e drejtësisë, si dhe nga hulumtimi i thelluar i ekspertëve se cilat mund të jenë shkaqet kryesore të problemeve që dalin nga të dhënat e monitorimeve të proceseve gjyqësore.

Këto reflektime mbi shkaqet rrënjësore zakonisht lihen të pashprehura për shkak të vështirësisë të pashmangshme të prodhimit të të dhënave, objektivisht të verifikueshme dhe që nuk lënë vend për interpretim. Megjithatë, meqenëse progresi është bërë në letër, mbetet i pakapshëm në praktikë, dhe është e rëndësishme që të dihet shkaku rrënjësor, të zgjerohet fusha e diskutimit dhe të stimulohet vazhdimi me vlerësime të synuara. Adresimi i këtyre sfidave do ta kërkojë një vizion afatgjatë të të gjithë akterëve përkatës.



---

## **i.Pronësia e proceseve reformuese**

---

Pavarësisht proceseve të rëndësishme të reformës gjyqësore dhe iniciativave për ta përmirësuar trajtimin e rasteve të KOK, efektiviteti duket të jetë i penguar nga pronësia e pamjaftueshme e akterëve përkatës të sektorit të drejtësisë. Përderisa dhënia e udhëzimeve, propozimeve të politikave dhe përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve janë inkurajuese, zbatimi i

bashkërenduar dhe pronësia janë thelbësore. Zhvillimi i një vizioni të përbashkët për reformën, të udhëhequr nga palët përkatëse të interesuara, së bashku me mekanizmat e qartë të mbikëqyrjes dhe me kanalet e fuqishme të komunikimit, është thelbësor për nxitjen e bashkëpunimit dhe të llogaridhënies në mesin e autoriteteve përgjegjëse.

---

## **ii.Burimet**

---

Monitorimi i proceseve gjyqësore dhe informacionet e ofruara nga zyrtarët gjyqësorë konfirmojnë se institucionet gjyqësore përballen me sfida materiale dhe burime njerëzore, veçanërisht kur kemi të bëjmë me ekspertët e specializuar për hetime financiare. Edhe në juridiksionet me një numër në dukje të mjaftueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh, shpërndarja e burimeve mund të jetë joefektive ose joefikase. Boshllëqet e gjata kohore të emërimeve në drejtësi dhe prokurori e përkeqësojnë këtë problem. Përveç kësaj, institucioneve gjyqësore shpesh

u mungon stafi i mjaftueshëm mbështetës ligjor.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon që Ministritë e Drejtësisë ta harmonizojnë mbështetjen e tyre politike me mbështetjen financiare, si dhe ta përshpejtojnë procesin e emërimit në këshillat gjyqësore dhe prokuroriale. Një mungesë e burimeve bazë njerëzore dhe materiale gjithashtu ndikon negativisht në perceptimin e aktorëve të sektorit të drejtësisë ndaj vlerës dhe rëndësisë së punës vetanake, duke e nxitur tutje inercinë dhe performancën e dobët.

---

## **iii. Kapaciteti dhe ekspertiza**

---

Identifikimi i shkakut rrënjësor të kapacitetit të papërshtatshëm është sfidues. Problemet i përfshijnë burimet jo të mjaftueshme strukturale, duke përfshirë menaxhimin dhe bashkëpunimin joefektiv në mesin e akterëve të lartë gjyqësorë e gjithashtu edhe mungesën e aftësivë ose

mosgatishmërinë për t'i përdorur aftësitë ekzistuese. Për shembull, në shumicën e aktakuzave në të gjitha juridiksionet, projekti ka gjetur mospërputhje në mes të përshkrimit faktik dhe kualifikimit ligjorë, arsyetime jo adekuate dhe madje edhe dështime për ta specifikuar dëmin ekonomik që

supozohej se është shkaktuar nga vepra penale, mungesa të cilat shpesh qojnë në akuza që nuk dëshmohen dhe si pasojë shpjen në aktgjykime liruese dhe në konfiskim të kufizuar të pasurive. Në të gjitha juridiksionet ekzistojnë gjithashtu probleme më arsyetimin jo adekuat në aktgjykime gjë që rregullisht shpie tek rigjykimet. Programet e ngritjes së kapaciteteve të ofruara nga institucionet vendore dhe nga komuniteti ndërkombëtar janë të

bollshme e me një gamë të gjerë temash në të gjithë rajonin. Megjithatë, në shkallë të ndryshme, udhëzimet e disponueshme, manualët e trajnimit dhe praktikat e vendosura mbeten të pashfrytëzuara. Andaj, ende ka vend për një vlerësim të nevojave për të identifikuar shkaqet reale të kapaciteteve të dobëta si dhe nivelin dhe llojin e duhur të reagimit korrigjues të kërkuar.

---

#### **iv. Mekanizmat e llogaridhënies dhe të menaxhimit të performancës**

---

##### **Performanca dhe llogaridhënia individuale**

Sistemet joefektive të menaxhimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke përfshirë kriteret e vlerësimit të cilat e favorizojnë sasinë mbi cilësinë, nuk e nxisin performancën optimale. Përveç përmirësimit të vlerësimit të performancës individuale, nevojitet një përpjekje e bashkërenduar për promovimin dhe standardizimin e praktikave më të mira, së bashku me stimuj për zbatimin e standardeve që ekzistojnë në letër, por që ende nuk po arrijnë të përkthehen në menaxhim kuptimplotë të performancës në praktikë.

##### **Performanca dhe llogaridhënia institucionale**

Vlerësimi i performancës së përgjithshme të gjyqësorit kërkon përmirësim të konsiderueshëm, me shumicën e sistemeve gjyqësorëve që

fokusohen në rezultate e jo në metrikë të rezultateve. Mbledhja e mëtutjeshme e fragmentuar dhe jo konsistente e të dhënave e pengon një pasqyrë domethënëse. Shumica e sistemeve gjyqësore nuk grumbullojnë të dhëna gjithëpërfshirëse lidhur me rastet e rënda të KOK, duke i lënë çështjet dhe shqetësimet kritike të analizuara në mënyrë të pamjaftueshme.

Në të vërtetë, të dhënat e publikuara nga institucionet gjyqësore nuk e lejojnë identifikimin e tendencave në administrimin e drejtësisë, duke e reduktuar kapacitetin e vendimmarrësve për marrjen e vendimeve të bazuara në dëshmi dhe duke e minimizuar ndikimin e këtyre të dhënave në ndërgjegjësimin dhe besimin e publikut.

Një qasje e drejtuar nga të dhënat do të ndihmonte në këto aspekte.

Ngjashëm me pjesën tjetër të Evropës, sistemet gjyqësore në BP po përpiqen që ta balancojnë dëshirën e tyre për ta nxitur transparencën me të drejtën e privatësisë dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.<sup>7</sup> Pavarësisht nga kjo, mungesa e mekanizmave të fuqishëm të llogaridhënies të drejtuara kah të dhënat e minon efektivitetin e gjyqësorit dhe e gërryen besimin e publikut. Projekti do të vazhdojë që të punojë në identifikimin e vlerave dhe të

kornizave statistikore të cilat mund ta nxisin performancën në përmbushjen e "qëllimeve që shoqëria i vendos për gjyqësorin" (siç përshkruhet në Metodologjinë e Projektit).

Për më tepër, përpjekjet e vazhdueshme nga iniciativat si Komisioni Evropian i Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) e kanë një rol vendimtar në adresimin e kësaj çështjeje, veçanërisht nga këndvështrimi i efikasitetit.

---

## **v. Mbisundimi i formalizmit**

---

Në të gjithë rajonin, një kulturë e formalizmit i detyron bartësit e funksioneve gjyqësore që t'u përmbahen kërkesave minimale në mënyrë të rreptë. Kjo është veçanërisht e theksuar atëherë kur kornizat rregullatore mungojnë ose janë të paqarta, me zyrtarët gjyqësorë të cilët u nënshtrohen kolegëve të tyre vertikalisht dhe horizontalisht brenda vet hierarkisë.

Gjetjet e Projektit tregojnë se kjo kulturë e formalizmit e redukton nxitjen për ta zbatuar si dhe pronësinë mbi reformat; e pengon cilësinë dhe efikasitetin e procedurave, duke çuar në konfirmimin e aktakuzave me të meta teknike si dhe në dështimin për ta adresuar përfaqësimin joadekuat ligjor ose gabimet procedurale nga të gjitha palët.

<sup>7</sup>Grupi i Politikave të Projektit "Ndërtimi mbi identifikuesin e Jurisprudencës Evropiane" Publikimi në internet i vendimeve të gjykatave në BE (Ndërtimi mbi Identifikuesin e Jurisprudencës Evropiane, 15 shkurt 2017), <https://bo-ecli.eu/uploads/deliverableserrrrdrffff/Deliverable%20WS0-D1.pdf>

## IV. RRUGA PARA NESH

Në të pesë juridiksionet, autoritetet dhe komuniteti ndërkombëtar kanë iniciuar aktivitete për adresimin e shumë aspekteve të çështjeve të identifikuara në këtë raport. Këtu përfshihen strategjitë, planet e veprimit, udhëzimet dhe ngritja e kapaciteteve. Këto janë investime thelbësore, arritja e progresit të qëndrueshëm do ta kërkojë një punë shtesë.

Me këtë Raport, Projekti synon që t'i promovojë rekomandimet për zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve sistematike në trajtimin e rasteve të KOK. Këto rekomandime duhet të konsiderohen në kontekstin më të gjerë të të gjithë sistemit të drejtësisë penale. Ashtu siç nuk ka një metodologji të pranuar botërisht për vlerësimin e efektivitetit, po ashtu, nuk mund të ketë një qasje të vetme që u përshtatet të gjitha reformave gjyqësore të nevojshme për ta përmirësuar përpunimin e rasteve të KOK. Legjislacioni dhe politikat e ndryshme

institucionale mund të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, me qëllimet e shoqërisë lokale dhe me perceptimet e drejtësisë. Palët e interesuara gjyqësore duhet të demonstrojnë fleksibilitet në hartimin e politikave, duke vazhduar t'i respektojnë standardet e pranuar dhe duke marrë parasysh se si ndërveprojnë me njëra tjetrën zgjedhjet e ndryshme të politikave dhe të dizajnit institucional. Si i tillë, Projekti e ka marrë një qasje të nuancuar ndaj detyrës së ndërlikuar të zhvillimit të rekomandimeve përkatëse, të zbatueshme dhe novatore.

Rekomandimet e Projektit synojnë që ta mundësojnë pronësinë, ta nxisin qëndrueshmërinë dhe ta rrisin besimin e publikut tek gjyqësori. Të zbatuara siç duhet, këto politika duhet që ta krijojnë një histori të qëndrueshme, të krijojnë ndikim të qëndrueshëm, të nxisin zgjidhje funksionale dhe që ta adresojnë rezistencën e mundshme.

### Historiku

Krijoni parakushte për një histori efektive kundër KOK, duke ofruar një rrugë të qartë drejt zbatimit, duke pasur parasysh burimet ekzistuese dhe kulturën ligjore.

### Ndikimi

Synoni për ndryshime që bëjnë një ndryshim të menjëhershëm ndërsa punoni drejt një ndikimi të qëndrueshëm.

### Fuqizimi

Adresoni rezistencën, llogaritni praktikat aktuale operacionale dhe kulturën e punës.

Duke e ditur se përpjekje të konsiderueshme janë duke u zhvilluar tashmë në këtë fushë, Projekti e ka vënë një theks të veçantë në aktivitetet që mund ta përmirësojnë motivimin e palëve të interesuara për t'i zbatuar mjetet që janë tashmë në dispozicion të tyre.

Rekomandimet aktuale bazohen në dokumentet e punës jo-publike të Projektit të vitit 2023 (periudha e rishikimit korrik 2021 deri në qershor 2023), të cilat u shkëmbyen drejtpërdrejt dhe në besim me palët e interesit të sektorit të drejtësisë në nëntor të vitit 2023.

Projekti u konsultua me këto palë të interesit për t'i vlerësuar pikëpamjet e tyre lidhur me këto rekomandime para përfshirjes së tyre në këtë raport.

Këto rekomandime u miratuan gjithashtu nga Ministrat e Drejtësisë në Forumin Ministror BE-Ballkani Perëndimor 2023 për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme.

Me miratimin e shumicës së këtyre rekomandimeve, akterët e sektorit të drejtësisë në të pesë juridiksionet tashmë i kanë përfshirë disa prej tyre në kuadrin e reformës vetanake. Për ta vlerësuar angazhimin e të gjitha palëve të interesit për partneritete konstruktive dhe largpamëse me OSBE-në dhe me BE-në si donator i projektit, rekomandimet që tashmë janë zbatuar nga palët e interesit janë pasqyruar siç duhet në këtë Raport. Megjithatë, zbatimi i këtyre përpjekjeve do të mbetet brenda fushës së veprimit të këtij Projekti dhe progresi do të raportohet në raportet e ardhshme.

# V. Shqipëria

## Shënim hyrës

Vlerësimet e fundit të bëra nga Projekti lidhur me trajtimin e rasteve të KOK në Shqipëri kanë nxjerrë në pah progres dhe sfida të vazhdueshme.

Në përgjithësi, të drejtat e gjykimit të paanshëm janë respektuar në rastet e monitoruara, por lindin shqetësime lidhur me limitet kohore në pezullimin e paraburgimit nga gjykatat për të gjithë të bashkëpandehurit, pavarësisht nga kontributi i tyre individual në vonesa. Transparenca vuan nga komunikimi i paqëndrueshëm me median dhe përditësimet e parregullta të faqeve të internetit<sup>8</sup>, duke e minuar potencialisht besimin e publikut.

Mangësitë e identifikuara në aktakuza dhe në aktgjykime, si dhe çështjet e vazhdueshme si proceset e ngadalta të emërimeve dhe vendet e lira në poste vendimtare e minojnë në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin dhe paraqesin sfida shtesë për administrimin efektiv të drejtësisë, gjë që kërkon profesionistë

të motivuar dhe me aftësi të specializuara.

Pavarësisht këtyre sfidave, ka një shtim të dukshëm të hetimeve të rasteve të KOK të profilit të lartë, përfshirë rastet e pastrimit të parave, gjë që e vë në pah angazhimin e Prokurorisë së Specializuar (SPAK) për luftimin e rasteve të KOK. Janë krijuar rregullat e sjelljes dhe etikës, si dhe udhëzimet e vlerësimit profesional për prokurorët dhe gjyqtarët.

Ministria e Drejtësisë (MD) e ka krijuar gjithashtu një rrjet bashkërendues kundër korrupsionit për t'i shtuar përpjekjet kundër korrupsionit. Miratimi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i udhëzimeve për marrëdhëniet gjykatë-media është gjithashtu një hap pozitiv në adresimin e shqetësimeve që lidhen me transparencën.

Efektet e të gjitha këtyre zhvillimeve duhet të shqyrtohen nga afër për ta vlerësuar progresin e prekshëm.

<sup>8</sup> <https://www.gjp.gov.al/>

<https://gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-specializuar-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar>

## Paanshmëria

1

### Rekomandim

**Të sigurohet që praktika gjyqësore për pezullimin e paraburgimit të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikat më të mira për të drejtat e gjyqimit të drejtë. Për këtë qëllim:**

- i. Në afat të shkurtër, Gjykata e Lartë duhet që ta nxjerrë një vendim unifikues që e harmonizon praktikën dhe e garanton përputhjen me standardet ndërkombëtare të gjyqimit të drejtë.
- ii. Në afat të gjatë, Parlamenti duhet t'i miratojë ndryshimet në nenin 265 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) për t'i shmangur paqartësitë ligjore në lidhje me pezullimin e kohës të paraburgimit për të gjithë të bashkëpandehurit.

Paraburgimi shërben si masë e përbashkët sigurie në drejtësinë penale shqiptare, veçanërisht në çështjet që kanë të bëjnë me rastet e KOK, me 40 nga 48 rastet e monitoruara ku përfshihen të pandehur të cilët gjenden në paraburgim. Megjithatë, kjo praktikë ka implikime për procedurat gjyqësore, pasi një ditë në paraburgim barazohet me një ditë e gjysmë në dënimin përfundimtar. Kjo shpesh përdoret si një taktikë mbrojtëse për t'i minimizuar dënimet, por edhe kontribuon në vonesat e gjykimeve<sup>9</sup>. Për t'i shmangur situatat kur të pandehurit lirohen për

shkak të kufizimeve shteruese të paraburgimit<sup>10</sup>, ndryshimet e KPP në vitin 2017 e vunë në jetë pezullimin e këtyre afateve nëse vonesat procedurale shkaktohen në mënyrë të pajustificueshme nga i pandehuri dhe/ose avokati mbrojtës.

Megjithatë, Projekti është i shqetësuar me gjykatat të cilat i pezulluan kufizimet kohore të paraburgimit për të bashkëpandehurit të cilët nuk e shkaktuan shtyrjen në 73 seanca, duke e zgjatur në mënyrë të paarsyeshme paraburgimin.

<sup>9</sup> Neni 57 i KP

<sup>10</sup> Shih: Delijorgji kundër Shqipërisë, Nr. i Aplikimit 6858/11

Kjo ngre çështje lidhur me të drejtën e lirisë sipas nenit 5 të GJEDNJ, pasi të pandehurit përballen me pasoja për vonesat e shkaktuara nga të tjerët, në kundërshtim me standardet e gjykimit të drejtë. Pezullimi ndodh kur të pandehurit ose avokatët e tyre e shkaktojnë shtyrjen e afatit për shkak të "veprimeve ose kërkesave të padrejta" ose për shkak të mosparaqitjes.<sup>11</sup> Pavarësisht mungesës së dispozitave të qarta, gjykatat e interpretojnë ligjin në një mënyrë që në dukje bie ndesh me të drejtën e lirisë së të pandehurve.

Një analizë krahasuese me vendet evropiane, veçanërisht me Italinë, ka gjetur dispozita të ngjashme në KPP-të e tyre. Megjithatë, KPP-ja italiane sqaron se pezullimi i afateve nuk vlen për të bashkakuzuarit që kërkojnë gjykime të veçanta. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e ka kritikuar trajtimin e paraburgimit në Shqipëri, duke i përmendur vonesat e shkaktuara nga avokatët e të bashkëpandehurve si dëshmi të kujdesit të pamjaftueshëm.<sup>12</sup>

Duke e nënvizuar këtë qëndrim, në një vendim ndaj Shqipërisë, GJEDNJ vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, në justifikimin e paraburgimit të ankuesit, i ishte referuar zvarritjes së procedurave të shkaktuara nga avokati i të bashkakuzuarit të tij. Në mungesë të ndonjë mase për t'i adresuar vonesat e

tilla, nuk mund të thuhet se sistemi vendorë i drejtësisë penale e kishte trajtuar çështjen e ankuesit me "zell të veçantë"<sup>13</sup>.

Gjykatësit dhe prokurorët e kanë pranuar këtë problem, duke ia atribuar atë paqartësisë së dispozitave të KPP-së dhe vendimeve jo konsistente të Gjykatës së Lartë. Sugjerimet e dhëna e përshijnë nxjerrjen e vendimeve për ndërprerjen e rastit ose ndryshimin e KPP-së për ta adresuar këtë çështje dhe për ta patur në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të gjykimit të drejtë. Nga ana tjetër, siç vërehet në Itali, Gjykata e Lartë mund të nxjerrë vendime uniforme për harmonizimin e praktikave dhe për sigurimin e përputhshmërisë me standardet e gjykimit të drejtë. Këto veprime do t'i korrigjonin paqartësitë në interpretimin e ligjit, do t'i mbronin të drejtat e të pandehurve dhe do t'i mbështesnin parimet e gjykimit të drejtë në sistemin e drejtësisë penale shqiptare.

Përfundimisht me datën 14 shtator 2023, MD e ka paraqitur një draft të pjesërishëm të pjesës së përgjithshme të Kodit të ri Penal (KP) për konsultim publik, ku përllogaritja e paraburgimit barazohet me një ditë dënim në dënimin përfundimtar. Projekti e konsideron këtë si një hap përpara në adresimin e kësaj çështjeje.<sup>14</sup>

<sup>11</sup> Neni 265 i KPP.

<sup>12</sup> Neni 304 paragrafi 5 i KPP të Italisë

<sup>13</sup> Rasti Mucaj kundër Shqipërisë, Vendimi i datës 11 Korrik 2023, § 23

<sup>14</sup> Një Kod Penal i ri për Shqipërinë - Ministria e Drejtësisë (drejtesia.gov.al)



### **Sigurimi i përfaqësimit ligjor efektiv në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë drejtim:**

- i. MD dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA) duhet ta bëjnë një rishikim rregullator dhe buxhetor të kombinuar me një analizë të kostos/përfitimit – nëpërmjet një grupi punues ndërinstitucional – për ta mundur një rritje adekuate të tarifave të avokatëve ex officio. Theksi duhet të vihet në shpërblimin e avokatëve të emëruar ex officio për përfaqësimin e të pandehurit para Gjykatave të Specializuara për Korrupsion dhe Krim të Organizuar (GjSKKO).
- ii. MD dhe DHKA duhet ta përpunojnë një listë të specializuar të avokatëve ex officio për përfaqësimin e të pandehurit përpara gjykatave të SKKO-së.
- iii. MD dhe DHKA duhet të punojnë në propozimin për ndryshimin e Ligjit për profesionin e avokatit<sup>15</sup> dhe ta përgatisin një procedurë specifike në Statutin e DHKA-së për monitorimin e punës së avokatëve mbrojtës të caktuar ex officio në rastet e mbrojtjes së detyrueshme.
- iv. DHKA duhet që ta fuqizoj një procedurë transparente, në kohë dhe të konsoliduar, për përpunimin e pretendimeve kundër avokatëve mbrojtës për ta rritur përgjegjshmërinë e tyre dhe për ta përmirësuar efikasitetin e procedurave.

E drejta për një gjykim të paanshëm që është e garantuar nga traktatet thelbësore të të drejtave të njeriut, e përfshin mbrojtjen ligjore efektive. Të pandehurit kanë të drejtën e ndihmës

juridike cilësore, qoftë të zgjedhur apo të ofruar falas nëse nuk mund ta përballojnë atë, me çka sigurohet një procedurë e drejtë penale.”<sup>16</sup>  
Në Shqipëri, e drejta kushtetuese për

<sup>15</sup> Ligji Nr. 55/2018, 'Mbi profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë'

<sup>16</sup> Neni 6, paragrafi 3 (c) i KEDNJ thotë se: “ të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës juridike sipas zgjedhjes së tij ose, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar ndihmën juridike, ajo t'i ofrohet falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”.

mbrojtje efektive ligjore çenohet nga sfidat në ofrimin e ndihmës nga avokatët mbrojtës të caktuar ex officio. Projekti ka vënë re mungesën e avokatëve të caktuar ex officio gjatë gjykimeve dhe në përfaqësimin joefektiv, duke përfshirë refuzimet për t'i marrë rastet ose dorëheqjet. Në gati 48.1% të seancave joproductive (265 nga 552), mungesa e avokatëve mbrojtës u përmend si një arsye kryesore, duke shpënë në procedime të zgjatura.<sup>17</sup> Për më tepër, Projekti ka vërejtur se gjykatat kanë raportuar dhe e kanë informuar DHKA-në për sjelljen e pahijshme të avokatëve mbrojtës të caktuar sipas legjislacionit.<sup>18</sup>

Kanë dalur gjithashtu shqetësime lidhur me tarifatat e ulëta që u paguhen avokatëve mbrojtës të caktuar ex-officio, duke kontribuar në problemet e lartpërmendura. Tarifatat, e paguara në bazë të gjykimeve, janë dukshëm më të ulëta në krahasim me juridiksionet e tjera të BP-së, duke e dekurajuar përfaqësimin cilësor. Tarifatat aktuale, që variojnë nga 36,000 lekë (rreth 330 euro) deri në 88,000 lekë (afërsisht 800 euro),<sup>19</sup> i mbulojnë gjykimet që mund të zgjasin mbi tre vjet ose më shumë, duke krijuar probleme financiare për avokatët. Pakoja e Vlerësimit të Drejtësisë Penale të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin

(UNODC) e nënvizon ndikimin e kompetencës, të arsimit dhe shpërblimit të duhur në cilësinë e përfaqësimit nga avokatët e caktuar ex officio, të cilët zakonisht paguhen më pak se homologët e tyre gjyqësorë.<sup>20</sup>

Rritja e tarifave të avokatëve të caktuar ex officio kërkon ndryshime në Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë<sup>21</sup> dhe Kreut të DHKA-së, për ta siguruar një modalitet të parashikueshëm përlllogaritjeje bazuar në kritere të qarta dhe në një politikë të drejtë shpërblimi. Proceset e përsheptuara dhe të strukturuar të shpërblimit janë thelbësore për çdo hap procedural. Tarifatat e rritura e motivojnë një përfaqësim më të mirë, duke e inkurajuar pjesëmarrjen e rregullt dhe përgatitjen për seancat me qëllim të sigurimit të mbrojtjes efektive.

Megjithatë, Projekti konsideron se vetëm rritja e tarifave për avokatët e caktuar ex officio nuk do t'i adresojë shqetësimet lidhur me cilësinë e përfaqësimit ligjor. DHKA duhet që gjithashtu ta krijojë një listë të veçantë të avokatëve të caktuar ex officio të angazhuar në rastet e mbrojtjes së detyrueshme para gjykatave të SKKO-së, të cilët i posedojnë aftësitë dhe përvojën e specializuar të nevojshme për këtë rol. Një listë e tillë duhet të përpunohet së bashku me MD-në dhe

<sup>17</sup> Neni 31, paragrafët (b) dhe (ç) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë thotë: ' Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen e vet' e gjithashtu 'të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; [dhe] 'të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme'.

<sup>18</sup> Neni 56 I KPK-së dhe dispozitat e Ligjit Nr. No. 55/2018 "Mbi Profesionin e Avokatëve në Republikën e Shqipërisë".

<sup>19</sup> Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Kryesuesit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr. 1284/3, i datës 16 Mars 2005, 'Mbi aprovimin e Pagesave dhe tarifave për ofrimin e mbështetjes ligjore' i parasheh tarifatat e avokatëve të caktuar ex-officio.

<sup>20</sup> Shih fq. 1 e Instrumentit të Vlerësimit të Drejtësisë Penale të UNODC-së "Qasja në drejtësi: Mbrojtja ligjore dhe ndihma juridike"; [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison\\_reform/cjat\\_eng/4\\_Legal\\_Defence\\_and\\_Legal\\_%20Aid.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison_reform/cjat_eng/4_Legal_Defence_and_Legal_%20Aid.pdf).

<sup>21</sup> Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Kryesuesit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Nr. 1284/3, i datës 16 Mars 2005, 'Mbi aprovimin e Pagesave dhe tarifave për ofrimin e mbështetjes ligjore'

gjykatat. Për më tepër, projekti konsideron gjithashtu se duhet të miratohet një dispozitë ligjore specifike për të kërkuar që avokatët e caktuar ex officio të përfshirë në rastet e mbrojtjes së detyrueshme para gjykatave të SKKO-së tu nënshtrohen trajnimeve specifike. Po kështu, bazuar në nenin 244 pika 7, të ligjit nr. 115/2016: “Për institucionet e qeverisjes së gjyqësorit”, siç është amendamentuar, DHKA mund ta lidhë një marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës (SHM) për të siguruar trajnime të rregullta të specializuara për avokatët e caktuar ex officio.

Për më tepër, duhet të propozohen amendamente të Ligjit Nr. 55/2018 dhe të Statutit të DHKA- së për ta

përfshirë një dispozitë dhe procedurë specifike për monitorimin e cilësisë së performancës së avokatëve mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare në çështjet pranë gjykatave të SKKO-së. Kjo e përfshin miratimin e rregulloreve të brendshme dhe akteve nënligjore që mungojnë për krijimin e një praktike transparente dhe të konsoliduar për adresimin e menjëhershëm të pretendimeve për sjellje të pahijshme. Gjyqtarët njëzëri i mbështesin këto rekomandime, duke e njohur natyrën e shumë anshme të çështjeve të tilla si seancat joproduktive dhe të drejtat e kompromentuara të mbrojtjes për shkak të mungesës së avokatëve të caktuar ex officio dhe të jo profesionalizmit.

### 3

#### Rekomandim

**Të sigurohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) do ta fuqizojë transparencën dhe qasjen në informacionet e rasteve të KOK duke i zbatuar udhëzimet të cilat i rregullojnë marrëdhëniet e gjykatave të KLGJ-së me publikun dhe me median. Për këtë qëllim, në mënyrë specifike:**

i. KLGJ-ja duhet të sigurohet që informacioni i saktë dhe me kohë lidhur me rastet e KOK të publikohet/përditësohet rregullisht në platformat publike përkatëse, duke përfshirë orarin gjyqësor të seancave publike.

ii. KLGJ-ja duhet që ta përmirësojë komunikimin e saj me shoqërinë civile dhe me median, duke u siguruar që gjykatat e KLGJ-së dhe SKKO-së t'u përgjigjen kërkesave për informacione në kohë,

konsistente dhe gjithëpërfshirëse. Ky përmirësim duhet që ta përfshijë mbajtjen e konferencave për shtyp në baza të rregullta dhe/ose kur ka raste të KOK me interes të lartë publik.

iii. KLGJ duhet të sigurohet që gjykatat e SKKO-së t'i publikojnë vazhdimisht versionet më të shkurtra të vendimeve – dhe versionet e plota aty ku është e mundur – duke i respektuar të drejtat e privatësisë.

Zbatimi i duhur i detyrave të gjykatësit të caktuar për marrëdhëniet me publikun nëpërmjet komunikimit të rregullt me publikun dhe median, përditësimi në kohë reale i zhvillimeve të rëndësishme gjyqësore dhe një qasje më e standardizuar për publikimin e vendimeve do ta rriste transparencën, duke e rritur përfundimisht besimin e publikut tek sistemi gjyqësor. Legjislacioni shqiptar<sup>22</sup> parasheh që të gjitha vendimet e gjykatës duhet të publikohen sipas kërkesave ligjore përkatëse, duke marrë parasysh edhe kufizimet përkatëse të të dhënave personale. Korniza ligjore aktuale e parashikon gjithashtu edhe rolin dhe përgjegjësitë e një gjyqtari specifik të caktuar për marrëdhëniet me publikun në çdo gjykatë, i cili duhet të jetë përgjegjës për komunikimin me institucionet, me publikun dhe me

median, duke siguruar dhënien e informacionit të rregullt për zhvillimet e rëndësishme gjyqësore dhe vëzhgimin e publikimit të vendimeve gjyqësore në përputhje me dispozitat ligjore<sup>23</sup>.

Megjithatë, projekti i ka vënë në dukje shqetësimet lidhur me dështimin e gjykatave për ta informuar publikun dhe median në lidhje me veprimtarinë e gjykatave të SKKO për publikimin e vendimeve, komunikimin me median dhe dhënien e informacioneve të tjera të rëndësishme në raste me interes të madh publik, pavarësisht nga ajo nëse kjo ka të bëjë me prezantimin e punës së përgjithshme të gjykatave apo ofrimin e detajeve për raste të veçanta. Faqja e internetit e gjykatave të SKKO-së e parasheh publikimin e një numri të kufizuar vendimesh, duke lënë jashtë rastet e gjykuara nga këto gjykata.

<sup>22</sup> Neni 46, "Marrëdhëniet me Publikun", të Ligjit Nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor".

<sup>23</sup> Neni 91, "Qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun", të ligjit nr. 115/2016 "Për institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Kjo mungesë e një strategjie të qartë dhe gjithëpërfshirëse komunikimi me publikun u konfirmua gjatë konsultimeve me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), të cilët e nënvizuan sasinë tepër të kufizuar të informacionit lidhur me vendimet.

Megjithëse Shqipëria ka ratifikuar kohët e fundit Konventën e Tromso-s (Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare)<sup>24</sup>, ende nuk ka një praktikë të unifikuar se çfarë përbëjnë të dhënat personale.

Ka raste kur edhe emrat e gjykatësit dhe të prokurorit janë anonimë, duke e penguar kështu të drejtën e publikut për t'u informuar.

Si një hap pozitiv në adresimin e kësaj çështjeje, KLGJ i ka miratuar një sërë udhëzimesh<sup>25</sup>, të cilat i trajtojnë shqetësimet kryesore të evidentuara nga Projekti në këtë drejtim.

Udhëzimet i rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet gjykatave, publikut dhe medias dhe e sigurojnë një rregullim të hollësishëm dhe të qartë të detyrave dhe përgjegjësiave të gjykatësit dhe punonjësve të tjerë të gjykatës të caktuar për mbajtjen e marrëdhënieve me publikun.<sup>26</sup>

Përfundimisht, Projekti rekomandon që KLGJ-ja t'i japë prioritet zbatimit të udhëzimeve të sipërpërmendura për ta siguruar një komunikim transparent dhe gjithëpërfshirës midis gjykatave të SKKO -së, publikut dhe medias

<sup>24</sup> Në korrik 2022, Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare, CETS 205 - Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare (coe.int).<sup>25</sup> Në datën 6 dhjetor 2023, KLGJ miratoi "Udhëzimet standarde për marrëdhëniet e gjykatave me publikun dhe median", VENDIM-Nr.-716-Datë-06.12.2023-PËR-MIRATIMIN-E-UDHËZUESIT-STANDARD-TË- MARRËDHËNIEVE-TË-GJYKATAVE-ME-PUBLIKUN-DHE-MEDIAN-.pdf

<sup>25</sup>Më 6 dhjetor 2023, KLGJ miratoi "Udhëzimet standarde për marrëdhëniet e gjykatave me publikun dhe median", VENDIM-Nr.-716-Datë-06.12.2023-PËR-MIRATIMIN-E-UDHËZUESIT-STANDARD-TË-MARRËDHËNIEVE-TË-GJYKATAVE-ME-PUBLIKUN-DHE-MEDIAN-.pdf

<sup>26</sup> Udhëzimet parashikojnë çështjen e anonimizimit dhe publikimit të vendimeve nga gjykatat, duke zbardhur paqartësitë e vërejtura nga Projekti në draftin e parë të mëparshëm të udhëzimeve. Më konkretisht, udhëzimet parashikojnë që për çështjet e profilit të lartë të KOK të gjykuara nga gjykatat e SKKO-së, vendimet e gjykatës duhet të publikohen pa anonimitete për shkak të nivelit të lartë të interesit publik për raste të tilla. Pasi kanë sqaruar "zonat gri" të mëparshme duke përcaktuar rolin aktiv të gjykatave në dhënien e informacionit, udhëzimet e reja e lehtësojnë një zbatim të barabartë të së drejtës për informim publik kur bëhet fjalë për çështje të profilit të lartë që kanë interes të madh publik

**Autoritetet kombëtare duhet që t'i përcaktojnë dhe tu japin përparësi rasteve të KOK të nivelit të lartë. Në këtë drejtim:**

- i. KLGJ dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), në bashkëpunim me MD, duhet që të miratojnë rregullore për përcaktimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar për qëllime statistikore dhe politikbërëse.
- ii. Për të njëjtat qëllime, KLGJ dhe KLP, në bashkëpunim me MD, duhet që të miratojnë kritere shtesë për ti dalluar rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar të nivelit të lartë nga rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar "të zakonshëm".
- iii. Bazuar në këtë sistem kategorizimi, MD, KLGJ dhe KLP duhet ta kenë parasysh sa vijon:
  - T'i japin prioritet ndjekjes penale dhe gjyqimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë prokuroritë dhe gjykatat të cilat miratojnë plane pune për procedimin e rasteve të tilla.
  - Hartimi i rasteve të KOK të nivelit të lartë me qëllim të alokimit të burimeve të duhura në zyrat e prokurorive dhe të gjykatave të përfshira në përpunimin e tyre.
  - Të sigurohen që kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve t'i pasqyrojnë në mënyrë adekuate sfidat specifike të pranishme gjatë përpunimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë.

Në Strategjinë e saj të vitit 2018 për BP, KE ka nënvizuar se rruga drejt zgjerimit kërkon krijimin e "një historiku konkret

dhe të qëndrueshëm në trajtimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit të organizuar", si një çështje urgjente.<sup>27</sup>

<sup>27</sup> (Balkans\_BorchureA5\_V7.indd (europa.eu) fq.5).

Një parakusht për krijimin e këtij historiku është ngritja e një sistemi kategorizimi të përshtatur mirë dhe të besueshëm për identifikimin e rasteve të KOK dhe rasteve të KOK të nivelit të lartë. Në fund të fundit, në përgjithësi pranohet se nuk mund të përmirësohet ajo që nuk mund të matet<sup>28</sup>. Së paku, kategorizimi i rasteve të KOK dhe rasteve të KOK të nivelit të lartë do t'u mundësonte institucioneve vendore që të përpilojnë statistika solide për përpunimin e rasteve të tilla dhe do ta ofronte një pikë referimi të qartë për vlerësimin e progresit përkatës.

Projekti është i vetëdijshëm se autoritetet kombëtare shpesh përdorin kritere të bazuara në ligjin penal për t'i identifikuar rastet e KOK dhe rastet e KOK të nivelit të lartë. Për shembull, rastet e korrupsionit identifikohen si raste që përfshijnë krime të caktuara specifike (si ryshfeti ose shpërdorimi i detyrës); Rastet e korrupsionit të nivelit të lartë identifikohen si ato brenda juridiksionit të prokurorive të specializuara ose gjykatave të specializuara që merren me një grup më të ngushtë veprash të korrupsionit.

Megjithatë, kjo nuk është e besueshme për qëllime statistikore ose si bazë për politikëbërje. Dispozitat e ligjit penal duhet të jenë strikte, objektive dhe jo dy kuptimëshe për ta garantuar sigurinë juridike. Për rrjedhojë, kriteret e bazuara në ligjin penal janë të ngurta dhe të paafta për t'i kapur nuancat që

përfundimisht e përcaktojnë një rast KOK të nivelit të lartë. Për shembull, një rast korrupsioni kundër një zyrtari të rangut më të lartë ka të ngjarë të jetë i nivelit më të lartë se një rast i ngjashëm kundër një zyrtari të rangut më të ulët. Ky dallim, megjithatë, nuk mund të zbulohet vetëm në bazë të zbatimit të dispozitave penale. Për këto arsye, rekomandohet që autoritetet kombëtare të miratojnë kritere ad hoc për përcaktimin e rasteve që janë të pavarura nga kuadri ligjor penal dhe veçanërisht për qëllime të politikëbërjes. Sistemi i propozuar i kategorizimit, nëse hartohet siç duhet, mund të jetë një mjet thelbësor në formësimin dhe zbatimin e masave kyçe për t'i përmirësuar reagimet gjyqësore ndaj KOK tek rastet e nivelit të lartë. Krahas krijimit të të dhënave sasiore të besueshme në lidhje me përpunimin e rasteve të tilla, ky sistem mund të përdoret gjithashtu për t'i dhënë përparësi ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë nga prokuroritë dhe gjykatat.

Për shembull, në planet vjetore të punës së gjykatave dhe prokurorive mund të parashihen objektiva specifike lidhur me përpunimin e këtyre rasteve. Harta e rasteve të nivelit të lartë nëpër prokurori dhe gjykata të ndryshme në sistemin vendas mund të përdoret për rialokimin e burimeve njerëzore dhe materialeve kur dhe ku janë më të nevojshme.

<sup>28</sup> (Ju nuk mund ta përmirësoni atë që nuk e matni (forbes.com))

Së fundi, kriteret e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet ta pasqyrojnë punën shtesë dhe sfidat e nevojshme në rastet e KOK, veçanërisht rastet e nivelit të lartë. Shpërblimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që punojnë në këto raste me pikë vlerësi shtesë,<sup>29</sup> për shembull, mund të jetë një mjet efektiv në nxitjen e një reagimi gjyqësor më efikas dhe më profesional ndaj KOK.

Thënë shkurt, zhvillimi i kriterëve të tilla kërkon vëmendje dhe ekspertizë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me kategorizimin e rasteve të KOK të nivelit të lartë. Kërkesat në fjalë duhet t'i përfshijnë tiparet thelbësore të një rasti të nivelit të lartë për sa i përket seriozitetit dhe kompleksitetit të tij, ndërkohë që janë mjaftueshëm të qarta dhe të lehta për t'u zbatuar. Kriteret e përshtatshme mund ta pasqyrojnë ndjeshmërinë e çështjes - për shembull

duke i kategorizuar rastet bazuar në fuqinë dhe rëndësinë e të pandehurit - ose për peshën e sjelljes duke miratuar kriteret e bazuara në dëmin ekonomik ose përfitimin që rezulton nga vepra penale, apo pasoja në jetën dhe mirëqenien e viktimave të saj.

Llojet e tjera të kriterëve mund t'i referohen kompleksitetit të çështjes, për shembull, për sa i përket numrit të të pandehurve, sasisë së provave që do të prodhohen, numrit të ekspertëve të kërkuar, konfiskimit të pasurisë ose nevojës për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (BJN) ose Masat e Veçanta Hetimore (MVH).

Të gjitha këto kriteret janë të rëndësishme dhe qasja më e mirë do të ishte miratimi i një kombinimi kriteresh që mund të peshohen përmes një sistemi të balancuar të pikëve.

<sup>29</sup> Metodologjia e pikëve për vlerësimin e gjyqtarëve është një mjet që KLGJ përdor për ta matur punën vjetore të gjyqtarëve. Rezultati i vlerësimit mund të ndikojë ndjeshëm në promovimin e gjyqtarit.



**Rishikimi i juridiksionit lëndor të gjykatave të SKKO për ta siguruar efikasitetin në përpunimin e rasteve më të rënda të KOK. Në këtë drejtim:**

- i. Grupi Punues Ndërmintor (GP) për miratimin e amendamenteve të KP duhet t'i rishikojë dispozitat ekzistuese për përjashtimin e gjykatave të SKKO -së nga gjykimi i veprave të kryera nga zyrtarët publikë (për shpifje dhe fyerje).
- ii. GP ndërmintore për miratimin e ndryshimeve në KPP duhet t'i propozojë amendamentet për rritjen e pragut që e përcakton juridiksionin lëndor të prokurorisë së SPAK dhe gjykatave të SKKO-së për veprat e korrupsionit.

Reforma kushtetuese e vitit 2016 i krijoi gjykatat e SPAK-ut dhe të SKKO-së dhe e përcaktoi juridiksionin e tyre për t'i ndjekur respektivisht gjykuar, të gjitha veprat penale të KOK. Për më tepër, gjykatat e SKKO janë kompetente për t'i gjykuar të gjitha akuzat penale kundër zyrtarëve të lartë publikë aktualisht në detyrë ose për veprat penale të kryera gjatë kohës sa ata ishin në detyrë.<sup>30</sup>

Për ta lehtësuar ngarkesën e punës nga veprat penale të nivelit të ulët, në vitin 2021 Kuvendi i miratoi ndryshimet në KP dhe KPP duke e ngushtuar juridiksionin e SPAK-ut vetëm për veprat penale me një vlerë minimale të përfitimit të veprës penale në shumën e 50.000 Lekëve (afërsisht 450 euro)

për korrupsion aktiv (neni 244), ndikim të paligjshëm ndaj zyrtarëve publikë (neni 245/1 i KP) dhe korrupsion pasiv (neni 259 i KP); dhe 800 000 lekë (rreth 800 euro) për veprën penale të shkeljes së parimit të barazisë në tenderët publikë (neni 258 i KP).

Prokuroritë dhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë kompetente për t'i ndjekur dhe gjykuar të njëjtat vepra penale që përfshijnë një vlerë më të ulët të përfitimit nga vepra penale.

Projekti ka vërejtur se rastet e korrupsionit ku përfshihen veprat penale të nivelit të ulët, por që janë brenda pragut të prokurorisë dhe

<sup>30</sup> Nenet 135 (2) dhe 147/dh të Kushtetutës së Shqipërisë, siç janë amendamentuar me Ligjin Nr. 76/2016.

gjykatave të specializuara (prokuroritë dhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë kompetente për t'i ndjekur dhe gjykuar veprat penale me vlerë më të ulët) kontribuojnë në ngarkesën e tepërt të rasteve për gjykatat SPAK dhe SKKO, të cilat mund të ndikojnë në kapacitetet e tyre për përpunimin e rasteve më të rënda. Kështu, KPP-ja duhet të ndryshohet për ta rritur pragun që e përcakton juridiksionin e prokurorisë së SPAK-ut dhe të dy gjykatave të SKKO-së.

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët e propozuan llogaritjen e shumës duke e shumëzuar pagën minimale në fuqi. Raporti i saktë për këtë shumëzim duhet të përcaktohet pas konsultimit me palët përkatëse të interesit, me ekspertët ligjorë dhe financiarë dhe partnerët ndërkombëtarë.

Përveç kësaj, gjykatat e specializuara e trajtojnë<sup>31</sup> një numër të madh rastesh të "shpifjes" (neni 120 i KP) dhe "fyerjes" (neni 119 i KP) ndaj zyrtarëve të lartë. Gjatë konsultimeve me ekipin e projektit, gjykatësit nga të dyja shkallët – GJSKKO e Shkallës së Parë dhe Apeli – dhe prokurorët e pranuan se kjo është një ngarkesë shtesë e punës që kërkon përpjekje shtesë për t'u marrë me këto raste më pak serioze dhe se heqja e ankesave penale private nga juridiksioni i tyre kur të pandehurit janë persona zyrtarë publikë të nivelit të lartë do ta ulnin ndjeshëm barrën e punës së tyre.

Së fundmi, kreu i SPAK-ut e pranoi nevojën për ta shtuar vlerën e juridiksionit lëndor gjatë mbledhjes së Komisionit të Integritetit në BE të Kuvendit të Shqipërisë.<sup>32</sup>

<sup>31</sup> Vendimi Unifikues nr.23/2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

<sup>32</sup> [Dumani kërkon heqjen e 'korrupsionit të vogël' nga kompetenca e SPAK - Reporter.al](#)

KLJG-ja, në konsultim me gjyqtarët e gjykatave të SKKO-së, duhet që t'i miratojë udhëzimet për menaxhimin e gjykimeve të rasteve komplekse të KOK, të cilat ndër të tjera do ta përfshijnë edhe rolin dhe funksionin e seancës paraprake. Udhëzimet duhet që t'i promovojnë teknikat efektive të menaxhimit të gjykimeve, të tilla si mbajtja e seancave të njëpasnjëshme në rastet komplekse të KOK.

**Udhëzimet për menaxhimin e gjykimeve dhe rregullat e menaxhimit të rasteve do ta siguronin angazhimin e palëve dhe përshtatshmërinë e procedurave dhe duhet që së paku:**

- i. Ta përshkruajnë sasinë e kohës së nevojshme për gjykim.
- ii. Të bien dakord për një datë të paracaktuar të seancës.
- iii. Ta përcaktojnë numrin dhe qëllimin e dëshmitarëve që secila palë planifikon t'i thërrasë.
- iv. T'i përshkruajnë nëse do të ketë prova ose dëshmitarë ekspertë, së bashku me emrat, profesionet, titullin/pozitën e ndonjë dëshmitari ekspert.
- v. Ta shqyrtojnë nëse secila palë do të përfaqësohet nga një avokat dhe ta përfshijë disponueshmërinë e tyre dhe të dhënat e tyre personale.
- vi. Ta përcaktojnë nëse dokumentet duhet të shkëmbehen ose të merren nga jashtë.
- vii. Ta përcaktojnë se si do të prezantohen dëshmitë.
- viii. Ta përcaktojnë nëse ka nevoja të veçanta për paraqitjen e dëshmive (për shembull, një dëshmitar jashtë qytetit që dëshiron të japë dëshmi me telefon ose përmes video-telefonatës).
- ix. Të dakordohen lidhur me punësimin e një eksperti të dakorduar reciprokisht.
- x. Të pajtohen për shkëmbimin e informacioneve shtesë.

## Rekomandim

xi. T'i diskutojnë provat e kërkuara, duke përfshirë dëshmitarët dhe dokumentet, duke i renditur ato dhe duke e përcaktuar se si do të gjenden dhe se si do të paraqiten në gjykatë në kohën e kërkuar


xii. Ta përfshijnë një historik të afateve kohore të paraburgimit dhe një afat kohor të përgjithshëm të procedurave.

xiii. Ta përmbajnë informacionin lidhur me kontaktin për informim të shpejt të palëve lidhur me anulimet e seancave - vetëm për arsye të justifikuara - për ta shmangur pjesëmarrjen e panevojshme të palëve dhe dëshmitarëve në gjykatë.

Projekti e ka identifikuar zgjatjen e tepërt të procedurave në rastet e KOK të nivelit të lartë dhe të mesëm si një problem sistematik për shkak të mungesës së menaxhimit efektiv të seancave gjyqësore.


Rastet e KOK të nivelit të lartë mund të zgjaten për një kohë të pacaktuar, pasi sistemi gjyqësor nuk dëshiron ose nuk është në gjendje që t'i marrë masat e duhura.

### Mesatarja e seancave dëgjimore në baza mujore



Grafiku nr.5 - Mesatarja nr. i seancave për muaj

## Kohëzgjatja mesatare e procedurave (në muaj)



Grafiku 6 - Kohëzgjatja mesatare e procedurave (në muaj)

Adresimi i këtij problemi jo vetëm që kërkon aftësi më të mira menaxheriale nga gjykatësit dhe prokurorët, por gjithashtu kërkon një ndryshim rrënjësor të politikës institucionale. Korniza ligjore aktuale i parashikon disa masa paraprake si caktimi i datës së seancës, thirrja e dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe masa të tjera urgjente.<sup>33</sup>

Megjithatë, këto masa, përveçse janë pjesë përbërëse e procedurës së shqyrtimit gjyqësor të parashikuar nga KPP, janë jo shteruese dhe jo gjithëpërfshirëse sa duhet për adresimin e nevojave të procedurës paraprake.

Për më tepër, gjyqtarët ankohen për taktikat e avokatëve mbrojtës për t'i zgjatur procedurat gjyqësore, duke përfshirë ngritjen e shpeshtë të çështjeve shëndetësore, përjashtimet e vazhdueshme për arsye të ndryshme dhe kërkesat për shtyrje të seancave për shkak të angazhimeve kontradiktore.

Projekti ka vëzhguar raste kur trupi gjykues ka vepruar në mënyrë proaktive për ta përmirësuar efikasitetin e provave. Në 15 nga 48 rastet e monitoruara, trupi gjykues ka paracaktuar seanca të njëpasnjëshme ose ka marrë masa të tilla si shpërndarja e raportit të ekspertit para seancës për t'ua mundësuar palëve që të përgatiteshin për seancën.

Megjithatë, edhe pse pozitive, këto masa ishin të rastësishme dhe nuk zbatoheshin nga të gjithë gjyqtarët në mënyrë të unifikuar.

Mungesa e udhëzimeve dhe e një procedurë uniforme për fazën paraprake po e pengon zhvillimin e drejtë, ekonomik dhe të shpejtë të seancave gjyqësore, gjë që përfundimisht mund ta dëmtoj vetë qëllimin e procedurës. Ndërkohë që problemet strukturore në aspektin e burimeve u pranuan gjithashtu nga palët e interesuara gjatë konsultimeve, tashmë ekzistojnë mjete procedurale që

<sup>33</sup> Neni 333-338 i KPP.

mund të përdoren për adresimin e kësaj çështje. Gjyqtarët e mbështetën propozimin për zbatimin e rregullave të konferencës së statusit, megjithëse kishte pikëpamje të ndryshme se si duhet bërë kjo, siç janë ndryshimet në KPP ose thjesht krijimi i udhëzimeve për menaxhimin e rasteve.

Zbatimi i kësaj procedure në legjislacione të tjera, si në Mbretërinë e Bashkuar,<sup>34</sup> për shembull, u mundëson gjykatave që ta identifikojnë çdo rast që herët, siç janë nevojat e dëshmitarëve, dhe siguron qartësi se çfarë duhet bërë, nga kush dhe kur. Një udhëzim i tillë do të ndihmonte në vendosjen e standardeve për përfaqësimin nga mbrojtja dhe do të siguronte një pikë referimi për të përcaktuar se kur mund të garantohet ndërhyrja. Zbatimi i udhëzimeve duhet të mbështetet përmes trajnimeve gjithëpërfshirëse për të përmirësuar nivelin e përfaqësimit.

Veprimet e dobishme në këtë drejtim e përfshijnë përcaktimin e hershëm të një afati kohor për ta siguruar progresin e rastit; sigurimin që provat të paraqiten shkurt dhe qartë; i dekurajon vonesat; trajtimi i sa më shumë aspekteve të rastit dhe shmangia e seancave të panevojshme; inkurajimi i palëve që të bashkëpunojnë për ta siguruar progresin e rastit; përmes përdorimit të teknologjisë. Projekti rekomandon që KLGJ-ja ta krijojë një grup pune, së bashku me përfaqësues të gjyqtarëve të SKKO -së, për t'i miratuar udhëzimet për menaxhimin e seancave gjyqësore dhe për t'i bërë ato pjesë integrale të rregullave të brendshme të gjykatës. Përveç sigurimit të një aplikimi të njëtrajtshëm nga të gjithë gjyqtarët, këto udhëzime do të ndihmonin në ofrimin e procedurave më të shpejta, mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve dhe rritjen e efikasitetit të gjykatës.

## 7

### Rekomandim

**KLJGJ duhet që ta krijojë një grup gjyqtarësh të specializuar në rastet e KOK, të cilët mund të caktohen menjëherë në raste të reja ose në rastet që janë duke u trajtuar. Për këtë qëllim**

i. KLJGJ duhet që ta hartojë një rregullore të veçantë e cila i përcakton kriteret dhe procedurat për funksionimin e sistemit të delegimit të gjyqtarëve vetëm për gjykatat e SKKO.

ii. Gjyqtarët në skemën e delegimit, ose ata që janë transferuar ose emëruar përkohësisht për ta dëgjuar një rast specifik në gjykatat e SKKO (në tekstin e mëtejshëm "gjyqtarët e përkohshëm"), duhet të marrin trajnime specifike për veprat penale të KOK, si dhe për praktikën e brendshme të Gjykatave të SKKO nga (SoM).

<sup>34</sup> Rregullat e Procedurës Penale (MB), Pjesa 3 "Menaxhimi i Çështjeve".

iii Gjyqtarët në sistemin e delegimit të gjykatave të SKKO duhet të marrin pikë shtesë në vlerësimin e performancës së tyre nga KLGJ në krahasim me gjyqtarët e sistemit të delegimit në gjykatat e zakonshme.

Projekti ka hasur shqetësime në lidhje me efikasitetin e sistemit të emërimeve të KLGJ-së dhe me performancën e gjyqtarëve të transferuar përkohësisht nga gjykatat tjera ose të caktuar në raste specifike për adresimin e barrës së punës, ngarkesës së mbetur ose të nevojave specifike brenda sistemit gjyqësor. Veçanërisht, përveç çështjes së vonesave në emërimin e tyre, Projekti ka vërejtur raste kur këta gjyqtarë të përkohshëm kanë shkaktuar vonesa dhe kanë ndikuar në efikasitetin e procedurave. Konkretisht, seancat (23 ose 2,35 % e seancave të monitoruara) janë shtyrë përtej afatit ligjor prej 15 ditësh kalendarike për shkak të ngarkesës së tepërt të gjyqtarëve të përkohshëm, ndërkohë që dispozitat e KPP nuk lejojnë asnjë zgjatje të këtij afati. Projekti ka vënë re shtyrje të njëpasnjëshme të seancave për shkak të mungesës së disponueshmërisë së një gjyqtari të përkohshëm për shkak të angazhimeve të tyre urgjente në gjykata të tjera ose për shkak të emërimit të tyre në gjykatat më të larta. Projekti ka identifikuar gjithashtu seanca të stërzgjatura me shtyrje të shpeshta të hershme në rastet e dëgjua nga gjyqtarët e përkohshëm.

Rastet e KOK shpesh përfshijnë të pandehur të shumtë, hetime të

shumta, dosje voluminoze të rasteve, dëshmitarë të mbrojtur, të pandehur me të dhëna të shumta penale, transaksione financiare komplekse, komunikime të koduara dhe çështje ligjore ndërkombëtare. Është me rëndësi të madhe që gjyqtarët e përkohshëm ta kenë ekspertizën dhe aftësitë e nevojshme për trajtimin e rasteve të KOK me të njëjtën aftësi si gjyqtarët e përhershëm. Ekzistimi i një grupi të veçantë gjyqtarësh të trajnuar për rastet e KOK do ta siguronte trajtimin më efektiv të rasteve të tilla duke shmangur kundërthëniet dhe pabarazitë e mundshme në administrimin e rasteve si dhe në dënim, dhe një proces të përsheptuar rekrutimi. Për më tepër, një grupim i veçantë do t'i stimulonte gjyqtarët e përkohshëm duke u dhënë atyre më shumë pikë vlerësimi se sa gjyqtarët në skemën e delegimit të gjykatave të rregullta dhe prioritet në procesin e rekrutimit për pozitat vakante në gjykatat e SKKO-së.

Për më tepër, KLGJ-ja duhet që të hartojë rregullore të veçanta të cilat i përvijojnë kriteret dhe procedurat që e rregullojnë sistemin e delegimit për gjyqtarët e përkohshëm, vetëm për raste specifike të KLGJ-së, duke përfshirë stimujt për të qenë pjesë e

grupit. Këto rregullore të specializuara duhet që t'i përfshijnë kriteret specifike të përzgjedhjes, përveç atyre të parashikuara në legjislacionin në fuqi

duke përfshirë trajnimin e detyrueshëm për krimin e organizuar dhe veprat e korrupsionit dhe ndër të tjera edhe njohjen me praktikën e brendshme të gjykatave të specializuara.

8

**Rekomandim**

**Rritja e pragut minimal të gjobave të zbatueshme për avokatët si masë represive ndaj mungesës së pajustificuar, siç parashikohet në nenin 350 (4) të KPP-së.**

Projekti ka vërejtur vazhdimisht se një nga shkaqet kryesore të zvarritjeve procedurale që ndikon në efikasitetin e gjyqësorit është mungesa e pajustificuar e avokatëve. Megjithatë neni 350 (4) i KPP i jep trupit gjykues mundësinë për të shqiptuar gjoba (nga 5000 lekë (50 euro) deri në 100 000 (1000 euro)) për avokatin në fjalë, nëse ai nuk paraqitet në seancë për rastet kur nuk ka pengesa të arsyeshme. Projekti ka vënë re se shumica e sanksioneve ishin më afër kufirit minimal të zbatueshëm (5000 lekë ose afërsisht 50 euro). Ky nuk është një ndëshkim i mjaftueshëm për këtë sjellje, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e praktikës uniforme në shqiptimin e gjobave dhe për shumat e tyre.

Në krahasim, neni 34 i Kodit të Procedurës Civile e ka sanksionuar një kufi minimal prej 50 000 lekësh (ose afërsisht 400 euro) për rastet kur palët i abuzojnë me vetëdije të drejtat e tyre gjatë procesit.

Gjatë konsultimeve me ekipin e Projektit, gjykatësit propozuan llogaritjen e gjobave në bazë të shumëzimit të pagës minimale zyrtare në fuqi për ta shmangur përditësimin e vazhdueshëm të dispozitave ligjore në fuqi. Raporti i saktë i shumëzimit duhet të përcaktohet pas konsultimeve me palët përkatëse të interesit, me ekspertët ligjorë dhe financiarë dhe me partnerët ndërkombëtarë.



**GJSKKO e Shkallës së Parë, dhe GJSKKO e Apelit dhe Prokurorisë së Specializuar (PS) duhet të pajisen me këshilltarë ligjorë shtesë për të trajtuar ngarkesën e tyre të madhe me raste. Për këtë qëllim:**

- i. KLGJ-ja duhet ta zbatojë dispozitën ligjore ligjore për themelimin e një njësie ligjore për emërimin e këshilltarëve ligjorë në GJSKKO të Shkallës së Parë.
- ii. KLGJ dhe KLP duhet të rrisin numrin aktual të këshilltarëve ligjorë, përkatësisht në GJSKKO të Apelit dhe PS.

Projekti e ka vërejtur një mungesë të përgjithshme të mbështetjes profesionale për gjyqtarët e gjykatave të SKKO. Me ngarkesën e madhe të rasteve, kjo mungesë e mbështetjes profesionale ndikon negativisht edhe në kohën e procedimeve dhe në cilësinë e akteve gjyqësore. Ky shqetësim është theksuar në Raportin e fundit Vjetor për Gjendjen e Gjyqësorit (për vitin 2022)<sup>35</sup> të publikuar nga KLGJ. Ai raport konstatoi se megjithëse emërimi i gjyqtarëve të rinj (në vitin 2022, tre gjyqtarë të rinj u emëruan në GJSKKO të Apelit, ndërsa një u emërua në GJSKKO të Shkallës së Parë) e uli lehtësisht barrën e rasteve për gjyqtar, numri i lëndëve të mbetura të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe fakti që të dyja gjykatat ende nuk po funksiononin me

kapacitet të plotë në aspektin e burimeve njerëzore, e rriti ndjeshëm kohën e nevojshme për përfundimin e një rasti. Për GJSKKO të Shkallës së Parë, koha e nevojshme për ta proceduar një rast korrupsioni u dyfishua, ndërsa koha e nevojshme për ta proceduar një rast të krimit të organizuar u rrit me 24% krahasuar me një vit më parë. Për GJSKKO -në e Apelit, koha e nevojshme për ta proceduar një rast është rritur me 40%.

Pavarësisht nga sa u tha më sipër, gjykatat e SKKO -së ende funksionojnë sipas strukturës së parashikuar nga dispozitat e vjetra ligjore (përpara ndryshimeve të datës 23 mars 2021), ku GJSKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka këshilltarë ligjorë dhe GJSKKO -ja e

<sup>35</sup> Raporti Vjetor 2022 i KLGJ”, RAPORT-VJETOR-2022-shkarko.pdf (klgj.al) “Raporti Vjetor 2022 i KLGJ”, RAPORT-VJETOR-2022-shkarko.pdf (klgj.al)RAPORT-VJETOR-2022- shkarko.pdf (klgj.al)

Apelit e ka një numër të kufizuar të këshilltarëve ligjorë. Për rrjedhojë, të dyja gjykatat aktualisht funksionojnë pa mbështetjen strukturore të parashikuar me ligj.

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët e konfirmuan nevojën për mbështetje të mëtejshme nga këshilltarët ligjorë, duke i theksuar vështirësitë me të cilat po përballën në trajtimin e dosjeve voluminoze, respektimin e të gjitha afateve ligjore dhe gjetjen e kohës dhe mbështetjes së nevojshme për hartimin e akteve gjyqësore.

Ndryshimet e fundit në ligjin Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor”<sup>36</sup> e parashikojnë mundësinë që të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit (përfshirë gjykatat e SKKO) ta kenë një njësi ligjore të përbërë nga këshilltarë ligjorë të emëruar nga KLGJ.

Duke pasur parasysh nevojën urgjente për mbështetje profesionale në menaxhimin më efikas të barrës së madhe të rasteve, Projekti rekomandon që KLGJ ta caktojë numrin maksimal të këshilltarëve të parashikuar me ligj.

## Kapaciteti

10

### Rekomandim

**Cilësia e akteve gjyqësore të nxjerra nga gjykatat e SKKO dhe prokuroria e SPAK duhet të përmirësohet, duke përfshirë zhvillimin e mjeteve specifike për t'i udhëhequr ato në hartimin e këtyre akteve. Për këtë qëllim:**

i. KLGJ duhet ta hartojë një model për hartimin e vendimeve për gjyqtarët e GJSKKO. Ai duhet që t'i pasqyrojë kërkesat ligjore të vendimeve si dhe kërkesat dhe teknikat shtesë, për ta siguruar ligjshmërinë dhe cilësinë e aktit.

ii. KLP duhet ta hartojë një model për hartimin e aktakuzave nga prokurorët e SPAK. Modeli duhet që t'i pasqyrojë kërkesat ligjore të aktakuzave dhe t'i përfshijë kërkesat dhe teknikat shtesë për ta siguruar ligjshmërinë dhe cilësinë e aktit.

<sup>36</sup>Neni 42 i ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i ndryshuar.

iii. Prokuroria e SPAK-ut duhet që të krijojë mekanizma të brendshëm për shqyrtimin e aktakuzave përpara finalizimit, duke e siguruar një ekuilibër të duhur midis autonomisë së një prokurori individual dhe fuqisë së një mbikëqyrësi për të dhënë udhëzime në raste të veçanta. Mekanizmi duhet të mbështetet në një grup specifik udhëzimesh që e përcaktojnë saktësisht procesin e kontrollit të cilësisë për hartimin e aktakuzave dhe që përfshijnë tregues cilësorë rreth cilësisë së aktakuzave për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

iv. KLGJ duhet që ta rishikojë treguesin e performancës në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore në sistemet e menaxhimit të performancës së gjyqtarëve, duke i integruar këto udhëzime të reja në procesin e vlerësimit. Trajnimi i komisionit vlerësues për zbatimin e këtyre standardeve të reja është gjithashtu i rëndësishëm.

Projekti gjeti se 22 nga 49 vendimet e analizuar nuk kishin analizë të plotë dhe kishin të meta strukturore, veçanërisht në adresimin e të gjitha pretendimeve të mbrojtjes dhe reagimit ndaj argumenteve të tyre ligjore.

Vërtetimi i provave nuk ishte përshkruar në mënyrë adekuate në lidhje me faktet penale me të cilat akuzoheshin të pandehurit. Shpesh ishte e vështirë të shihej se si secila pjesë e provave lidhej me veprën penale dhe si i vërtetonte akuzat kundër secilit të pandehur.

Në anën tjetër, 31 nga 42 aktakuzat e analizuar nuk e kishin një strukturë gjithëpërfshirëse, duke rezultuar në mospërputhje me një ose më shumë nga elementet e kërkuara nga KPP.

Jo të gjitha aktakuzat përmbanin një përshkrim të qartë të fakteve, veprimeve ose mosveprimeve të të pandehurve e as analizë të provave mbështetëse. Aktakuzat që përfshijnë shumë të pandehur shpesh nuk e specifikonin mënyrën e përgjegjësisë dhe nuk i përcaktonin qartë provat të cilat e vërtetonin kontributin individual penal të secilit të pandehur për secilën vepër të akuzuar.

Në këtë pikë, gjyqtarët e GJSKKO-së së Apelit e pranuan mungesën e përgjithshme të një qasjeje analitike të strukturuar dhe konsistente ndaj vendimeve, por sugjeruan gjithashtu që KLGJ-ja ta shqyrtojë më nga afër cilësinë e gjykimit si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Shabllonet e vendimeve dhe aktakuzave të përshtatura me kërkesat e KPP-së mund ta ofrojnë një strukturë gjithëpërfshirëse për ta lehtësuar punën hartuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i përmbajtur të gjitha elementët e kërkuara nga dispozitat e KPP-së<sup>37</sup> dhe duke i sugjeruar teknikat dhe praktikat më të mira për hartimin e akteve në rastet komplekse dhe të jenë të përshtatura për t'i adresuar sfidat specifike ligjore të rasteve të KOK.

Qëllimi i këtyre shablloneve duhet të jetë që t'ua mundësojnë të pandehurve që t'i lexojnë më lehtë aktet ligjore, por duke mos ndërhyrë në lirinë e gjyqtarëve apo prokurorëve për ta hartuar një akt ligjor sipas vlerësimit më të mirë të tyre. Praktika e përdorimit të shablloneve të vendimeve

mbështetet gjithashtu nga Udhëzimet e CEPEJ<sup>38</sup> për shkak të efekteve pozitive në përmirësimin e procesit të përgjithshëm të menaxhimit të rasteve.

Gjithashtu, projekti rekomandon që një grup gjyqtarësh dhe prokurorësh të përfshihen, si nga KLGJ-ja po ashtu edhe KLP-ja në hartimin e këtyre shablloneve me qëllim marrjen e njohurive më të mira të mundshme, duke shpënë rrjedhimisht në rezultate të prekshme në shabllone të mirë strukturuar.

Për më tepër, në rastet kur mungon mbështetja profesionale, shabllonet e standardizuara janë një ndihmë e rëndësishme në përgatitjen e akteve gjyqësore dhe prokuroriale gjithëpërfshirëse dhe të mirë strukturuar.

<sup>37</sup> Neni 383 i KPP "Elementet e Vendimit" dhe neni 331/3 i KPP "Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjykatë".

<sup>38</sup> Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), "Udhëzues në fushën e efikasitetit të drejtësisë", Seksioni V, pika A, paragrafi 3, 16809f007a (coe.int).

# VI. BOSNJA DHE HERCEGOVINA

## Hyrje

Trajtimi i përmirësuar i rasteve të KOK mbetet imperativ në forcimin e shtetit të së drejtës në BeH. Pavarësisht aspiratave të deklaruara politike dhe institucionale dhe përkushtimit të konsiderueshëm nga disa bartës të funksioneve gjyqësore, trajtimi efektiv dhe efikas i rasteve të KOK të nivelit të lartë mbetet i paarrtshëm. Në nivel institucional, procedimi dhe gjykimi i rasteve të tilla dhe thelbi i proceseve të vazhdueshme të reformës në drejtësi për ta fuqizuar integritetin, transparencën dhe llogaridhënien, shumica prej të cilave janë përballur me kundërshtime politike, pasqyrojnë mangësi serioze. Në vitin 2021, KLGJP i BeH e ka miratuar një agjendë gjithëpërfshirëse reformash për gjyqësorin, megjithëse shumë nga masat nuk janë zbatuar. Në shkurt të vitit 2024, është miratuar një agjendë reformash e rishikuar dhe më e kufizuar. Ligji i ri mbi KLGJP të BeH ende nuk është miratuar. Në vitin 2023, u miratuan amendamentet lidhur me integritetin në Ligjin ekzistues për KLGJP të BeH, megjithëse ndryshimet e minutës së fundit, në krahasim me tekstin e miratuar nga Komisioni i Venecias, mund ta minojnë ndikimin e synuar të amendamenteve.<sup>39</sup> Ligji i ri për gjykatat e BeH gjithashtu nuk është miratuar.

Shqetësimet lidhur me ndikimin e pa duhur të jashtëm mbi gjyqtarët dhe prokurorët që i trajtojnë rastet e KOK të nivelit të lartë vazhdojnë. Konsultimet me palët e interesuara nxorën në pah shqetësime domethënëse lidhur me politizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Projekti kanë vënë re shqetësime të ngjashme në disa raste të monitoruara ku përfshiheshin politikanë të rangut të lartë. Rastet e përshkruara më poshtë, kur vendosen në kontekstin më të gjerë të frikësimit politik të gjyqësorit, mund të tregojnë për integritet dhe pavarësi të pamjaftueshme dhe jo thjesht boshllëqe apo jo efikasitet kapacitetesh.

Mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe planifikimi rreth burimeve ekzistuese njerëzore në të gjitha institucionet mbetet problematike. Duke pasur parasysh ritmin e ngadaltë të procesit të emërimit, postet gjyqësore shpesh mbeten të paplotësuara për muaj e nganjëherë edhe vite. Gjyqtarët gjithashtu kanë mungesë të stafit adekuat mbështetës. Si shenjë progresi, shtimi i këshilltarëve ekonomikë në prokurori ofron mbështetje të paçmuar në punën me të dhënat financiare.

<sup>39</sup> Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Bosnjë dhe Hercegovinë Opinion për Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial, nr. 1015/2021 (Strasburg: Këshilli i Evropës, CDL-AD(2021) 015, 23 mars 2020.

Edhe pse Projekti nuk e monitoron fazën e hetimit, informacioni i marrë gjatë konsultimeve, si dhe të dhënat e monitorimit të provave tregojnë se hetimet proaktive janë të rralla. Megjithatë, në një zhvillim pozitiv, disa prokurori kanë miratuar plane veprimi për t'i dhënë prioritet hetimit të rasteve të caktuara së bashku me institucionet e zbatimit të ligjit ose me institucionet tjera përkatëse, siç janë organet kundër korrupsionit.

Një tregues i mundshëm i progresit në rritje është rritja e numrit të aktakuzave të konfirmuara në rastet e nivelit të lartë që nga viti 2018.<sup>40</sup> Për shembull, në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, aktakuzat e konfirmuara për korrupsion të nivelit të lartë u rritën nga 14 në 16 dhe aktakuzat e konfirmuara të krimit të organizuar të nivelit të lartë u rritën nga 6 në 14. Megjithatë, mbetet për t'u parë rezultatet e këtyre rasteve dhe se si do të procedohen ato. Në vitin 2023 u shqiptuan tetë vendime të formës së prerë dhe detyruese në rastet e KOK të nivelit të lartë.<sup>41</sup>

Kohëzgjatja e procedurave në rastet e KOK mbetet një shqetësim i domethënës. Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës shpesh e demonstrojnë një shkallë të lartë tolerance për vonesat dhe madje një qëndrim të përgjithshëm të vetëkënaqur, nëse jo indiferent, ndaj procedurave joefikase.

Si një zhvillim pozitiv, KLGJP i BeH e ka miratuar një konkluzion i cili synon rritjen e disiplinës procedurale dhe kërkon që seancat dëgjimore të mbahen çdo javë; megjithatë, në shumë raste të monitoruara, kjo ende nuk është një normë. Kërkohet një qasje dukshëm më proaktive për menaxhimin e provave për ta kapërcyer këtë kulturë aktuale të jo efikasitetit.

Seksioni tjetër, i përpunuar në bazë të gjetjeve të monitorimit të seancave gjyqësore të Projektit dhe konsultimeve me zyrtarët gjyqësorë, i prezanton dhjetë rekomandime për adresimin e këtyre çështjeve më urgjente .

<sup>40</sup> KLGJP i BeH e zhvilloi një përkufizim të rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë në vitin 2019 dhe u rishikua në vitin 2021, i cili përfshin shqyrtimin e statusit të të pandehurit dhe peshën e veprës së pretenduar.

<sup>41</sup> Të dhënat nga KLGJP BeH, mars 2024, në dosje me Projektin

## Paanshmëria

1

### Rekomandim

#### **Përmirësimi i transparencës dhe i qasjes në informacion lidhur me procedimin e rasteve të KOK; në veçanti:**

i. KLGJP-ja e BeH duhet ta sigurojë uniformitetin e praktikës duke i zhvilluar ose përditësuar rregulloret ekzistuese për organizimin e gjykatave dhe të prokurorive, dhe udhëzimet të cilat i përcaktojnë standardet minimale në lidhje me:

- Publikimin e akteve gjyqësore dhe informacioneve të tjera që kanë të bëjnë me procedimet penale, përfshirë edhe orarin e seancave.
- Reagimin me kohë ndaj kërkesave për informacione.
- Komunikimin me publikun gjatë hetimit dhe në rastet me interes publik.

ii. KLGJP e BeH duhet që ta krijojë një grup këshillues për median dhe/ose të mbajë takime të rregullta me median për t'i diskutuar dhe zgjidhur sfidat në lidhje me qasjen në informacione.

Projekti e ka identifikuar mungesën e transparencës dhe qasjen e pamjaftueshëm në informacione që kanë të bëjnë me KOK, duke përfshirë publikimin e paqëndrueshëm të orareve të seancave nga gjykatat, publikimin e paqëndrueshëm të akteve gjyqësore dhe procedurat e gjata dhe të rënda për marrjen e informacionit duke përdorur ligjet e lirisë së informacionit. Këto sfida u konfirmuan përmes konsultimeve me përfaqësues të shoqërisë civile dhe me palët e interesuara gjyqësore.

Në fakt, megjithëse palët e interesuara i pranuan gjerësisht hapat e ndërmarrë nga gjyqësori për ta nxitur transparencën, shoqëria civile dhe media mbeten të frustruara nga mungesa e informacionit në kohë. Bartësit e funksioneve gjyqësore shprehën një sërë qasjesh dhe pikëpamjesh në lidhje me shkëmbimin e informacionit mbi procedimet penale me publikun, duke reflektuar qasjen jo konsistente ndaj transparencës midis institucioneve të ndryshme gjyqësore.

Udhëzimet ekzistuese për publikimin e akteve gjyqësore nuk zbatohen në mënyrë uniforme. Ndërsa KLGJP i BeH ka mbajtur disa takime ad hoc me përfaqësues të medias, një modalitet

më i qëndrueshëm, si një grup këshillues mediatik, do ta krijonte një rrugë më të qëndrueshme të komunikimit të dyanshëm midis gjyqësorit dhe medias.

2

## Rekomandim

### **Promovimi i zbatimit uniform të ligjit për ta nxitur sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit. Në mënyrë specifike:**

- i. KLGJP i BeH, së bashku me gjykatat e apelit në BeH, duhet të vazhdoj që ta përsos raportimin dhe klasifikimin e praktikës gjyqësore në bazën e të dhënave ligjore gjyqësore dhe të sigurohet që pozicionet e vendosura gjyqësore të përfshihen siç duhet.<sup>42</sup>
- ii. Të gjithë bartësit e funksioneve gjyqësore duhet ta rrisin referencën dhe mbështetjen në pozicionet ligjore gjyqësore të caktuara nga gjykatat më të larta.
- iii. KLGJP i BeH, panelet e harmonizimit dhe gjykatat e apelit në BeH duhet ta sigurojnë adresimin e qëndrimeve konfliktuale gjyqësore.
- iv. Ministritë e drejtësisë dhe organet legjislative duhet ta kenë prioritet harmonizimin e legjislacionit penal material dhe procedural relevant për trajtimin e rasteve të KOK.

Zbatimi uniform i ligjit është thelbësor për sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit dhe kontribuon në paanësinë dhe drejtësinë si dhe në perceptimin e publikut për to. Bazuar në gjetjet e monitorimit të proceseve gjyqësore dhe në konsultimet me zyrtarët gjyqësorë,

mekanizmat për sigurimin e trajtimit të qëndrueshëm të rasteve të ngjashme janë të dobëta. Për më tepër, verdiktet dhe vendimet e rishikuara në rastet e monitoruara rrallë përfshijnë referenca lidhur me praktikën gjyqësore ose qëndrimet ligjore, gjë që tregon

<sup>42</sup> Baza e të dhënave të pozitive juridike gjyqësore është e disponueshme në faqen e internetit të KLGJP të BeH: Baza sudske prakse (pravosudje.ba).



mungesën e mbështetjes në to. Mjetet dhe mekanizmat ekzistues duhet të fuqizohen dhe promovohen për ta siguruar një uniformitet më të madh në zbatimin e ligjit në procedurat penale në përgjithësi dhe veçanërisht në rastet e KOK. Gjithashtu, harmonizimi i procedurës penale dhe i ligjit penal në

lidhje me procedimin e rasteve të KOK duhet të ndiqet në mënyrë aktive nga ministrinë përkatëse të drejtësisë.

Përpjekjet *ad hoc* për harmonizimin e legjislacionit duhet të zëvendësohen nga një trup i përherëshëm ekspertësh me këtë mandat.

## Efikasiteti

3

### Rekomandim

**KLGP i BeH, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët duhet ta nxisin trajtimin efikas të rasteve të KOK, veçanërisht të rasteve të nivelit të lartë. Më konkretisht, ata duhet:**

i. Të miratojnë udhëzime për menaxhimin e proceseve gjyqësore për t'i adresuar çështjet siç është identifikimi i çështjeve faktike dhe ligjore për të cilat është rënë dakord, identifikimi i provave të dakorduara dhe të kontestuara, disponueshmëria e dëshmitarëve dhe dëshmitarëve ekspert si dhe taktika e vonesave nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

ii. Të sigurohet zgjidhja në kohë e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar duke kërkuar një plan procesesh gjyqësore që përfshin caktimin e seancave ditore, ose – së paku – të shumë seancave gjatë javës, deri në përfundimin e gjykimit.


iii. Të përdoren të gjitha mjetet e disponueshme të politikave për ta kërkuar trajtimin me prioritet të rasteve të KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë planet për reduktimin e lëndëve të pazgjidhura, planet vjetore dhe planet e veprimit të krijuara së bashku me institucionet tjera.

iv. Kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët, brenda institucioneve të tyre përkatëse, duhet që ta krijojnë një mekanizëm monitorues për ta siguruar trajtimin ose hetimin efikas të rasteve të KOK, me mbikëqyrje dhe raportim pranë KLGJ-së së BeH-së.

Projekti ka identifikuar vonesa të panevojshme dhe të shmangshme në procedime si dhe mungesë të praktikave efikase të menaxhimit të proceseve gjyqësore, duke përfshirë caktimin e rrallë të seancave, shtyrjet dhe vonesat për shkak të shëndetit të të pandehurve ose të avokatëve. Edhe në rastet që janë zgjidhur në një kornizë kohore të përshtatshme, një inspektim më i afërt i procedurës zbuloi jo efikasitet, siç janë seancat që zgjasin shpesh nën dy orë, të cilat nuk i përdorin në mënyrë efektive seancat e planifikuara dhe kohën e të pranishmëve si dhe dëshmitarët që nuk marrin pjesë.

Planifikimi i rrallë i seancave është një sfidë domethënëse që mbizotëron si në rastet e korrupsionit ashtu edhe në rastet e krimit të organizuar, pavarësisht nga kompleksiteti i çështjes. Edhe pse seancat paraprake mbaheshin shpesh, ato nuk u përdorën për ta përcaktuar ndonjë kornizë kohore reale për përfundimin e gjykimit. Mesatarisht, në rastet e monitoruara me vendim të shkallës së parë ose të formës së prerë dhe detyruese pas procedurave gjyqësore, seancat dëgjimore mbaheshin një herë në muaj në rastet e krimit të organizuar dhe një herë në dy muaj në rastet e korrupsionit (shih Grafikon 6).

### Mesatarja e seancave dëgjimore të mbajtura çdo muaj



**Grafiku 6** - Numri mesatar i seancave të mbajtura në baza mujore në 33 rastet që janë monitoruar nga Korriku 2021 deri në Mars 2024.

Autoritetet gjyqësore kanë publikuar informacion të kufizuar në lidhje me kohëzgjatjen e përgjithshme të procedimeve, një faktor që shërben si një tregues tjetër i efikasitetit. Në mesin e 17 lëndëve të monitoruara në të cilat është dhënë aktgjykimi i shkallës së parë dhe që tani janë në fazën e ankimimit, kohëzgjatja mesatare e


procedurës deri në aktgjykimin eshkalës së parë ka qenë mbi tre vjet dhe mesatarisht është mbajtur një seancë në muaj.

Në pjesën më të madhe, këto raste kishin një shkallë kompleksiteti, me shumë të pandehur dhe me shumë akuza. Veçanërisht, për rastet e krimit të organizuar deri në vendimin e

shkallës së parë janë mbajtur mesatarisht 60 seanca, ndërsa për rastet e korrupsionit janë mbajtur 22 seanca. Më tej, duke qenë se të gjitha këto raste janë në apel, kohëzgjatja totale e procedurave do të jetë në mënyrë të pashmangshme shumë më e gjatë.

Sa i përket vendimeve përfundimtare pas procedurave gjyqësore, përderisa kohëzgjatja mesatare e procedurave ishte 3.54 vjet, madhësia e modelit është e vogël, me vetëm nëntë lëndë. Përveç kësaj, këto ishin raste të thjeshta, disa prej të cilave kishin vetëm një ose dy të pandehur.

### Kohëzgjatja mesatare e procedurave në vite



**Grafiku 7-** Kohëzgjatja mesatare e procedurave në 33 rastet e monitoruara nga korriku 2021 deri në mars 2024

Megjithatë, pavarësisht se ishte relativisht e thjeshtë, gjykatat ende mbanin vetëm një seancë çdo dy muaj.

Në 16 rastet e monitoruara, aktakuza është konfirmuar para vitit 2018. Pesë nga këto raste janë ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor; tri çështje janë në rigjykim; pesë raste janë në apel; dhe janë përfunduar vetëm tre lëndë, një në shtator 2022, një në qershor 2023 dhe një në nëntor 2023. Pavarësisht nevojës për përfundimin urgjent të kësaj procedure, duke pasur parasysh kalimin e kohës që nga konfirmimi i aktakuzave përkatëse, në këto raste mesatarisht vetëm një seancë është mbajtur në muaj. Monitorimi i proceseve gjyqësore tregon se rastet e KOK të nivelit të lartë

mund të zgjaten për një kohë të pacaktuar, pasi sistemi gjyqësor nuk dëshiron ose nuk është në gjendje t'i marrë masat e duhura për të bërë progres dhe për t'i finalizuar këto raste. Trajtimi i këtij problemi kërkon aftësi më të mira menagjeriale, rritje të disiplinës procedurale dhe një ndryshim rrënjësor në politikën institucionale, së bashku me angazhimin institucional dhe individual. Edhe pse KLGJP i BeH-së e miratoi Rregulloren mbi Kornizat Kohore për Procedimin e Rasteve në Gjykatat dhe Prokuroritë në BeH (Rregullore) në vitin 2013, e cila i përcakton afatet kohore optimale dhe të parashikueshme për çdo lloj dhe fazë të procedurës, kjo politikë ka pasur pak ndikim në efikasitet.

Rishikimi i Rregullores ishte një masë e paraparë me Agjendën e Reformës së KLGJP të BeH-së të vitit 2021. Në maj 2023, dhe siç u ndryshua në shtator 2023, KLGJP i BeH e miratoi një konkluzion i cili kërkon që seancat dëgjimore të mbahen çdo javë në rastet e KOK. Kjo dhe masat e tjera të propozuara nga KLGJP i BeH të cilat e synojnë përmirësimin e efikasitetit të procedurave në rastet e KOK të nivelit të lartë duhet të zbatohen pa vonesë.<sup>43</sup> Udhëzimet gjithëpërfshirëse të menagjimit të proceseve gjyqësore nevojiten për ta përmirësuar zgjidhjen efikase të rasteve të KOK.

Udhëzimet e tilla duhet të ndihmojnë në adresimin e vonesave në procese duke ofruar një kornizë për nxitjen e një kulture të përshtatshmërisë.

Për më tepër, planet për reduktimin e lëndëve të pazgjidhura dhe dokumentet strategjike, të tilla si planet vjetore të punës, duhet t'i kenë prioritet përfundimet e rasteve të KOK të nivelit të lartë. KLGJP i BeH, duke punuar me secilin kryeprokuror dhe president gjykate, duhet ta krijojë një mekanizëm mbikëqyrës për ta siguruar përpunimin efikas të rasteve të KOK.

## Përmirësimi i Performancës

4

### Rekomandim

**KLGJP i BeH së bashku me kryetarët e gjykatave dhe me kryeprokurorët, duhet të vazhdojë që t'i përmirësojë mekanizmat për monitorimin, analizimin dhe raportimin publik mbi trajtimin e rasteve të KOK si një pikë hyrëse në politikë bërjen efektive dhe të drejtuar nga të dhënat, veçanërisht në lidhje me performancën e përgjithshme institucionale. Më konkretisht, ata duhet:**

i. Që të sigurojnë mbledhje dhe ndarje kuptimplote të të dhënave sasiore, ku mund të përfshihet përcaktimi i mëtejshëm i parametrave për vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit si në rastet e nivelit të lartë ashtu edhe në rastet e tjera të KOK.

<sup>43</sup> KLP BH, Agjenda e Reformës, Masa III.3.3: Zhvillimi i mëtejshëm i aftësive të menaxhimit të kohës dhe menaxhimit të çështjeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve; Masa III.3.7: Analizoni dhe propozoni masa për të siguruar efikasitet dhe efektivitet në caktimin dhe mbajtjen e seancave, duke përfshirë seancat paraprake, veçanërisht në rastet që e përfshijnë korrupsionin, krimin e organizuar dhe krimet e luftës; Masa IV.1.7: Në planet e zvogëlimit të lëndëve të pazgjidhura të gjykatave dhe prokurorive përfshihen si prioritet rastet e korrupsionit të profilin të lartë dhe krimin të organizuar.

ii. Që t'i përmirësojnë modalitetet për aplikimin e analizave cilësore të çështjeve specifike që ndikojnë në trajtimin e rasteve të KOK, duke përfshirë zgjerimin e kapaciteteve kërkimore të brendshme dhe të jashtme.

iii. Që t'i përkufizojnë dhe përmirësojnë procedurat për aplikuar, analizuar dhe përdorur analiza sasiore dhe cilësore në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që këto të dhëna t'i paraqesin përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e trajtimit të rasteve të KOK, dhe t'i publikojnë këto gjetje çdo vit.

KLJGP i BeH e ka përmirësuar monitorimin institucional mbi trajtimin e rasteve të KOK, së bashku me raportimin përkatës. Sistemi i menaxhimit të rasteve prokuroriale u modifikua për të menaxhuar të dhëna shtesë dhe për të prodhuar statistika mbi aspektet kyçe të këtyre rasteve, siç është konfiskimi i pasurisë.

Megjithatë, disponueshmëria e të dhënave të besueshme dhe të zbërthyera nga gjykatat për vendimet e dhëna në rastet e KOK, duke përfshirë dënimet ndaj secilit të pandehur, mbetet e kufizuar.

Si i tillë, mbledhja, nxjerrja dhe raportimi publik i të dhënave duhet të modifikohet më tej për ta përmirësuar disponueshmërinë e një informacioni të tillë.

KLJGP i BeH duke punuar me kryetarët e gjykatave dhe me kryeprokurorët, duhet të bëjë dhe të publikojë analiza cilësore mbi trajtimin e rasteve të KOK, veçanërisht me synimin për identifikimin e çështjeve sistemore dhe reformave të nevojshme përkatëse. Kjo do ta plotësonte analizën gjithëpërfshirëse dhe kuptimplote të të dhënave statistikore.

KLJGP i BeH duhet që ta identifikojë më tej kapacitetin teknik dhe objektivitetin për të aplikuar analiza të tilla dhe pasi të finalizohen, duhet t'i përcaktojë palët e interesuara dhe modalitetet për aplikimin dhe duke i pasuar gjetjet. Bashkëpunimi me organet e jashtme kërkimore, duke përfshirë akademinë ose shoqërinë civile, duhet të rritet.

**KLGGJ i BeH duhet të sigurohet që vlerësimi i performancës gjyqësore dhe prokuroriale dhe kriteret e barrës së punës t'i pasqyrojnë përpjekjet e nevojshme për trajtimin e rasteve të KOK. Në veçanti, KLGGJ i BeH, së bashku me bartësit e funksioneve gjyqësore të përfshirë në proceset e vlerësimit të performancës, duhet që të:**

- i. Sigurohen që komponentet sasiore dhe cilësore të vlerësimeve të performancës gjyqësore ta llogarisin siç duhet kompleksitetin e përpunimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë, së bashku me përpjekjet përkatëse të kërkuara.
- ii. Vazhdojnë ta monitorojnë dhe vlerësojnë ndikimin e ndryshimeve në aspektet sasiore dhe cilësore të vlerësimeve të performancës të prokurorëve dhe gjyqtarëve për ta siguruar që ka stimul të përshtatshëm për t'i përpunuar në mënyrë efektive rastet e KOK të nivelit të lartë.
- iii. Sigurohen që vlerësuesit i zbatojnë në mënyrë të përshtatshme dhe uniforme të gjitha dispozitat e vlerësimit të cilat e lejojnë reflektimin adekuat të efikasitetit dhe cilësisë së punës.

Për ta garantuar paanshmërinë, vlerësimet e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet ta llogarisin me saktësi barrën e tyre përkatëse, duke marrë parasysh kompleksitetin e rasteve të tilla, si dhe kohën dhe burimet e nevojshme për ndjekjen penale dhe gjykimin e tyre. Duke i njohur sfidat specifike në trajtimin e rasteve të KOK të nivelit të lartë, kriteret e vlerësimit të matura siç duhet e përfaqësojnë një nxitje të fuqishme për të punuar në këto raste.


#### *Aktakuzat*

Që nga janari i vitit 2022, shumica e prokurorëve kanë një kuotë të reduktuar në rastet e KOK të nivelit të lartë për ta siguruar një vlerësim më të ekuilibruar të komponentit sasior të vlerësimit të performancës dhe për t'i motivuar prokurorët që t'i marrin përsipër këto raste më të vështira dhe që kërkojnë kohë. Është ende e vështirë të vlerësohet ndikimi i këtyre ndryshimeve. Të dhënat për numrin e aktakuzave të konfirmuara të nivelit të

lartë nga viti 2018 deri në vitin 2023 e japin një pamje të turbullt. Në shikim të parë, duket sikur kuota e rishikuar, dhe ndoshta faktorë të tjerë, kanë


kontribuar në rritjen e numrit të aktakuzave të konfirmuara në rastet e nivelit të lartë, megjithatë nuk mund të përcaktohet një lidhje shkakësore.

### Numri i aktakuzave të rasteve KOK të konfirmuara



**Grafiku 8** - Numri i aktakuzave të konfirmuara në rastet KOK. Burimi: KLGJP i BeH, mars 2024.

### Numri i të akuzuarve në rastet KOK




**Grafiku 9** - Numri i të akuzuarve në rastet KOK. Burimi: KLGJP i BeH, mars 2024.

### Aktgjykimet

Rezultatet gjyqësore në rastet e KOK të nivelit të lartë, të matura me vendimet e shqiptuara përfundimtare dhe detyruese, janë të kufizuara (shih Grafikon 10). Veçanërisht, kuota vjetore

për gjyqtarët në lidhje me krimin e organizuar u zvogëluar, ngjashëm me atë për prokurorët, ndërsa ndryshime të ngjashme për korrupsionin apo për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, nuk janë institucionalizuar.

### Numri i vendimeve përfundimtare në rastet e nivelit të lartë



**Grafiku 10** - Vendime përfundimtare dhe detyruese të nivelit të lartë në BeH. Burimi: Memorandumet e brendshme të KLGJP-së së BeH-së mbi trajtimin e rasteve të KOK nga 2019-2023.

KLJJP i BeH duhet të marrë masa për tu siguruar që komponentët sasiorë dhe cilësorë të vlerësimit të performancës gjyqësore e pasqyrojnë nivelin e kompleksitetit të rasteve të KOK të nivelit të lartë.

Ndryshimet në sistemin e vlerësimit duhet të synojnë nxitjen e përpunimit dhe finalizimit të këtyre rasteve në mënyrë efektive dhe efektive.

## 6

### Rekomandim

**Fuqizimi i ekspertizës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit ligjor për t'i ndjekur penalisht dhe për t'i gjykuar rastet e KOK në mënyrë efektive dhe efektive, duke u siguruar njëkohësisht që institucionet të jenë të organizuara për ta mbështetur zgjidhjen e këtyre rasteve. KLJJP i BeH, në bashkëpunim me kryeprokurorët dhe kryetarët e gjykatave, dhe, sipas rastit, qendrat e trajnimit gjyqësor dhe prokurorial të Republikës Serbe (RS) dhe Federata e Bosnje dhe Hercegovinës (FBeH) duhet:**

- i. Ta promovojnë më tej specializimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në KOK dhe të vazhdojnë të ofrojnë trajnime të specializuara.
- ii. Vazhdimisht ta monitorojnë, vlerësojnë dhe zgjidhin funksionimin, efikasitetin dhe ndikimin e departamenteve të specializuara në trajtimin e rasteve të KOK.

Sistemi gjyqësor i BeH ka krijuar departamente të specializuara për krimin e organizuar, korrupsionin dhe krimet ekonomike brenda disa gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Në FBeH, autoritetet po ndërmarrin hapa për të krijuar departamente të specializuara brenda Gjykatës së Lartë të FBeH dhe Prokurorisë së FBeH për trajtimin e rasteve të KOK. Megjithatë, krijimi i strukturave të specializuara

nuk është kurë; duhet të adresohen një sërë faktorësh të tjerë, siç është sigurimi i një numri të mjaftueshëm të zyrtarëve të kualifikuar gjyqësorë, ekspertëve të specializuar financiarë dhe personelit mbështetës ligjor si dhe të mundësohet një bashkëpunim i fortë me organet e specializuara të zbatimit të ligjit dhe me organe të tjera përkatëse.



KLGP i BeH, qendrat e trajnimit gjyqësor dhe prokurorial të FBeH dhe RS, kryeprokurorët dhe kryetarët e gjykatave duhet të sigurohen që gjykatat dhe zyrat e prokurorisë të përfitojnë nga ekspertiza e gjyqtarëve të specializuar, prokurorëve, bashkëpunëtorëve ligjorë dhe këshilltarëve, si dhe praktikantëve dhe ekspertëve financiarë.

Duhet të shqyrtohen qasjet për ta thelluar ekspertizën e lëndëve në fusha si prokurimi publik, privatizimi dhe pastrimi i parave. Këtu mund të përfshihen trajnime të vazhdueshme dhe krijimi i një ekipi zyrtarësh të specializuar gjyqësorë në dispozicion për të mentoruar dhe këshilluar kolegët e tyre sipas nevojës.

7

## Rekomandim

**Përmirësimi i procedurave në lidhje me hartimin, shqyrtimin dhe konfirmimin e aktakuzave për ta përmirësuar cilësinë e tyre. Në mënyrë specifike:**

- i. Duhet të përmirësohen dispozitat për shqyrtimin e aktakuzave në rregulloret e prokurorive për organizimin e brendshëm për ta përcaktuar më tej procesin, duke përfshirë fushëveprimin e shqyrtimit dhe standardet e aplikueshme. Sipas nevojës, duhet të përfshihen dispozita specifike që lidhen me disa lloje krimesh, të tilla si KOK.
- ii. Kryeprokurorët, zëvendës kryeprokurorët dhe shefat e departamenteve duhet ta zbatojnë mekanizmin e shqyrtimit të aktakuzës në mënyrë konsistente dhe uniforme përpara finalizimit të një aktakuze të KOK.
- iii. Kryetarët e gjykatave duhet të sigurohen që gjyqtarët më me përvojë të shërbejnë si gjyqtarë të seancave paraprake për të vendosur mbi aktakuzat në rastet e KOK.
- iv. Komuniteti i ekspertëve ligjor, duke punuar së bashku me ministritë përkatëse të drejtësisë, duhet t'i analizojë praktikat aktuale dhe ta shqyrtojë zhvillimin e propozimeve legjislative për ta fuqizuar procedurën për konfirmimin e aktakuzës për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe efektiv të shqyrtimit gjyqësor, duke e ruajtur efikasitetin.

Aktakuzat e shqyrtuara nga Projekti përmbanin, ndër të tjera, 1) përshkrime të paqarta faktike; 2) provat mbështetëse që nuk lidhen me akuzën; 3) nuk ofrohen fakte dhe prova të mjaftueshme që mbështesin kualifikimin ligjor; dhe 4) informacioni për fitimin financiar i pa përfshirë. Konsultimet me bartësit e funksioneve gjyqësore i konfirmuan këto çështje lidhur me cilësinë e aktakuzave.

Rregulloret për organizimin e brendshëm të prokurorive parashikojnë që kryeprokurorët, zëvendës kryeprokurorët dhe/ose shefat e departamenteve t'i shqyrtojnë aktakuzat e përgatitura nga prokurorët që ata i mbikëqyrin. Megjithatë, qëllimi i këtij rishikimi nuk është përcaktuar. Është e paqartë nëse shqyrtimi kufizohet vetëm në pajtueshmërinë formale me kërkesat thelbësore ligjore

ose nëse ai e përfshin gjithashtu vlerësimin e mjaftueshmërisë së provave për akuzat, ligjshmërinë e asaj prove dhe çdo konsideratë tjetër praktike ose strategjike. Kjo rezulton në praktika divergjente nga prokurorë të ndryshëm dhe ndërmjet prokurorive. Për ta fuqizuar dhe harmonizuar këtë proces, në të gjitha prokuroritë, duhet që të përcaktohen më tej procedurat përkatëse. Sa i përket shqyrtimit gjyqësor të aktakuzave, gjyqtarët e seancave paraprake pothuajse gjithmonë i konfirmojnë aktakuzat.<sup>44</sup> Gjatë konsultimeve, praktikuesit e kësaj fushe shprehën shqetësimin se procedura për konfirmimin e aktakuzës është e pamjaftueshme në disa mënyra, duke përfshirë mungesën e një procedimi mjaftueshëm kontradiktor dhe kohën e pamjaftueshme për shqyrtimin e duhur të aktakuzës, veçanërisht në rastet komplekse.

## 8

### Rekomandim

#### **Përmirësimi i cilësisë dhe i praktikave në lidhje me shqiptimin e sanksioneve të individualizuara dhe proporcionale në rastet e KOK. Në mënyrë specifike:**

i. Gjyqtarët duhet të sigurohen që vendimet ofrojnë arsyetim të qartë dhe specifik për vendimin e dënimit, duke përfshirë zbatimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues dhe përdorimin e dënimeve me kusht. Një arsyetim i tillë duhet të ndihmojë gjithashtu që dënimet të jenë të individualizuara, proporcionale dhe bindëse.

<sup>44</sup> KLGJP i BeH, Raporti Vjetor 2022 (Sarajevë: HKLGJP i BeH) 57, duke konfirmuar se në vitin 2022, 98 për qind e aktakuzave të paraqitura janë konfirmuar.

ii. KP duhet të ndryshohet për ta hequr mundësinë e konvertimit të një dënimi me burgim deri në dhe duke përfshirë një vit në një gjobë për veprat e KOK të nivelit të lartë.

Në individualizimin e dënimeve, sanksionet duhet të jenë në proporcion me peshën e veprës penale dhe me rrethanat e autorit.

Gjyqtarët duhet të japin arsyetim të qartë se përse janë përdorur sanksione të caktuara penale, cilët faktorë janë marrë parasysh për ta përcaktuar dënimin dhe se si sanksioni e përmbush qëllimin e dënimit.

Në vendimet e shqyrtuara nga Projekti, cilësia e arsytimit në lidhje me dënimet e shqiptuara, duke përfshirë përdorimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues, ishte e dobët. Gjyqtarët prireshin të përdornin fjalë të përhershme për rrethanat rënduese dhe lehtësuese, pa dhënë një vlerësim individual të rrethanave të çështjes ose të autorit. Për më tepër, aktgjykimet u referoheshin “rrethanave shumë lehtësuese” si bazë për përdorimin e dispozitës për uljen e dënimit nën


minimumin e përcaktuar me ligj, pa arsyetuar se si këto rrethana lehtësuese e përmbushnin atë standard.<sup>45</sup> Vendimet gjithashtu nuk i referoheshin praktikës tjetër gjyqësore në lidhje me praktikën e dënimit.

Për shkak të mungesës së arsytimit adekuat, dënimet e shqiptuara shpesh ishin në kufirin e poshtëm të lejuar të dënimit dhe shqiptoheshin dënime me kusht. Kjo pasqyrohet në gjetjet dhe të dhënat e Projektit të marra nga KLGJP i BeH.

Grafiku 12, i dhënë më poshtë, ofron të dhëna të KLGJP të BeH mbi dënimet kundër autorëve në rastet e KOK; këto të dhëna i përfshijnë si aktgjykimet e shkallës së parë ashtu edhe ato përfundimtare dhe detyruese. Në vitin 2021, në dënimet e shqiptuara ndaj autorëve në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, pothuajse gjysma morën dënim me kusht.

<sup>45</sup> Shih reduktimi e ndëshkimit, KP BeH Neni. 49(1)(b); KP FBeH Neni. 50(1)(b); KP RS Neni. 53 (3); KP DB Neni. 50(1)(b).

## Dënimet në rastet e KOK në BeH



Grafiku 11 - Dënimet në rastet e KOK. Burimi: KLGJP BeH, mars 2024.

Këto tendenca mund të shihen edhe më qartë në rastet e finalizuara që janë monitoruar nga Projekti.


Nga 65 autorë të dënuar, vetëm 17 për qind u dënuan me burgim mbi 12 muaj; afërsisht 39 për qind kanë marrë një dënim me burgim prej 12 muajsh ose më pak; dhe 41.5 për qind morën një dënim me

kusht (shih Grafikon 12).

Të dhënat e pasqyrojnë edhe përdorimin e masave të sigurisë të ndalimit të një pune, veprimtarie apo detyre të caktuar si dhe gjobat si elemente shtesë të sanksionit.

Masat e sigurisë u shqiptuan ndaj 14 për qind të kryesve.

## Dënimet e shqiptuara ndaj kryesve në rastet përfundimtare



**Figure 12** - Dënimet ndaj 65 kryesve të dënuar (përfshirë personat juridikë) në rastet e monitoruara, të përfunduara, korrik 2021 - mars 2024.

Të katër KP-të e përmbajnë një dispozitë sipas së cilës, nëse një i dënuar, i dënuar me një vit ose më pak kërkon shndërrimin e dënimit me burgim në gjobë, gjykata duhet ta pranojë kërkesën.<sup>46</sup> Natyra e detyrueshme e kësaj dispozite, e cila kërkon që gjyqtarët ta plotësojnë kërkesën e të dënuarit pa marrë parasysh meritat e ndryshimit të dënimit, ngre shqetësime. Vetëm KP i BeH dhe i RS e kufizojnë përdorimin e kësaj dispozite në lidhje me disa vepra të rënda penale, por veprat e KOK nuk përfshihen në këto përjashtime.<sup>47</sup> Duke pasur parasysh zbatimin e gjerë të dispozitave për zvogëlimin e dënimit, shpesh të dënuarit – madje edhe për raste të rënda të KOK – e kanë mundësinë që ta konvertojnë dënimin

e tyre me burg në gjobë. Për veprat e motivuara nga lakmia, që shpesh përfshijnë shuma të konsiderueshme dëmi të pretenduar ekonomik ose përfitime të paligjshme, përdorimi i këtyre dispozitave mund të mos shërbejë si pengesë dhe madje mund të dërgojë një mesazh për përfitimin e krimeve të tilla. Nisur nga sa u tha më sipër, përdorimi dhe ndikimi i këtyre dispozitave në rastet KOK, duhet të vlerësohet më tej, me synimin për ta hequr këtë mundësi në rastet e KOK të nivelit të lartë.

Dispozita për zëvendësimin e dënimit me burgim me gjobë duket se përdoret gjerësisht. Grafiku i mëposhtëm i prezanton dënimet ndaj 63 autorëve në vendimet përfundimtare të cilët kanë

<sup>46</sup> Shih Zëvendësimi i Burgimit në KP të BeH, Neni. 42a; KP FBeH Neni. 43a; KP DB neni. 43a dhe Natyra e jashtëzakonshme e dënimit me burgim afatshkurtër në KP të RS Art. 46 (a) 2.

<sup>47</sup> Shih Zëvendësimi i Burgimit në KP të BeH, Neni. 42a(4) dhe Natyra e jashtëzakonshme e dënimit me burgim afatshkurtër në KP të RS Art. 46 (a) 4.

dënim me burgim ose burgim me kusht. Vetëm 17 për qind e autorëve u dënuan me burgim mbi 12 muaj dhe gati 39 për qind u dënuan me 12 muaj ose më pak. Nga 25 autorë të dënuar me burgim

prej 12 muajsh ose më pak, në momentin e shkrimit, 19 e kërkuan konvertimin në gjobë, e cila jepej në çdo rast, përfshirë edhe kur nuk ishte e detyrueshme. (shih Grafikon 13)

### Dënimet ndaj 63 kryesve



**Grafiku 13** - Dënimet ndaj 63 kryesve në rastet përfundimtare të monitoruara dhe përdorimi i dispozitës.

Shumë nga aktgjykimet e shqyrtuara nga Projekti nuk u referoheshin faktorëve specifikë ose nuk jepnin arsyetim për dënimin e shqiptuar. Më tej duke vënë në dukje se burgimi prej dymbëdhjetë muajsh ose më pak duhet të zëvendësohet me gjobë nëse kërkohet nga i pandehuri, dënimet duken të buta.

Kështu, duke pasur parasysh tërësinë e këtyre rrethanave – arsyetimi i dobët dhe përdorimi i shpeshtë i dënimeve të ulëta dhe dënimeve me kusht – ekziston rreziku që dënimet të duken, ose në fakt mund të jenë arbitrare, pasi atyre u mungojnë elementet që e tregojnë përpjesëtueshmërinë e dënimit.

**Të sigurohet që marrëveshjet për pranimin e fajësisë të përdoren në mënyrë strategjike dhe të drejtë në rastet e KOK dhe, kur është e përshtatshme, të sigurohet që përfitimi i paligjshëm, pagesa e dëmeve për palët e dëmtuara dhe/ose bashkëpunimi i të pandehurit të jenë pjesë e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë. Në mënyrë specifike:**

i. Kryeprokurorët e BeH, FBeH, RS dhe të Distriktit të Brçkos (DB) të BeH duhet që ta rivlerësojnë ndikimin e udhëzimeve mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë në rastet e KOK. Ky rivlerësim duhet që ta përfshijë një rishikim sasior dhe cilësor të vendimeve të shqiptuara pas marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në rastet e KOK. Udhëzimet e rishikuara duhet që ta adresojnë shqyrtimin e brendshëm të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë dhe modalitetet për bashkëpunimin e të pandehurve.

ii. Kryeprokurorët, zëvendës kryeprokurorët dhe prokurorët duhet të sigurohen që marrëveshjet për pranimin e fajësisë të përdoren në mënyrë strategjike për ta siguruar bashkëpunimin e të pandehurve në drejtim të marrjes së informacioneve dhe provave, dhe duhet që ta kërkojnë konfiskimin e pasurisë ose pagesën e dëmit ndaj palës së dëmtuar, kur kjo është e përshtatshme dhe e zbatueshme.

iii. Gjyqtarët duhet të sigurohen që prezumimi i pafajësisë së palëve të treta të respektohet në vendimet e bazuara në marrëveshjet për pranimin e fajësisë.

iv. Ligjvënësit në BeH, FBeH, RS dhe DB BeH, duke u bazuar në pozitën e ekspertit të dakorduar nga komuniteti ligjor, duhet që të miratojnë dispozita identike në KPP-të përkatëse për ta prezantuar dëshmitarin bashkëpunues ose bashkëpunëtorin e drejtësisë.

v. Komuniteti i ekspertëve ligjorë duhet që ta identifikojë një zgjidhje legislative për ta paraparë bashkëpunimin e të pandehurit brenda dispozitave përkatëse të KPP-së për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë dhe të propozojë që të gjitha ministritë e drejtësisë ta miratojnë atë.


Marrëveshjet për pranimin e fajësisë përdoren gjerësisht në rastet e monitoruara nga Projekti.

Në BeH, marrëveshjet për pranimin e fajësisë marrin formën e marrëveshjes së dënimit; gjegjësisht, prokurorët e paraqesin marrëveshjen në gjykatë për shqyrtim, duke rezultuar në një vendim penal, me mundësinë e ankesës në baza të kufizuara.<sup>48</sup> Gjykata mund ta refuzojë marrëveshjen, por nuk mund ta ndryshojë atë.<sup>49</sup> Në fund të vitit 2019, KLGJP i BeH ka lëshuar udhëzime për të gjithë kryeprokurorët për të nxjerrë instruksione detyruese lidhur me kriteret shtesë për marrëveshjet për pranimin e fajësisë në rastet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe në raste të tjera.<sup>50</sup> Udhëzimet synojnë që prokurorët të mos e propozojnë një

dënim nën minimumin e përcaktuar ligjërisht, një dënim më të butë ose një sanksion më pak se dy të tretat e sanksionit të pritshëm në procedimet penale. Si përjashtim, nëse pranimi i fajësisë e mundëson zbulimin e veprave të tjera penale ose të kryesve tjerë, konfiskimin e pasurisë ose pagesën e dëmit të dëmtuarit, prokurori mund të lidhë marrëveshje për pranimin e fajësisë nën minimumin e përcaktuar ligjor për veprën në fjalë.

Grafiku i mëposhtëm i paraqet rezultatet kundër 80 të pandehurve në lidhje me të gjitha rastet e përfunduara të monitoruara nga Projekti, duke treguar se marrëveshjet për pranimin e fajësisë janë përdorur për t'i zgjidhur procedimet për 67 për qind të të gjithë të pandehurve (shih Grafikon 14).

## Rezultatet në rastet e monitoruara



**Grafiku 14** - Rezultatet për 80 të pandehur në të gjitha rastet e monitoruara nga korriku 2021 deri në mars 2024

Edhe pse ka disa përjashtime, në shumë prej rasteve të shqyrtuara, prokuroria nuk e përdori marrëveshjen për pranimin e fajësisë për ta konfiskuar përfitimin e paligjshëm, për t'ua paguar dëmshpërblim palëve të dëmtuara apo për ta përfituar bashkëpunimin e të pandehurit në lidhje me zbulimin e aktiviteteve të tjera kriminale. Këto të dhëna e tregojnë një dështim të përdorimit strategjik të

marrëveshjeve për pranimin e fajësisë. Në veçanti, vërehet mungesa e konfiskimit të përfitimit të kundërligjshëm në vendimet e bazuara në marrëveshjet për pranimin e fajësisë; konfiskimi u urdhërua vetëm ndaj 33 për qind të të gjithë të pandehurve që nënshkruan marrëveshje për pranimin e fajësisë, kryesisht në rastet e krimit të organizuar të nivelit të lartë. (shih Grafikon 15).


<sup>48</sup> Shih marrëveshjet për pranimin e fajësisë në KPP BeH Neni 231; KPP FBeH Neni 246; KPP RS Neni 246; dhe KPP DB Neni. 231.

<sup>49</sup> Shih marrëveshjet për pranimin e fajësisë në KPP BeH Neni 231(5); KPP FBeH Neni 246 (5); KPP RS Neni 246(5); dhe KPP DB Neni. 231(5).

<sup>50</sup> Shih KLGJP i BeH, *Udhëzimet për udhëzimet detyruese mbi kriteret shtesë për marrëveshjet për pranimin e fajësisë në korrupsion të profilit të lartë, krim të organizuar dhe lloje të tjera të rasteve*, 28 nëntor 2019.



## Kryesit e dënuar në rastet me marrëveshje për pranimin e fajësisë



**Grafiku 15** - Konfiskimi i pasurisë ndaj 54 kryesve të dënuar në rastet e zgjidhura me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë të monitoruara nga Projekti.

Sa i përket zgjidhjes së kërkesave të parashtruara nga palët e dëmtuara, vetëm një aktgjykim i dhënë pas marrëveshjes për pranimin e fajësisë e trajtoi një kërkesë të tillë. Gjykata urdhëroi shfuqizimin e një transaksioni pasuror të paligjshëm që ishte pjesë e veprës penale. Si një shqetësim shtesë i vërejtur në lidhje me vendimet e bazuara në marrëveshjet për pranimin e fajësisë, shumë vendime dështojnë ta ruajnë prezumimin e pafajësisë së bashkëkryerësve të tjerë të dyshuar, veçanërisht në rastet e krimit të organizuar. Veprat e supozuara kriminale, siç përshkruhen në aktakuzë, zakonisht kopjohen fjalë për fjalë në aktgjykim, pa përjashtim të veçantë të

fakteve dhe/ose referencave ndaj të pandehurve që nuk janë objekt i aktgjykimit në fjalë për marrëveshjen e pranimit të fajësisë. Së fundi, kohëzgjatja e procedurave në rastet e përfunduara pas një marrëveshjeje mbi pranimin e fajësisë tregon se këto procedura zgjasin më shumë se një vit, gjë që nuk është veçanërisht efikase për procedurat e shkurtuara. Përdorimi i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë në fillim të procedurës i siguron përfitimet e procesit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke përfshirë efikasitetin, sigurimin e pasurive të paligjshme, zgjidhjen e kërkesave për kompensim dhe bashkëpunimin e të pandehurit.

## Përdorimi i mjeteve gjyqësore

10

### Rekomandim

**Të ndërmerren masa për ta shtuar aplikimin e hetimeve financiare, si dhe ngrirjen, konfiskimin dhe konfiskimin e zgjeruar të përfitimit të fituar në mënyrë të paligjshme. Më specifikisht:**

i. KLGJP i BeH dhe të gjithë kryeprokurorët duhet të jenë proaktivë në përcaktimin e modaliteteve për ta përmirësuar qasjen në informacionet financiare dhe pronësore të të dyshuarve/të pandehurve, duke përfshirë personat juridikë, duke e respektuar konfidencialitetin e procedurave dhe të drejtën e privatësisë. Institucionet përkatëse në të gjitha nivelet që e mbajnë një informacion të tillë duhet të përfshihen në këtë përpjekje, sipas fushëveprimit të tyre të punës dhe autoritetit.

ii. KLGJP i BeH në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të drejtësisë dhe Komisionin Gjyqësor të DB BeH, duhet të sigurohen që prokuroritë i kanë burimet e nevojshme buxhetore për t'i punësuar ose përndryshe të kenë qasje të gatshme tek ekspertët e specializuar financiarë, sipas nevojës, për t'i ndjekur penalisht dhe në mënyrë efektive rastet që përfshijnë çështje financiare komplekse, të dhëna mbi pronat dhe biznesin.

iii. Ministrinë e drejtësisë dhe Komisioni Gjyqësor i DB të BeH duhet:

- T'i rishikojnë dhe sipas nevojës, amendamentojnë të gjitha ligjet për dëshmitarët ekspertë për ta siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe për ta ofruar cilësinë e nevojshme.
- Të sigurohen që lista e ekspertëve e ofron ekspertizën e nevojshme në rastet e KOK.

iv. KLGJP i BeH së bashku me kryeprokurorët e BeH, FBeH, RS dhe DB të BeH, duhet t'i përditësojnë udhëzimet detyruese për kryerjen e hetimeve financiare për të trajtuar aspekte të tjera financiare të krimeve, duke përfshirë ngrirjen dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme dhe përdorimin e konfiskimit të zgjeruar.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare, korniza ligjore e BeH e parashikon një sërë masash për ngrirjen dhe konfiskimin e përfitimeve të paligjshme, duke përfshirë përdorimin e urdhrave të ndërmjetëm ose masave të sigurisë për ngrirjen e aseteve,<sup>51</sup> konfiskimin e përfitimeve të paligjshme,<sup>52</sup> dhe përdorimin e konfiskimit të zgjeruar.<sup>53</sup> Ligjet speciale në fuqi në FBeH, RS dhe DN të BeH e rregullojnë këtë gjithashtu.<sup>54</sup> Pavarësisht nga një kornizë ligjore dhe politike përgjithësisht e mjaftueshme, këto mjete të rëndësishme mbeten kryesisht të pashfrytëzuara.

Është bërë njëfarë progresi në përmirësimin e rikuperimit të aseteve në kuptimin e përmirësimit të mbledhjes së të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve prokuroriale, si dhe në klasifikimin e një hetimi financiar si një element i veçantë si për mbajtjen e të dhënave, ashtu edhe si pjesë e kuotës vjetore të punës së prokurorit. Megjithatë, kjo nuk i zgjidh plotësisht çështjet përkatëse.

Konsultimet me palët e interesuara nxorën në pah sfida në marrjen e informacionit financiar në kohë dhe konfidenciale në një mënyrë që nuk e kërcënon hetimin. Ndërkohë që është bërë njëfarë progresi me nënshkrimin e

memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet institucioneve përkatëse, duke lehtësuar kështu qasjen në të dhëna, nevojiten më shumë hapa për tu siguruar që prokurorët në të gjitha juridiksionet të kenë qasje të shpejtë në këtë informacion në lidhje me të gjitha burimet përkatëse të financave dhe në të dhënat për pronën dhe biznesin.

### **Dëshmitarët ekspert**

Përderisa ministritë përkatëse të drejtësisë dhe Komisioni Gjyqësor i DB të BeH mbajnë lista me një numër të madh ekspertësh financiarë, bartësit e funksioneve gjyqësore shprehën shqetësime gjatë konsultimeve me Projektin lidhur me mungesën e ekspertëve të kualifikuar, vonesat në dorëzimin e gjetjeve dhe potencialin për anshmëri në mesin e dëshmitarëve ekspertë. Pa përmirësime në cilësinë e dëshmitarëve ekspert ose në procedurat për angazhimin e tyre, rezultatet e hetimit mund të mos rezultojnë në sigurimin faktik të dëshmisë efektive të ekspertit gjatë gjykimit.

### **Udhëzime për hetimet financiare**

Gjyqësori ka ndërmarrë hapa për ta përmirësuar ngrirjen dhe konfiskimin e përfitimeve të paligjshme. Në janar të vitit 2019, KLGJP i BeH miratoi udhëzime

<sup>51</sup> Shih urdhrat e ndërsjella në Artet e KPP të BiH. 202 dhe 395; CPC FBIH Artet. 216 dhe 416; CPC RS Artet. 112 dhe 389; dhe CPC BD BiH Arts. 202 dhe 395.

<sup>52</sup> Shih Bazat e konfiskimit të të ardhurave nga krimi dhe mënyrat e konfiskimit të fitimit material të fituar përmes kryerjes së veprës penale, nenet e KP të BeH. 110 dhe 111; CC FBIH Artet. 114 dhe 115; CC RS Artet. 83 dhe 84; dhe CC BD BiH Arts. 114 dhe 115.

<sup>53</sup> Shih Konfiskimi i zgjeruar i fitimit material të fituar nëpërmjet kryerjes së një veprë penale në KP të BeH, Neni 110 (a); KP FBeH Neni 114a; KP BD Neni 114a dhe Neni 28 Ligji i RS për konfiskimin e të ardhurave nga krimi.


<sup>54</sup> Shih Ligjin e FBIH-së për konfiskimin e të ardhurave të veprës penale (Gazeta zyrtare e FBIH-së nr. 71/14) dhe Ligjin e RS-së për konfiskimin e produkteve të veprës penale (Gazeta zyrtare e RS nr. 66/18) dhe Ligjin e BD të BiH-së për konfiskimin e të ardhurave nga krimi (Gazeta Zyrtare BD BH nr. 29/16).

që u kërkonin kryeprokurorëve të nxjerrin instruksione detyruese për prokurorët që të urdhërojnë hetime financiare në rastet e korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimit të parave.<sup>55</sup>

Këto udhëzime, të cilat do të përfshiheshin më pas në udhëzimet detyruese të lëshuara nga kryeprokurorët, kërkojnë që ushtruesi i detyrës së prokurorit ta marr parasysh hapjen e një hetimi financiar për një listë të caktuar të veprave penale. Si i tillë, ndërsa ofron një pikënisje të dobishme, qëllimi i kufizuar i këtyre udhëzimeve e trajton vetëm një aspekt të një procesi kompleks. Për më tepër, si një komponent i veçantë i procesit hetimor, hetimet financiare u

përcaktuan si një çështje më vete në sistemin e menaxhimit të çështjeve prokuroriale, dhe për rrjedhojë, edhe si një rast i veçantë i kuotës vjetore për prokurorët.<sup>56</sup> Nomenklatura e re i lejon sistemit të menaxhimit të çështjeve që ta monitorojë përdorimin e hetimeve financiare dhe duhet t'i stimulojë prokurorët për të kryer hetime financiare, pasi duke bërë një gjë të tillë e prezanton edhe kuotën e tyre. Siç shihet në Grafikon 16, megjithëse hetimet financiare janë rritur që nga viti 2018, përdorimi i mjeteve të tilla mbetet i paqëndrueshëm, me numrin e të pandehurve nën hetim që varion nga viti në vit. Thënë kështu, siç u përmend më lart, përfshirja e hetimeve financiare në kuotën vjetore për prokurorët duket se shërben si një nxitje.

## Hetimet financiare



**Grafiku 16** - Hetimet financiare, sipas të pandehurit dhe sipas rastit, nga 2018 deri me 2023. Burimi: KLGJP i BeH, Mars 2024.


<sup>55</sup> KLGJP i BeH, Raporti Vjetor 2019 (Sarajevë: HJPC BiH, 2019), f. 55, i cili i referohet miratimit të udhëzimeve për kryeprokurorët për të nxjerrë udhëzime detyruese që përshkruajnë detyrimin për të kryer një hetim financiar gjatë kryerjes së një hetimi në raste të caktuara të korrupsionit, krimi i organizuar dhe pastrimi i parave.

<sup>56</sup> KLGJP i BeH, *Rregullore për Kuotat e Performancës për Prokurorët në Prokuroritë në BeH* (Gazeta Zyrtare e BiH nr. 6/2022, 31 janar 2022), *Službeni List- Pregled Dokumenta* (sluzbenilist.ba).

Megjithatë, të dhënat për ngrirjen dhe konfiskimin e përfitimeve të paligjshme e japin një pasqyrë të turbullt (shih Grafikon 17).

Rrallëherë urdhërohet konfiskimi i zgjeruar e edhe masat e sigurisë për ngrirjen e aseteve para vendimit përfundimtar janë të kufizuara.

### Ngrirja, konfiskimi dhe konfiskimi i zgjeruar



**Grafiku 17** - Ngrirja (masat e sigurisë), konfiskimi dhe konfiskimi i zgjeruar në BeH, nga 2020 deri në 2023. Burimi: KLGJP i BeH, mars 2024.

Këto gjetje janë në përputhje edhe me rezultatet e rasteve të monitoruara nga Projekti. Ndër rastet e përfunduara, vetëm 32 për qind e të gjithë kryesve


të dënuar iu nënshtruan konfiskimit të pasurisë, kryesisht në rastet e krimit të organizuar, dhe disa nga shumtat ishin deri në 100 BAM (50 €) (shih Grafikon 18 dhe 19).

### Konfiskimi



**Grafiku 18** - Konfiskimi i pasurisë së autorëve të dënuar në të gjitha aktgjykimet e dhëna, nga muaji korrik 2021 deri në muajin mars 2024

## Llojet e rasteve me pasuri të konfiskuar



**Grafiku 19** - Llojet e rasteve me pasuri të konfiskuar, raste të monitoruara, nga muaji korrik 2021 deri në muajin mars 2024.

Ndërkohë që kërkohet monitorim dhe analizë e mëtejshme e rezultateve të konfiskimit dhe marrjes së pasurisë, të dhënat tregojnë rezultate të pabarabarta.

Gjetjet e monitorimit të Projektit, siç përshkruhet më sipër, tregojnë nevojën për burime shtesë dhe për ngritje kapacitetesh për t’i fuqizuar aftësitë dhe ekspertizën në këtë fushë.

Megjithëse materialet cilësore të trajnimit dhe udhëzimet e përgjithshme mbi hetimet financiare dhe procedurat

për ngrirjen dhe konfiskimin e fitimeve të paligjshme janë zhvilluar,<sup>57</sup> nuk janë nxjerrë udhëzime më praktike dhe detyruese.<sup>58</sup>

KLGPJ i BeH është zotuar që t’i përpiloj udhëzimet në lidhje me përcaktimin e aspekteve financiare të veprave penale.<sup>59</sup> Kjo masë mund të zbatohet duke i përditësuar dhe zgjeruar udhëzimet detyruese tashmë ekzistuese të nxjerra nga kryeprokurorët për hetimet financiare në rastet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

<sup>57</sup> Shih Eldan Mujanović dhe Darko Datzer, botimet., *Manual mbi konfiskimin e fitimit të paligjshëm* (Sarajevë: Centar za istraživanje politike suprotstavljanja kriminalitetu, 2016) Oduzimanje\_imovinske\_koristi\_pribavljene\_krivicnim\_rubajelom; Qendra e Këshillave për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE), *Priručnik o djelotvornom oduzimanju imovinske koristi pribavljene krivičnim djelom u skladu s evropskim i međunarodnim standardima* (Qendra AIRE, Inicijativa Rajonale Kundër Korrupsionit).

<sup>58</sup> Eldan Mujanović, red., *Smjernice za postupanje nadležnih institucija u postupku za oduzimanje imovinske koristi pribavljene krivičnim djelom* (Sarajevë: Centar za istraživanje politike suprotstavljanja kriminalitetu, 2017).

<sup>59</sup> KLGJP BeH, *Axhenda e Reformës 2021-2023, Masa IV.1.13: Duhet të zhvillohen udhëzime specifike në lidhje me përcaktimin e aspekteve financiare të krimeve ... dhe përdorimin e rrethanave faktike për të vërtetuar këto elemente.*

# VII. Kosova

## Hyrje

Administrimi i drejtësisë në Kosovë në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit ("KOK") tregon progres dhe sfida. Zhvillimet pozitive përfshijnë miratimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021–2026<sup>60</sup> dhe miratimin e Planit Strategjik për Zgjidhjen Efektive të Rasteve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2022–2024.<sup>61</sup> Për më tepër, nënshkrimi i një deklaratë të përbashkët ("Deklarata e Përbashkët e Zotimit") nga palët kryesore të interesit në mars të vitit 2023 theksoi angazhimin e tyre për reformën në sektorin e drejtësisë dhe forcimin e sundimit të ligjit.<sup>62</sup> Përderisa nënshkruesit duken vërtetë të përkushtuar ndaj reformës në drejtësi, vazhdojnë të ekzistojnë mosmarrëveshjet në lidhje me ligjet ekzakta që duhet të ndryshohen dhe me përmbajtjen e nevojshme të ndryshimeve (përfshirë sistemin e kontrollit të integritetit).

Megjithatë, sfidat e vazhdueshme e përjetësojnë një perceptim të mosndëshkueshmërisë dhe e minojnë

besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Gjykatësit dhe praktikantët kanë vështirësi në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të Kodit të Procedurës Penale ("KPP") dhe një numër i madh i rasteve të KOK vazhdojnë që të kthehen për rigjykim. Kjo ndikon në zgjatjen e procedurave dhe shterimin e burimeve.

Ekziston mungesa e transparencës dhe qasjes në informacionet publike. Ekziston nevoja për përmirësimin e sistemeve të njoftimit lidhur me seancat gjyqësore dhe të statistikave më të sakta për funksionimin e sistemit të drejtësisë. Gjithashtu vazhdojnë përgjigjet e paqëndrueshme ndaj kërkesave për informacion. Edhe pse strategjitë e komunikimit janë miratuar, udhëzimet detyruese dhe mekanizmat monitorues nevojiten për ta siguruar efektivitetin e tyre. Për më tepër, mospërputhjet në praktikën gjyqësore, mungesa e udhëzimeve nga Gjykata Supreme dhe platformat e kufizuara elektronike për qasje në vendime, e cenojnë barazinë para ligjit.

<sup>60</sup> Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026 është në dispozicion në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/8EF86336-E250-4EA2-9780-D4B8F7E853B5.pdf> [qasur më 21 mars 2024]

<sup>61</sup> E disponueshme në: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK\\_Plani\\_Strategjik\\_per\\_zgjidhjen\\_efikase\\_te\\_lendeve\\_te\\_korrupsionit\\_dhe\\_krimit\\_te\\_organizuar\\_20\\_22\\_2024.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/11/KGJK_Plani_Strategjik_per_zgjidhjen_efikase_te_lendeve_te_korrupsionit_dhe_krimit_te_organizuar_20_22_2024.pdf) (in Albanian). [accessed on 21 March 2024]

<sup>62</sup> Ministria e Drejtësisë (MD), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Kryeprokurori në detyrë dhe Kryetari i Gjykatës Supreme ishin nënshkruesit fillestarë të "Deklaratës së Përbashkët të Zotimit" për reformën në drejtësi në mars 2023. Palët identifikuan objektivat kryesore për reformën gjyqësore në lidhje me përmirësimin e vlerësimeve të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, kontrolleve të integritetit, qëndrueshmërisë disiplinore të gjyqtarëve dhe statusit dhe zhvillimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Një raport i konsoliduar u hartua në vitin 2023 dhe u nda me palët përkatëse të interesit dhe organizatat ndërkombëtare.

Mbeten gjithashtu shqetësimet në lidhje me procedurat e ekzaminimit të dëshmitarëve, të drejtat e të pandehurve dhe me vonesat e përkthimit, të cilat ndikojnë në drejtësinë e procedurave. Efikasiteti i procedurave mbetet gjithashtu një problem, me një numër të lartë seancash të ri-caktuara dhe joproductive dhe shtyrje të gjata, pjesërisht për shkak të mungesës së afateve të qarta për caktimin e seancave gjyqësore dhe të rigjyqimeve.

Përdorimi i paqëndrueshëm i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve ("SMIL") dhe mbështetja tek të dhënat e hedhura në letër e pengojnë gjithashtu menaxhimin e rasteve.

Cilësia e aktakuzave në rastet e KOK priret të jetë e ulët, duke rezultuar me një shkallë të lartë të aktgjyqimeve liruese. Në vlerësimet e performancës së prokurorëve dhe gjyqtarëve vihet

theksi te kriteret sasiore, të cilat mund t'i japin përparësi shpejtësisë dhe vëllimit mbi cilësinë me qëllim të përmbushjes së kërkesave të performancës.

Për më tepër, përpunimi joefektiv i rasteve të KOK përkeqësohet nga nivelet e ulëta të konfiskimit të aseteve. Pavarësisht fitimeve të konsiderueshme të supozuara të paligjshme në shumë raste, konfiskimi është minimal, pjesërisht për shkak të mungesës së mirëkuptimit midis organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorëve për dobinë e hetimeve financiare efektive.

Për t'i trajtuar këto çështje sistemike, ky raport ofron rekomandime të cilat synojnë ta fuqizojnë kapacitetin e Kosovës për t'i ndjekur penalisht dhe për t'i gjykuar në mënyrë efektive rastet e KOK të nivelit të lartë, duke e përmirësuar kështu integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të saj të drejtësisë.



## Paanshmëria

1

### Rekomandim

#### Fuqizimi i transparencës dhe i qasjes në informacionet lidhur me rastet e KOK

i. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ("KGJK") duhet ta sigurojë publikimin dhe përditësimin e rregullt të informatave të sakta dhe me kohë lidhur me rastet e KOK, duke përfshirë oraret e seancave dhe aktgjykimet.

ii. KGJK, Këshilli Prokurorial i Kosovës ("KPK"), gjyqtarët dhe prokurorët duhet që ta përmirësojnë komunikimin me shoqërinë civile duke iu përgjigjur menjëherë, në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse kërkesave të tyre për informacion. Kjo përfshin:

- Mbajtjen e konferencave të rregullta për shtyp dhe të adresohen rastet me interes të lartë publik, veçanërisht i atyre që lidhen me rastet e KOK.
- Monitorimi dhe zbatimi i strategjive përkatëse të komunikimit.
- Përpilimi i udhëzimeve detyruese që i përcaktojnë standardet minimale për publikimin e informacioneve të rasteve.

iii. KPK duhet të krijojë mekanizma për ta siguruar një qasje konsistente ndaj publikimit të aktakuzave. Këta mekanizma duhet që t'i përfshijnë masat mbrojtëse të mjaftueshme për t'i mbrojtur të drejtat e privatësisë dhe për ta mbrojtur informacionin e ndjeshëm.

Monitorimi i proceseve gjyqësore, së bashku me konsultimet me median dhe shoqërinë civile, ka nxjerr në pah probleme lidhur me qasjen e publikut në informacion, duke përfshirë mungesën e një sistemi të besueshëm të njoftimit të seancave gjyqësore,<sup>63</sup> publikimin jo konsistent të vendimeve gjyqësore dhe përgjigjet e dobëta ndaj kërkesave të shoqërisë civile për informacion.<sup>64</sup>

Sigurimi i transparencës në procesin e drejtësisë, veçanërisht në rastet e KOK, e kërkon një ekuilibër të kujdesshëm midis interesit publik lidhur me procedurat dhe mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm. Prandaj, respektimi i kornizës ligjore dhe standardeve etike për ta shmangur komprometimin e privatësisë ose paragjykimin e procedurave është thelbësor, dhe për gjykatat dhe prokuroritë është e rëndësishme që të ekzistojnë strategji dhe udhëzime lidhur me komunikimin me publikun.

Projekti ka vërejtur se në vitin 2023 ka pasur një përmirësim të dukshëm në publikimin e aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit, krahasuar me vitin 2021 dhe 2022.

Megjithatë, janë identifikuar vonesa të vazhdueshme në publikimin e aktgjykimeve nga Gjykatat Themelore.

Në nivel institucional, publikimi i rregulloreve, buxheteve, planeve, raporteve dhe statistikave, së bashku me mbajtjen e konferencave të rregullta për shtyp, e rrit transparencën dhe llogaridhënien dhe e krijon besimin e publikut. KGJK dhe KPK kanë strategji gjithëpërfshirëse të komunikimit për ta shtuar transparencën dhe bashkëpunimin me mediat dhe shoqërinë civile.<sup>65</sup> Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme që Këshillat ta monitorojnë në mënyrë proaktive zbatimin e këtyre strategjive.

Udhëzuesi i Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë ("CEPEJ") për Komunikimin me Median dhe Publikun, për Gjykatat dhe Autoritetet Prokuroriale, ofron udhëzime të dobishme që mund të shërbejnë si pikë referimi për qasjen në informacion.<sup>66</sup> Përdorimi i sistemit SMIL për mbledhjen e të dhënave është gjithashtu jetik dhe do të sigurohet që informacioni i besueshëm dhe i përditësuar të jetë i disponueshëm për publikun nëpërmjet "Panelit të Performancës Gjyqësore".<sup>67</sup>

<sup>63</sup> Shqetësimet në lidhje me sistemet e njoftimit përfshinin publikimin e orareve të seancave pa emrat e të pandehurve dhe hyrjet e pasakta ose të munguara në platformë.

<sup>64</sup> Siç u tha gjatë një forumi diskutimi me median dhe shoqërinë civile më 10 prill 2023.

<sup>65</sup> Strategjia e Këshillit Prokurorial për Komunikimin e Sistemit Prokurorial 2021 – 2023 në dispozicion në <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Dokumente%20Strategjike/Strategy%20for%020%20the%20prosecutorial%20system%202021-2023.pdf> dhe Strategjia e Komunikimit të Këshillit Gjyqësor 2022 - 2024 në dispozicion në [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/03/KGJ\\_Komunitik-Strate](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/03/KGJ_Komunitik-Strate). [të dyja u arritën më 21 mars 2024].

<sup>66</sup> Në dispozicion në <https://rm.coe.int/cepej-2018-15-en-communication-manual-with-media/16809025fe>. Për një referencë shtesë krahasuese, shihni udhëzuesin e Anglisë dhe Uellsit për aksesin e mediave në gjykata në dispozicion në <https://www.gov.uk/government/publications/guidance-to-staff-on-supporting-media-access-to-courts-and-tribunals/jurisdictional-guidance-to-support-media-access-to-courts-and-tribunals-criminal-courts-guide-accessible-version>. [qasur më 21 mars 2024].

<sup>67</sup> Në dispozicion në: <https://www.gjyqesori-rks.org/performance-dashboard/?lang=en> [qasur më 21 mars 2024].

### Rritja e kapaciteteve të gjykatave për të funksionuar në mënyrë efektive në të dyja gjuhët zyrtare

- i. KGJK dhe KPK duhet t'i vlerësojnë nevojat e të gjitha Gjykatave Themelore dhe Prokurorive dhe të përcaktojnë se sa interpret dhe përkthyes do t'i vendosin në secilën prej tyre. Në këtë proces, ata duhet ta kenë prioritet ndarjen e burimeve për rastet urgjente dhe për rastet e vjetra (mbetura).
- ii. KGJK dhe KPK duhet t'i rishikojnë kriteret e kualifikimit dhe nevojat e vazhdueshme për trajnim për tu siguruar që interpretët dhe përkthyesit i posedojnë aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të punuar në mënyrë efektive brenda sistemit të drejtësisë.
- iii. Në afat të gjatë, KGJK dhe KPK duhet të sigurohen që kushtet e punësimit të jenë të përshtatshme për ta lehtësuar rekrutimin dhe mbajtjen e interpretve dhe përkthyesve profesionistë.

Interpretët dhe përkthyesit e trajnuar janë thelbësorë për ta lehtësuar pjesëmarrjen efektive në procese dhe për t'i realizuar të drejtat gjuhësore të të pandehurve. Ky parim pasqyrohet në Kushtetutë, KPP dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("KEDNJ"), të cilat në përgjithësi e ofrojnë të drejtën për ndihmë falas nga një përkthyes nëse i pandehuri nuk mund ta kuptojë gjuhën e procedurës.<sup>68</sup> Një nga shqetësimet mbizotëruese në

lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë lidhet me përkthimin dhe interpretimin e dobët në vazhdimësi. Projekti ka vënë re shqetësime në të 15 rastet e monitoruara ku është kërkuar interpretim ose përkthim. Përkthyesit e caktuar u zbulua se nuk i njohin termat ligjore ose aftësitë thelbësore të interpretimit. Projekti vuri re në të paktën 25 raste vonesa për shkak të mungesës së përkthyesve.

<sup>68</sup> Shih: Kushtetuta, neni 30; KPP, neni 14; dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6. Për më tepër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka deklaruar se detyrimi për të ofruar përkthim "nuk kufizohet në emërimin e thjeshtë të një përkthyesi, por edhe në ushtrimin e një shkalle kontrolli mbi përshtatshmërinë e interpretimit". GJEDNJ, Cuscani kundër Mbretërisë së Bashkuar, 24 shtator 2002, në dispozicion në [https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:\[%22002-5182%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/fre#{%22itemid%22:[%22002-5182%22]}) [qasur më 21 mars 2024].

Gjithashtu, vonesat dhe ndërprerjet e shkaktuara nga mungesa e pajisjeve për përkthim të njëkohshëm në sallat e gjyqit, ose problemet teknike me pajisjet ekzistuese janë vërejtur në të paktën 28 raste.

Projekti i ka vërejtur po ashtu sfidat lidhur me sigurimin e aktakuzave dhe dosjeve të lëndëve të përkthyer, më çka janë shkaktuar vonesa nga dy deri në gjashtë muaj në pesë raste të KOK të nivelit të lartë. Rregulloret e miratuara të KGJK-së, kodi i etikës dhe doracaku

për interpretues dhe përkthyes janë zhvillime të mirëseardhura që mund t'i adresojnë disa nga sfidat e përmendura më lartë.<sup>69</sup>

Megjithatë, gjatë konsultimeve, shpesh është raportuar se pagat e ulëta e përfaqësojnë një pengesë për rekrutimin dhe mbajtjen e interpretëve dhe përkthyesve të kualifikuar. Kjo e sugjeron nevojën për masa për ta krijuar një mjedis që i tërheq dhe i ruan profesionistët e aftë në fushën e interpretimit dhe përkthimit.

### 3

## Rekomandim

### **Sigurimi i ndihmës juridike efektive për të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale**

- i. KGJK, KPK dhe Oda e Avokatëve të Kosovës ("OAK") duhet të bashkëpunojnë për të përpiluar udhëzime detyruese, duke përfshirë afatet kohore të detajuara, për tu siguruar që mbrojtja të ketë qasje në prova dhe materiale gjatë fazës paraprake në përputhje me KPP.
- ii. Gjykatat duhet të sigurohen që të jenë të disponueshme ambientet për konsultime private avokat-klient përpara seancave dhe të lejojnë kohë të mjaftueshme për konsultime të tilla.
- iii. OAK duhet të hartojë udhëzime për avokatët mbrojtës ku do të përfshihen standardet minimale për përgatitjen, këshillimin dhe përfaqësimin e rasteve.

<sup>69</sup> Më 21 qershor 2023, KGJK miratoi dokumentet në vijim: i) Rregulloren nr. 07/2023 për procedurën e certifikimit, emërimin, kushtet, të drejtat, detyrimet, shpërblimin dhe disiplinën e përkthyesve dhe përkthyesve gjyqësorë; ii) Doracaku për punën e përkthyesve dhe përkthyesve në gjyqësorin e Kosovës; dhe iii) Kodin e Etikës për Përkthyesit Gjyqësorë dhe/ose Përkthyesit dhe Përkthyesit e Certifikuar dhe të Emëruar. Në kohën e hartimit, vetëm Rregullorja 07/2023 është e disponueshme në internet: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/29119\\_KGJK\\_Rregullore\\_07\\_2023\\_per\\_perkthyes\\_dhe\\_interpret\\_gjyqesore.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/29119_KGJK_Rregullore_07_2023_per_perkthyes_dhe_interpret_gjyqesore.pdf) [qasur me 21 mars 2024]

iv. OAK duhet ta krijojë një mekanizëm për adresimin e ankesave të marra nga gjykatat në lidhje me sjelljen e anëtarëve të saj dhe të sigurohet që gjetjet disiplinore të jenë të disponueshme për publikun, duke respektuar gjithashtu të drejtat e privatësisë.

Sipas KPP-së, mbrojtja ka të drejtë në një kopje të aktakuzës dhe që t'i shqyrtojë shkresat e lëndës para seancës fillestare.<sup>70</sup> Projekti ka vënë re raste kur prokurori nuk i ka dhënë mbrojtjes qasje në këto dokumente thelbësore. Rrjedhimisht, në 16 lëndë të monitoruara janë shtyrë seancat për mos dorëzimin e aktakuzës dhe/ose shkresave të lëndës,<sup>71</sup> duke shkaktuar vonesa nga dy deri në 24 javë.<sup>72</sup>

Në tetë raste të monitoruara, me shumë të pandehur, Projekti ka vënë re hapësirë të kufizuar në sallën e gjyqit dhe ardhjen me vonesë të të pandehurve nga qendrat e paraburgimit gjë e cila e ka penguar mundësinë e avokatëve mbrojtës për t'u konsultuar me klientët e tyre.

Projekti ka observuar 24 raste në të cilat avokatët mbrojtës ofruan përfaqësim me cilësi të dobët për shkak të përgatitjes joadekuate. U vu re se trupat gjykues përgjithësisht nuk ndërhyjnë në këto raste. Për të siguruar përfaqësim efektiv ligjor, gjykatat duhet

të ushtrojnë mbikëqyrje duke përdorur kompetencat e përcaktuara në KPP. Megjithatë, konsultimet me gjyqtarët konfirmuan se masa e vetme për t'i adresuar shqetësimet në lidhje me punën e avokatëve mbrojtës të udhëzuar privatisht është raportimi i avokatit në OAK për masa disiplinore.

Kjo do të ishte e përshtatshme vetëm në raste të rënda. Megjithatë, ajo duhet të zbatohet kur është e nevojshme. Fatkeqësisht, gjyqtarët dhe prokurorët kanë raportuar se OAK rrallë u përgjigjet kërkesave për masa disiplinore dhe/ose nuk ishin të informuar fare për rezultatin e ankesave. Nëse është e saktë, kjo sugjeron një mungesë shqetësuese respekti ndaj kërkesave të gjykatës dhe mund të kontribuojë në ndjenjën e mosndëshkimit tek avokatët që nuk i respektojnë standardet profesionale. Gjatë konsultimeve, KGJK, KPK dhe OAK kanë raportuar se nuk ka mekanizëm për zgjidhjen e kësaj çështjeje, pasi nuk ka takime të rregullta apo platforma për t'i diskutuar çështjet ndërmjet institucioneve.

<sup>70</sup> KPP, neni 239, "Materialet të cilat i jepen të pandehurit me ngritjen e aktakuzës".

<sup>71</sup> Dispozitat e këtij neni i nënshtrohen masave për mbrojtjen e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve. Neni 239, par. 5 të KPP-së të miratuar së fundmi, thuhet: "Kur prokurori i shtetit nuk respekton detyrimet nga paragrafi 1. i këtij neni, njoftohet kryeprokurori i zyrës".

<sup>72</sup> Në dy raste, vonesat janë shtuar për shkak të nevojës për përkthimin e shkresave të lëndës.

OAK duhet t'i marrë parasysh udhëzimet më efektive për avokatët mbrojtës. Këto udhëzime duhet që t'i përfshijnë standardet minimale për përgatitjen, këshillimin dhe përfaqësimin e rastit. Një udhëzim i tillë do të ndihmonte në vendosjen e standardeve për

përfaqësimin e mbrojtjes penale dhe do ta siguronte një pikë referimi për ta përcaktuar se kur mund të garantohet ndërhyrja. Zbatimi i udhëzimeve duhet të mbështetet përmes trajnimeve gjithëpërfshirëse për ta përmirësuar nivelin e përfaqësimit.

## 4

### Rekomandim

**Sigurimi i zbatimit të vazhdueshëm të ligjit në përputhje me standardet ndërkombëtare, veçanërisht me ato të përcaktuara nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE).**

i. Inkurajimi i gjykatave të instancave më të ulëta që t'i referohen praktikës gjyqësore të gjykatave më të larta, veçanërisht kur merren me çështje të interpretimit. Gjykata Supreme duhet të ofrojë udhëzime për çështje të ndërlikuara të ligjit/interpretimit.

ii. Rritja e numrit të takimeve ndërmjet gjyqtarëve nga instanca të ndryshme gjyqësore dhe përpilimi i një përmbledhjeje të vendimeve të përzgjedhura për trajtimin e rasteve të ndërlikuara dhe të nivelit të lartë të KOK.

iii. KGJK duhet të sigurohet lidhur me publikimin në mënyrë konsistente dhe me kohë të aktgjykimeve, veçanërisht të aktgjykimeve të gjykatave më të larta.

Gjykatësit raportuan marrëdhënie jo të kënaqshme vertikale brenda sistemit gjyqësor. Në veçanti, nuk ka takime të mjaftueshme ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së

Apelit me gjyqtarët e Gjykatës Themelore dhe atyre të Degëve me qëllim të promovimit të praktikës së mirë dhe të qëndrueshme gjyqësore. Për më tepër, konsultimet treguan se

gjykatat e shkallëve më të ulëta shpesh hezitojnë të kërkojnë opinione juridike nga Gjykata Supreme.<sup>73</sup> Gjithashtu u raportua se gjyqtarët e shkallëve më të ulëta nuk janë proaktivë në hulumtimin dhe zbatimin e jurisprudencës së gjykatave më të larta. Kjo gjë e kufizon aftësinë e gjykatave më të larta për t'i adresuar sfidat në interpretimin e ligjit dhe për ta promovuar harmonizimin, duke çuar në një mospërputhje gjithnjë në rritje.

Në dhjetor të vitit 2023, Gjykata Supreme i miratoi dy udhëzime. I pari, i titulluar "Vendimet e zgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës",<sup>74</sup> përmban një përmbledhje të vendimeve kyçe në fushën e lëndëve penale dhe civile që synojnë unifikimin e praktikës gjyqësore. E dyta, e titulluar "Përmbledhje e praktikës së Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile",<sup>75</sup> ofron zgjidhje për sfidat me të cilat përballen gjyqtarët në çështjet penale dhe civile, duke përfshirë udhëzimet për zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ"). OSBE i mirëpret këto publikime dhe do të vazhdojë ta monitorojë ndikimin e tyre.

Inkurajohet miratimi i udhëzimeve të ngjashme për adresimin e çështjeve sfiduese në rastet e ndërlikuara të KOK me shumë të pandehur.

Pavarësisht vëllimit të ligjeve të reja që kanë hyrë në fuqi, duke përfshirë një Kod të ri Penal ("KP") në 2019 dhe KPP në vitin 2023, Projekti ka vënë re një rënie të numrit të opinioneve të dhëna nga Gjykata Supreme që nga viti 2016.<sup>76</sup> Për më tepër, kur ka aktgjykime, vendime të KGJK-së, apo udhëzime të tjera të reja që ndikojnë në praktikën gjyqësore, është thelbësore që gjyqtarët të jenë të informuar. Në këtë drejtim, përditësimet e rregullta profesionale ose njoftimet e tipit paralajmërues në SMIL mund të shërbejnë për ta paralajmëruar gjyqësorin për zhvillime të rëndësishme profesionale.

Projekti gjithashtu ka vënë re se gjykatat rrallë i referohen jurisprudencës ekzistuese. Në fakt, kishte vetëm dy raste të monitoruara ku Gjykata e Apelit iu referua praktikës gjyqësore – në të dyja rastet, gjyqtarët cituan vendimet e GJEDNJ.<sup>77</sup> Gjatë konsultimeve, disa gjyqtarë shprehën shqetësime rreth përdorimit të mundshëm selektiv të jurisprudencës për ta favorizuar një

<sup>73</sup> Bazuar në Nenin 26(1.4), Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, Gjykata Supreme është kompetente dhe " përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës".

<sup>74</sup> Në dispozicion në: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/26927\\_Permbledhje%20me%20vendime%20t%C3%AB%20p%C3%ABrzgjedhura%20t%C3%AB%20Gjykat%C3%ABs%20Supreme%202023.PDF](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/26927_Permbledhje%20me%20vendime%20t%C3%AB%20p%C3%ABrzgjedhura%20t%C3%AB%20Gjykat%C3%ABs%20Supreme%202023.PDF) [qasur më 21 mars 2024]

<sup>75</sup> Në dispozicion në: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/76246\\_Permbledhje%20nga%20praktika%20e%20Gjykates%20Supreme,%20ne%20ceshtjet%20penale%20dhe%20civil%20](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/76246_Permbledhje%20nga%20praktika%20e%20Gjykates%20Supreme,%20ne%20ceshtjet%20penale%20dhe%20civil%20) [qasur më 21 mars 2024]

<sup>76</sup> Në vitin 2016, Gjykata e Lartë ka nxjerrë 15 opinione ligjore (me numra të ngjashëm të lëshuar në vitet e mëparshme). Megjithatë, ndërmjet 2017 dhe 2023 janë lëshuar gjithsej vetëm dhjetë opinione ligjore. Shih, <https://supreme.gjyqesori-rks.org/mendimet-juridike/?cYear=2023>. [qasur më 21 mars 2024]

<sup>77</sup> Zbatueshmëria e jurisprudencës së GJEDNJ-së është padyshim më e qartë sepse përkufizohet në nenin 53 të Kushtetutës, i cili thotë: "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet e gjykatës të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."

interpretim të preferuar. Kjo e nënvizon nevojën për udhëzime të qarta se kur dhe si gjykatat mund t'i referohen siç duhet jurisprudencës së gjykatave më të larta.

Kërkohet një ndryshim i rëndësishëm në praktikë për ta inkurajuar referencën në jurisprudencën ekzistuese dhe për t'i qartësuar detyrimet e palëve në këtë drejtim. Kjo praktikë nuk duhet të konsiderohet si kërcënim për pavarësinë e gjyqësorit. Përkundrazi, ai

duhet parë si një mjet për ta siguruar zbatimin uniform të ligjit. Janë ndërmarrë hapa thelbësorë për ta rritur publikimin e vendimeve<sup>78</sup> Në vitin 2023, shumica e aktgjykimeve janë publikuar në faqen zyrtare të KGJK-së, duke bërë të mundur hulumtimin e procedurave juridike.<sup>79</sup> Megjithatë, faqja e internetit mund të jetë më miqësore për përdoruesit dhe veçoritë e kërkimit duhet të rafinohen për ta mundësuar identifikimin e saktë të rasteve.

5

Rekomandim

### Sigurimi i paanshmërisë së gjykatës dhe perceptimi i saj

i. Ofrimi i trajnimeve praktike për gjyqtarët lidhur me menaxhimin e sallës së gjyqit dhe me kryerjen e procedurave në mënyrë profesionale dhe të paanshme në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në 15 raste të monitoruara, Projekti ka hasur në komente të papërshtatshme të bëra nga gjyqtarët dhe prokurorët të cilat e cenonin perceptimin e paanshmërisë dhe prezumimin e pafajësisë. Për shembull, në një rast korrupsioni të nivelit të lartë, pasi një dëshmitar iu referua të pandehurit si "njeri i mirë", një nga anëtarët e trupit gjykues u përgjigj: "Nëse i pandehuri është një

person i mirë, atëherë pse mendoni se ai akuzohet?" Edhe pse kjo deklaratë e minoi perceptimin e paanshmërisë së gjykatës dhe e cenoi prezumimin e pafajësisë së të pandehurit, mbrojtja nuk e kërkoi përjashtimin e gjyqtarit.<sup>80</sup> Në një rast tjetër korrupsioni të nivelit të lartë, pasi një dëshmitar bëri një koment pozitiv për karakterin e të pandehurit, kryetari i trupit gjykues tha:

<sup>78</sup> Sipas raportit të Lëvizjes FOL për monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar - dhjetor 2022), ka pasur një rritje të publikimit të vendimeve gjyqësore prej 41% në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 (2021: 24.593 aktgjykime të publikuara; në vitin 2022: 34.694. ). KGJK ka kërkuar përkushtim edhe më të madh në publikimin e vendimit të gjykatës për rritjen e nivelit të transparencës. Shiko, <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2023/03/Monitorimi-i-publikimit-te-vendimeve-gjyqesore.pdf>. [qasur më 21 mars 2024]

<sup>79</sup> eKosova është një portal ku shërbimet publike ofrohen online. Në dispozicion në <https://ekosova.rks-gov.net/Service/10> [qasur më 21 mars 2024]

<sup>80</sup> Neni 38(3), KPP, "[një] gjyqtari mund të përjashtohet gjithashtu nga ushtrimi i funksioneve gjyqësore në një çështje të caktuar nëse [...] paraqiten rrethana që e bëjnë të dyshimtë paanshmërinë e tij/saj".



“Nuk po e varim atë”. I njëjti gjyqtar komentoj shënimet që dëshmitari kishte përgatitur për të ndihmuar kujtesën e tij duke thënë: “Po, ne e dimë se sa të përgatitur jeni”. Gjithashtu, gjatë marrjes në pyetje të këtij dëshmitari, i cili më herët ishte i ndaluar për të njëjtën çështje, prokurori ka komentuar: “Është e pabesueshme që ju jeni liruar”.

Në shumicën e rasteve me shumë të pandehur, trupat gjyquese u përpoqën ta ruanin rendin, herë pas here duke përdorur masa që mund të perceptoheshin si të pjesshme. Monitoruesit e procesit gjyqësorë vunë re çështje si zbatimi jo konsistent i rregullave të marrjes në pyetje të dëshmitarëve, duke e minuar sërish perceptimin e paansisë. Për shembull, në disa raste, gjyqtarët lejuan palët që

t'i pyesin dëshmitarët disa herë, megjithëse KPP lejon vetëm marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe rimarrjes në pyetje.<sup>81</sup>

Për më tepër, në të paktën 16 raste, gjyqtarët hodhën poshtë propozimet dhe kundërshtimet e palëve pa dhënë arsytetime të bazuara mirë.

Shumë nga shqetësimet e vërejtura kanë qenë të lidhura me menaxhimin e dobët dhe/ose të papërshtatshëm të sallës së gjykimit. Akademia e Drejtësisë së Kosovës (ADK) duhet të ofrojë trajnime praktike dhe cilësore për prokurorët lidhur me teknikat e ekzaminimit dhe për gjyqtarët lidhur me ruajtjen e rendit dhe kryesimin në mënyrë të paanshme. Kjo do ta rriste cilësinë e drejtësisë që ofrohet dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësorë.

## Efikasiteti

6

### Rekomandim

**Përmirësimi i monitorimit të rasteve për t'i identifikuar shkaqet rrënjësore të vonesave dhe për t'i përcjellur në mënyrë proaktive gjykimet e gjata.**

i. KGJK duhet ta krijojë një mekanizëm për raportimin e rasteve që hasin në vonesa të rënda, ta identifikojë shkakun e vonesave dhe t'i përcaktojë masat përmirësuese.

<sup>81</sup> KPP, nenet 328-331. Nuk ka asnjë dispozitë për t'u dhënë palëve një mundësi për një raund tjetër provimi të kryqëzuar ose ridrejtim të ekzaminimit. Për më tepër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar rëndësinë e paanshmërisë për akses të drejtë në drejtësi në çështjen García Ruiz kundër Spanjës, 24 janar 1999, në dispozicion në: GARCÍA RUIZ kundër SPAIN (coe.int), Piersack kundër Belgjikës, 1 tetor 1982, i disponueshëm në PIERSACK kundër BELGJIKËS (coe.int), dhe Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 shkurt 1997, i disponueshëm në: FINDLAY kundër Mbretërisë së Bashkuar (coe.int) [të gjitha u ngjitën më 25 mars 2024]

## Rekomandim


ii. KGJK duhet t'i rishikojë rregullat dhe rregulloret e brendshme të cilat ndikojnë në ecurinë e rasteve. Këtu duhet përfshirë vlerësimin e zbatimit praktik të rregullave për ngritjen në detyrë, daljen në pension dhe riuemërimin për tu siguruar që disponueshmëria e juristëve të mos i vonojë procedurat.

Që nga korriku i vitit 2021, OSBE i ka monitoruar 16 raste që kanë përfunduar. Kohëzgjatja e procedurës, nga ngritja e aktakuzës deri në nxjerrjen e aktgjykimit përfundimtar, shkonte

nga një deri në 120 muaj.

Në veçanti, në 12 raste (75 përqind) u deshën më shumë se 24 muaj për ta marrë një vendim përfundimtar.

### Kohëzgjatja e procedurës nga aktakuza deri në aktgjykimin përfundimtar në muaj




Grafiku 20 - Kohëzgjatja e procedurës nga aktakuza deri në aktgjykimin përfundimtar në muaj

Seancat dëgjimore joproductive doli se ishin arsyeja kryesore për vonesat e procedimeve në rastet e KOK të nivelit të lartë dhe të mesëm. Në total, 30 për qind e të gjitha seancave të monitoruara ishin ose "joproductive"

ose "të ricaktuara".<sup>82</sup> Duke parë grafikun e mëposhtëm, është thelbësore të theksohet se progresi në kuptim të efikasitetit të proceseve gjyqësore, e ndjek një model sporadik dhe të paparashikueshëm.

<sup>82</sup> Seancat dëgjimore përkufizohen si "joproductive" nëse nuk ndodh asgjë thelbësore gjatë seancës dhe/ose çështja nuk përparon. Seancat përshkruhen si të "ricaktuara" kur data e seancës ndryshohet paraprakisht dhe palët njoftohen, duke shmangur nevojën për të marrë pjesë në gjykatë.

## Seancat produktive kundrejt jo-produktive dhe të ricaktuara gjatë fazës së monitorimit




**Grafiku 21** - Seancat produktive kundrejt seancave joproduktive dhe seancat e ricaktuara

Arsyeja më e zakonshme për seancat joproduktive ishte mungesa e një ose më shumë palëve, d.m.th. mungesa e të pandehurit, dëshmitarit,

avokatit mbrojtës ose prokurorit. Ky ishte shkak kryesor në 88 nga 126 seancat joproduktive (70 përqind).

## Arsyet për Seancat Jo-Produktive



**Grafiku 22** - Arsyet për Seancat Jo-Produktive

Rastet me tre seanca të njëpasnjëshme joproductive ose rastet e shtyra për më shumë se tre muaj duhet ta nxisin një mekanizëm për analiza dhe masa korrigjuese.

Një faktor tjetër që shkakton vonesë është aplikimi i rigjytimeve. Për shembull, monitoruesit e kanë vëzhguar një rast në të cilin Gjykata e Apelit i shfuqizoi dënimet e të pandehurve në Gjykatën Themelore (shkalla e parë) në tri raste të ndara dhe çdo herë e kthente rastin në rigjykim. Në rigjykimin e tretë, Gjykata Themelore i liroi të pandehurit.<sup>83</sup> Nuk ekziston një afat për fillimin e rigjyimit pas kthimit të një çështjeje nga Gjykata e Apelit dhe nuk ka kufizim sa i përket numrit të herave që një çështje mund të kthehet në rigjykim.

Gjatë konsultimeve, gjyqtarët shprehën shqetësime lidhur me ngarkesat e tepërta të punës, veçanërisht në Departamentin Special, në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Caktimi i tre gjyqtarëve shtesë në këtë departament ishte një zhvillim pozitiv.

Megjithatë, dy vende të tjera të zbrazëta kanë mbetur të hapura që atëherë.<sup>84</sup> Prokuroria Speciale (PSRK) do t'i rekrutojë nëntë prokurorë shtesë në vitin 2024.<sup>85</sup> Megjithatë, që kjo të rezultojë në efikasitet të përmirësuar, duhet të ketë gjyqtarë të mjaftueshëm brenda Departamentit Special.

Gjyqtarët gjithashtu u ankuan se mungesa e zyrtarëve ligjorë dhe e personelit administrativ paraqet pengesë për një procedim më efektiv të rasteve.

Shumë gjyqtarëve u mungojnë zyrtarët ligjorë ose të trajnuar për ta mbështetur punën e tyre. KGJK dhe KPK duhet ta sigurojnë një vlerësim të vazhdueshëm të nevojave të gjykatave dhe departamenteve të ndryshme, duke e marrë parasysh jo vetëm numrin e lëndëve, por edhe natyrën dhe ndërlikueshmërinë e tyre.

<sup>83</sup> Aktakuza është ngritur në vitin 2014. Aktgjykimet e Gjykatës Themelore janë lëshuar në vitin 2017, 2018 dhe 2020 me disa ose të gjithë të pandehurit të dënuar. Aktgjykimet përfundimtar i Gjykatës Themelore në vitin 2023 u shpall të pafajshëm të gjithë të pandehurit.

<sup>84</sup> Për shkak të vdekjes së një gjyqtari dhe daljes në pension të një tjetri. Përveç kësaj, Projekti është informuar se një gjyqtar i tretë i Departamentit Special do të pensionohet në korrik 2024.

<sup>85</sup> Që nga viti 2019, Departamenti Special ka juridiksion për të gjitha rastet e ndjekura nga PSRK-ja.

### Përmirësimi i praktikave lidhur me përdorimin e pranimit të fajësisë në shqyrtim dhe atij të negociuar

- i. Inkurajimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve që t'i përdorin deklaratimet e rregullta dhe të negociuara të fajësisë në rastet e duhura.
- ii. Zyra e Kryeprokurorit duhet që ta përditësojë Udhëzimin për Marrëveshjet e Negociuara të Pranimit të Fajësisë dhe ta monitorojë zbatimin e tij.
- iii. Gjykata Supreme duhet që të hartojë udhëzime për pranimin e fajësisë, duke përfshirë rastet kur gjykatat duhet ta pranojnë një pranim fajësie dhe një qasje të duhur ndaj dënimit.

Pranimet e fajësisë, qofshin të negociuara apo të rregullta, dhe vullnetare, konzervojnë burime të kufizuara gjyqësore. Në rastet kur provat janë të mjaftueshme dhe i pandehuri e pranon përgjegjësinë vullnetarisht, deklaratat e pranimit mund të ofrojnë një zgjidhje efektive për çështjen duke ndihmuar menaxhimin efikas të çështjes dhe përdorimin e burimeve, veçanërisht në rastet e ndërlikuara të KOK.<sup>86</sup>

Në Kosovë, Projekti (i konfirmuar nga palët e interesit) e vërejt një përdorim të ulët të pranimit të fajit, veçanërisht në rastet e nivelit të lartë.

Ligji i Kosovës e lejon uljen e dënimeve pas pranimit të fajësisë.<sup>87</sup> Kjo është e përshtatshme duke qenë se pranimi i përgjegjësisë dhe pasojat për një administrimin efikas të drejtësisë janë faktorë të rëndësishëm lehtësues.

<sup>86</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Transnacional sugjeron që dënimi mund të zbutet kundër personave "të cilët ofrojnë bashkëpunim thelbësor në hetimin ose ndjekjen penale" të krimin të organizuar dhe veprave të lidhura me to. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Transnacional, Art. 26 (2). GJEDNJ ka pohuar se "marrëveshja për pranimin e fajësisë" nuk cenon në vetvete të drejtën për një gjykim të drejtë dhe mund të kontribuojë në procedura efikase, ulje të ngarkesës gjyqësore dhe të shërbejë si "një mjet i suksesshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar". Natsvlshvili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë, Nr. 9043/05, 29 prill 2014, para. 90.

<sup>87</sup> 2023 KPP, Neni 230

Megjithatë, dënimi duhet të mbetet proporcional dhe nuk duhet ta mundësojë mosndëshkimin. Të drejtat e të pandehurve, duke përfshirë qasjen në këshilla ligjore efektive që i përvijojnë të gjitha pasojat e pranimit të fajit, duhet të mbrohen.

Në katër raste të monitoruara, të pandehurit e kanë shprehur synimin që ta pranojnë fajësinë. Megjithatë, gjykata i hodhi poshtë deklaratat e tyre të fajësisë. Në dy raste, pretendimet u refuzuan për shkak se të bashkëpandehurit po e kundërshtonin çështjen, dhe gjykata arsyetoi se ata, për rrjedhojë, duhej të dilnin në gjyq.<sup>88</sup> Në dy rastet e tjera, gjykata konstatoi se baza e pranimit të fajësisë nuk korrespondonte me faktet e pretenduara.<sup>89</sup> Këto raste ilustronë disa nga sfidat për gjykatat në interpretimin e dispozitave të pranimit të fajësisë së rregullt dhe të negociuar (PFN).

Në vitin 2021, Zyra e Kryeprokurorit ka nxjerrur udhëzime për përdorimin e PFN-së.<sup>90</sup>

Vlen të përmendet se mosrespektimi i udhëzimeve konsiderohet shkelje e Kodit të Etikës së Prokurorëve.<sup>91</sup> Megjithatë, udhëzimi duhet të përditësohet për t'i pasqyruar ndryshimet e fundit legjislative dhe për ta monitoruar zbatimin, veçanërisht të dispozitave për konfiskimin dhe kompensimin që pason pas një PFN-je.

Udhëzime të ngjashme nga Gjykata Supreme mund të ndihmojnë në harmonizimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Në tre aktgjykime pas pranimit të fajësisë,<sup>92</sup> gjykata nuk arriti që ta ruajë prezumimin e pafajësisë për të bashkëpandehurit të cilët nuk e kishin pranuar fajësinë. Në këto aktgjykime, çështja e prokurorisë është kopjuar në aktgjykim pa e përjashtuar referencën për të pandehurit të cilët kanë vazhduar të kundërshtojnë pretendimet. GJEDNJ-ja ka deklaruar se vendimet e marra në bazë të pranimit të fajësisë duhet që ta mbrojnë prezumimin e pafajësisë për bashkë-kryerësit e tjerë të dyshuar.<sup>93</sup>

<sup>88</sup> Në të dyja rastet, veprat pretendohet se janë kryer në "bashkëkryerje".

<sup>89</sup> KPP, Neni 242 (2.3)

<sup>90</sup> Udhëzimet detajojnë procedurat në lidhje me NGP-të, duke përfshirë: përbajtjen e marrëveshjes, stimujt, të pandehurit bashkëpunues dhe detyrat në lidhje me konfiskimin dhe kompensimin. E disponueshme në: [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20160\\_2021%20per%20Negocim%20e%20marreveshjes%20pranmbin%2020fajesise.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/Udhezim%20nr.%20160_2021%20per%20Negocim%20e%20marreveshjes%20pranmbin%2020fajesise.pdf). [qasur më 21 mars 2024]

<sup>91</sup> E disponueshme në

[https://prokuroriarks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/ANKodet/2019\\_02\\_08\\_082355\\_S\\_hqip.pdf](https://prokuroriarks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Legjislacioni/ANKodet/2019_02_08_082355_S_hqip.pdf) [accessed on 21 March 2024]

<sup>92</sup> Të gjitha raste të korrupsionit.

<sup>93</sup> Mucha kundër Sllovakisë, nr. 63703/19, 25 nëntor 2021, par. 66. Në mënyrë të veçantë, GJEDNJ deklaroi se, "vendimet gjyqësore duhet të formulohen në mënyrë që të shmangët çdo paragjykim i mundshëm për fajësinë e palës së tretë, në mënyrë që të mos rrezikohet shqyrtimi i drejtë i akuzave në procedurat e veçanta".

### Sigurimi i menaxhimit efektiv të rasteve KOK

i. KGJK dhe Gjykata Supreme duhet që të hartojnë udhëzime për menaxhimin e gjykimeve. Udhëzimet duhet që ta përshkruajnë përdorimin e duhur të sanksioneve dhe masave të tjera për ta siguruar praninë e palëve në seanca.

ii. KGJK-ja dhe Gjykata Supreme duhet t'i inkurajojnë seancat e menaxhimit të lëndëve në rastet e rënda/komplekse për ta mundësuar:

- Zhvillimin e një plani kohor real për rastin.
- Identifikimin e çështjeve faktike dhe juridike të pakontestuar dhe të kontestuar.
- Identifikimin e provave të pakontestuar dhe të kontestuar.
- Drejtimin lidhur me shpalosjen e provave.

Identifikimin e nevojës për dëshmi nga ekspertët.

iii. KGJK duhet ta zhvillojë dhe promovojë më tej përdorimin e ftesave elektronike dhe njoftimeve online për t'i informuar palët lidhur me datat e seancave.

Gjatë konsultimeve, ka pasur mbështetje të përgjithshme për zhvillimin e udhëzimeve për menaxhimin e rasteve dhe përdorimin e seancave paraprake për t'i menaxhuar në mënyrë aktive rastet. Këto udhëzime duhet ta pasojnë legjislacionin parësor dhe ta lejojnë lirinë gjyqësore kur është e nevojshme. Por ato duhet gjithashtu që ta ofrojnë një pikë referimi të qartë për standardet e pritshme se si do të ecin rastet përpara.

KGJK duhet ta marrë parasysh zhvillimin dhe pilotimin e formularëve të menaxhimit të rasteve.<sup>94</sup> Udhëzimet e sipërpërmendura duhet që ta trajtojnë përdorimin e duhur të sanksioneve dhe mjeteve procedurale për ta siguruar pjesëmarrjen e palëve në seancat dëgjimore. Ligji i Kosovës u jep gjyqtarëve autoritetin për të marrë masa ndëshkuese ose disiplinore, por gjyqtarët rrallë i zbatojnë këto masa në seancat e monitoruara.

<sup>94</sup> Shembuj të mirë të formularëve të menaxhimit të çështjeve të përdorura në Angli dhe Uells janë në dispozicion në: cm001eng.docx (live.com); PTPH\_1\_defendant.docx (live.com); me formularë të tjerë të disponueshëm në: Rregullat e Procedurës Penale: Formularët - GOV.UK (www.gov.uk) [qasur më 21.03.2024]

Gjyqtarët e përmendin shpesh mungesën e udhëzimeve të qarta për zbatimin e sanksioneve për moszbatimin e këtyre masave ndëshkimore, duke theksuar nevojën për udhëzime lidhur me këtë çështje.

KGJK duhet t'i zhvillojë më tutje bazat e të dhënave ekzistuese dhe ta promovojë dixhitalizimin, duke përfshirë zhvillimin e një sistemi të njoftimeve për t'i informuar palët dhe publikun kur caktohen rastet.<sup>95</sup>

Hapat drejt realizimit të këtij rekomandimi duhet që ta përfshijnë:

i. Zbatimin e një sistemi dixhital njoftimi për të dërguar emaile të automatizuara ose mesazhe me tekst palëve, duke u ofruar atyre përditësime me kohë lidhur me datat e seancave dhe çdo ndryshim në planifikim.

ii. Sigurimin e mirëmbajtjes dhe përditësimit të faqeve të internetit të gjykatave me orare të sakta ditore të seancave dhe me njoftime për ricaktimin e seancave.

iii. Vazhdimin e zhvillimit dhe promovimit të përdorimit të SMIL për ta centralizuar informacionin, për ta lehtësuar komunikimin dhe për të ofruar qasje në dokumentet përkatëse.

iv. Ofrimin e trajnimeve të rregullta për personelin e gjykatës për përdorim efektiv të teknologjive përkatëse dhe për rëndësinë e sistemeve të njoftimit në kohë.

Këto masa do ta përmirësonin efikasitetin e procedurave gjyqësore, do t'i mbanin palët të informuara dhe do ta rrisnin qasjen e publikut në informacion.

Në qershor të vitit 2023, KGJK e ka miratuar "Planin e Punës së Departamentit Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë për vitin 2023" (PP). Në shkurt 2024, plani është rishikuar dhe përditësuar. Objektivi i PP është që ta rrisë efikasitetin dhe të caktoj rastet sipas prioritetit brenda Departamentit Special. Miratimi i PP është i lavdërueshëm, dhe zhvillimi i PP-ve të ngjashme për departamentet e tjera gjyqësore është i inkurajuar.

<sup>95</sup> Projekti Rajonal i Monitorimit të Seancave Gjyqësore "Lufta kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Ballkanin Perëndimor", Raport i Përkohshëm i Gjetjeve dhe Rekomandimeve, viti i rishikimit korrik 2021–qershor 2022, faqe 42



### **Sigurimi i përfshirjes në KPP të ri i dispozitave të cilat e synojnë reduktimin e vonesave.**

- i. Gjykata Supreme duhet të nxjerrë udhëzime për interpretimin e duhur të ndryshimeve në dispozitat për rigjykim në nenin 402 të KPP.
- ii. KGJK-ja ta shqyrtojë analizën e përdorimit të vazhdueshëm të rigjykimeve në rastet e KOK.
- iii. Gjykata Supreme duhet të nxjerrë udhëzime për dispozitat e reja in absentia të nenit 303 të KPP.
- iv. OAK duhet të nxjerrë udhëzime për rolin e avokatit mbrojtës gjatë procedurave in absentia dhe të ofrojë trajnime për anëtarët mbi këto dispozita.

Më 17 shkurt 2023, ka hyrë në fuqi KPP i rishikuar, duke sjellë disa ndryshime të cilat e synojnë adresimin e mangësive në procedimin penal.<sup>96</sup> Këtu përfshihet mundësimi i gjykimeve in absentia në lidhje me të gjitha veprat penale dhe vendosja e një testi më të rreptë për kthimin e çështjeve nga Gjykata e Apelit për rigjykim. Edhe pse ka qenë një periudhë gjashtëmujore ndërmjet publikimit të KPP-së së re dhe hyrjes së tij në fuqi, Projekti ka vërejtur se ka ende një keqkuptim të madh të dispozitave të reja dhe të ndryshuara.

Mbase, gjatë periudhës tranzitore nuk janë mbajtur trajnime të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse për praktikuesit dhe kjo ka çuar në probleme lidhur me zbatimin.

Gjatë pesë seancave të monitoruara, gjyqtarët e sugjeruan procedimin in absentia, por mbrojtja e kundërshtoi me sukses sepse nuk e kishin marrë trajnimin e duhur. Prandaj, rekomandohet që OAK ta shqyrtojë nxjerrjen e udhëzimeve për procedurat in absentia për avokatët mbrojtës.

<sup>96</sup> Gazeta Zyrtare, e disponueshme në <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759> [qasur më 21 mars 2024]

Udhëzimet duhet të fuqizohen përmes trajnimeve praktike. Kjo është e rëndësishme pasi dispozitat krijojnë sfida të veçanta etike dhe ligjore për avokatët mbrojtës.

Mbështetja e tepërt në rigjykime është identifikuar nga Projekti si një shkak kryesor i vonës në gjykimin e rasteve. Për ta adresuar këtë çështje, KPP i vitit 2023 e prezantoi një test më të rreptë për kthimin e çështjeve për rigjykim. Sipas Kodit të ri të PP, rigjykimi lejohet vetëm në "rrethana të jashtëzakonshme", dhe Gjykata e Apelit është e detyruar që ta përfshijë në aktvendim arsyetimin për mos ndryshimin e aktgjykimit në vend të rigjykimit.<sup>97</sup> Megjithatë, "rrethanat e

jashtëzakonshme" nuk janë të përcaktuara, dhe ekziston mundësia për interpretime të ndryshme. Duhet të sigurohen udhëzime për tu siguruar që gjykatat do t'i zbatojnë këto dispozita.

Aktualisht rigjykimet po shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues që e ka gjykuar çështjen në shkallë të parë. Mbase, Gjykata Supreme duhet gjithashtu ta marrë në konsideratë këtë praktikë dhe ta nxjerrë një opinion mbi përbërjen e duhur të trupave gjykues në rigjykim.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e KPP për përmirësimin e drejtësisë penale, rekomandohet që Ministria e Drejtësisë të marr pjesë në një "vlerësim ex post" të zbatimit të ligjit të ri.<sup>98</sup>

## Kapaciteti

10

### Rekomandim

**Të përmirësohet standardi i aktakuzave dhe i akteve tjera ligjore.**

i. Zyra e Kryeprokurorit duhet që t'i përmirësojë mekanizmat e brendshëm për shqyrtimin e aktakuzave para finalizimit, duke siguruar një ekuilibër të duhur ndërmjet autonomisë së prokurorëve individualë dhe fuqisë së mbikëqyrësve për të nxjerrë udhëzime në raste specifike.

<sup>97</sup> Neni 402, Kodi i Procedurës Penale 2013 ... thotë: "1. Gjykata e Apelit, në raste të caktuara, me aktvendim e anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e kthen lëndën në rigjykim [...]". Sipas nenit 402, Kodit të Procedurës Penale 2023, kjo është zëvendësuar me "1. Gjykata e Apelit, në raste të jashtëzakonshme, me aktvendim anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e kthen lëndën në rigjykim [...]". Përveç kësaj, sipas Kodit të vitit 2023, paragrafi 2 "[t]aktvendimi duhet të përmbajë qartë arsyet dhe shkaqet për të cilat Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi

<sup>98</sup> Në dispozicion në: 'Manual për Vlerësimin Ex Post të Akteve Ligjore'; në dispozicion në <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/Manual-on-Ex-Post-Evaluation-of-Legal-Acts.pdf> [qasur më 21 mars 2024]

ii. Zyra e Kryeprokurorit duhet që ta zhvillojë një mekanizëm për ta siguruar shqyrtimin e brendshëm të rasteve të KOK të nivelit të lartë që rezultojnë në lirime ose të rasteve ku aktakuzat janë hedhur poshtë/refuzuar.

iii. Akademia e Drejtësisë e Kosovës ("ADK") duhet që ta rris numrin e trajnimeve të targetuara për prokurorët dhe gjyqtarët për ta përmirësuar cilësinë e aktakuzave në rastet e KOK.

Janë vërejtur mangësi në shumicën e aktakuzave të ngritura në rastet e monitoruara. Shqetësimet e zakonshme e përfshijnë stilin e të shkruarit, akuzat e pabazuara, përshkrimet e paqarta faktike, shpjegimin joadekuat të rëndësisë së provave dhe përsëritjen fjalë për fjalë të dëshmisë së dëshmitarit. Aktakuzave gjithashtu shpesh u mungojnë detajet mbi përfitimin ose dëmin financiar dhe nuk e kërkonin konfiskimin e pasurisë. Veçanërisht në rastet e krimit të organizuar, aktakuzat shpesh nuk i detajonin elementet e veprës së supozuar në përputhje me Kodin Penal. Përkundër këtyre të metave, në shumicën e rasteve, gjyqtarët nuk i hodhën poshtë akuzat apo nuk kërkuan ndryshime të aktakuzave.<sup>99</sup>

Gjatë forumeve të diskutimit dhe konsultimeve, pati mosmarrëveshje për rolin e gjyqësorit në shqyrtimin e aktakuzave – dhe veçanërisht për fuqinë e tyre për ta bërë këtë sipas ex officio

(d.m.th., kur nuk ka asnjë kërkesë nga palët), duke pasur parasysh natyrën e fortë kundërthënëse të sistemit gjyqësor të Kosovës. Shumë gjyqtarë deklaruan se ata preferojnë të mbështeten në kërkesat e mbrojtjes për ta hedhur poshtë aktakuzën, nga frika e akuzave për paragjykim. Vlen të përmendet se në të 52 rastet e monitoruara, mbrojtja ka bërë kërkesa për hedhjen poshtë të aktakuzës.<sup>100</sup> Megjithatë, asnjë nga këto kërkesa nuk ishte e suksesshme.

Në një rast të korrupsionit të nivelit të lartë, dispozitivi i aktakuzës nuk i referohej njërit prej të pandehurve. Me këtë rast gjykata ia ka kthyer aktakuzën prokurorit dhe ka kërkuar ndryshim. Kjo kontribuoi në administrimin efikas të drejtësisë dhe për këtë arsye u theksua si një praktikë e mirë.

Në përpjekje për ta identifikuar shkakun e aftësive joadekuate hartuese, konsultimet zbuluan se prokurorët ndonjëherë fokusohen në rezultatet

<sup>99</sup> Neni 235(4), KPP

<sup>100</sup> Në disa raste, refuzimi i këtyre aplikacioneve u ankimua (pa sukses). Fakti që një numër kaq i madh i sfidave i bëhet mjaftueshmërisë së aktakuzave ka implikime të rëndësishme për burimet e gjykatës dhe menaxhimin efikas të rasteve.

sasiore mbi ato cilësore; d.m.th., fokusohen në numrin e aktakuzave të ngritura në vend të standardit të atyre aktakuzave. Kjo mund t'i atribuohet theksimit të treguesve sasiore në vlerësimet e performancës së prokurorëve.

Një çështje tjetër e identifikuar është se në aktakuza shpesh mungojnë informacionet kryesore. Kjo mund ta demonstroj nevojën që prokurorët të jenë më proaktivë në mbikëqyrjen e hetimeve nga zbatuesit e ligjit për tu siguruar që të gjitha provat relevante janë marrë përpara se të ngrihet aktakuza. Mangësitë e vërejtura në aktakuza kanë kontribuar në lirim të pandehurve në së paku katër raste të monitoruara. Rrjedhimisht, duhet të vazhdohen përpjekjet për ta përmirësuar cilësinë e aktakuzave në aspektin e përmbajtjes dhe të hartimit. Duke pasur parasysh që prokurorët trajnohen për hartimin e aktakuzave, gjatë programit të trajnimit fillestar dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional,<sup>101</sup> rekomandohet që të krijohet një mekanizëm efektiv i rishikimit të brendshëm me qëllim të:

- Ruajtjes së autonomisë së vendimmarrjes së prokurorit duke siguruar konsistencë, llogaridhënie dhe respektim të standardeve ligjore nëpërmjet një sistemi mbikëqyrës.
- Promovohet vendimmarrja e qëndrueshme dhe të sigurohet mbrojtja nga paragjykimet ose

konfliktet e interesit, duke e nxitur kështu një sistem drejtësie të drejtë dhe të paanshëm.

- Prokurorëve tu ofrohet ekspertizë dhe udhëzime nga ana e mbikëqyrësve.
- Të mundësohet identifikimi i hershëm të gabimeve, lëshimeve ose dobësive duke i fuqizuar ndjekjet penale.

Nuk ekziston asnjë standard i përbashkët në Evropë. Në disa juridiksione, prokurorët e lartë kanë kompetenca të gjera për ta mbikëqyrur punën e kolegëve të rinj. Në të tjerat, autonomia e prokurorëve individualë është prioritare. Megjithatë, përgjithësisht pranohet se kur prokurorët e vjetër kanë kompetenca të gjera për të ndërhyrë në çështje, kërkohen kontrole për tu siguruar që pushteti të mos abuzohet. Përveç kësaj, duhet të ketë një proces formal për t'i adresuar mosmarrëveshjet ndërmjet prokurorit që e trajton rastin dhe mbikëqyrësit ose mentorit të tyre.<sup>102</sup>

Është raportuar se nuk ka mekanizëm rishikimi për rastet kur ka pasur lirime apo kur aktakuzat janë refuzuar apo hedhur poshtë.

Krijimi i një mekanizmi të tillë rishikimi do ta mundësonte nxjerrjen e mësimave dhe informacionin rreth praktikës së ardhshme. Kjo është padyshim, veçanërisht e rëndësishme në rastet e KOK të nivelit të lartë.

<sup>101</sup> Të dy programet e trajnimit zbatohen nga Akademia e Drejtësisë e Kosovës.

<sup>102</sup> Në dispozicion në: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=09000016804be55a](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016804be55a) [qasur më 21 mars 2024]

**KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të sigurohen se kriteret e vlerësimit të performancës dhe pritjet e barrës së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve e pasqyrojnë saktë nivelin e përpjekjeve të nevojshme për t'i trajtuar rastet e KOK.**

- i. Këshillat duhet që ta marrin parasysh peshën që u jepet treguesve cilësorë në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- ii. Edhe elementet sasiore e edhe ato cilësore të vlerësimit të performancës duhet ta marrin parasysh në mënyrë adekuate kompleksitetin dhe përpjekjet e përfshira në trajtimin e rasteve të KOK të nivelit të lartë.
- iii. Këshillat duhet që t'i rishikojnë vazhdimisht kriteret e vlerësimit të performancës në rastet e KOK për tu siguruar që ato e stimulojnë praktikën e mirë dhe vënien e duhur të rasteve sipas prioritetit.

Vlerësimet e performancës synojnë që ta sigurojnë llogaridhënien dhe t'i ruajnë standardet gjyqësore dhe prokuroriale, duke e nxitur kështu besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Ndërsa treguesit sasiorë të performancës, të tilla si menaxhimi i ngarkesës me rastedhe normat e pastrimit, ofrojnë një pasqyrë, kështu që ato duhet të kombinohen me tregues cilësorë të cilët e vlerësojnë standardin e punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në Kosovë, sistemet e vlerësimit të performancës

aktualisht i vënë në theks treguesit sasiorë. Për ta arritur një ekuilibër më të mirë, vëmendje më e madhe duhet t'u kushtohet faktorëve cilësorë. Kjo duhet bërë me qëllim që gjyqtarët dhe prokurorët të mos i japin përparësi "sasisë mbi cilësinë" dhe ta lejojë një vlerësim gjithëpërfshirës të kompetencës dhe profesionalizmit të përgjithshëm.

Zbatimi i vazhdueshëm i këtij rekomandimi është pjesë e "Deklaratës së Përbashkët të Zotimit".<sup>103</sup>

<sup>103</sup> Këshilli i Evropës ka kryer vlerësime të detajuara të sistemeve të vlerësimit si për gjyqtarët ashtu edhe për prokurorët në përputhje me standardet e KKGJE-së, të cilat duhet të informojnë rishikimin e sistemeve ekzistuese si pjesë e kësaj nisme. Shih gjithashtu Opinionin Nr. 17 (2014) të KKGJE-së "për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, cilësinë e drejtësisë dhe respektimin e pavarësisë së gjyqësorit"; në dispozicion në: <https://rm.coe.int/16807481ea> [qasur më 21.03.2024]. KKGJE rekomandon marrjen në konsideratë të treguesve cilësorë të mëposhtëm: kompetencën profesionale, duke përfshirë njohjen e ligjit, aftësinë për të zhvilluar procedura gjyqësore dhe aftësinë për të shkruar vendime të arsyetuara; kompetenca personale, duke përfshirë aftësinë për të përballuar ngarkesën e punës, aftësinë për të marrë vendime dhe hapjen ndaj teknologjive të reja; dhe kompetencat sociale, duke përfshirë aftësinë për të ndërmjetësuar, për të respektuar palët dhe për të performuar në pozita udhëheqëse.

Raporti i konsoliduar i cili e detajon progresin e bërë në kuadër të "Deklaratës së Përbashkët të Zotimit" e pasqyron konstatimin se gjyqtarët dhe prokurorët duhet të vlerësohen në një sërë treguesish cilësorë dhe sasiorë.<sup>104</sup>

Në vitin 2023, KGJK-ja e ka miratuar Rregulloren lidhur me shkallën e punës së gjyqtarëve ("Normën e Gjyqtarëve"). Sistemi i pikëve "të peshuara" që e

pasqyron punën shtesë të përfshirë në rastet e KOK të nivelit të mesëm dhe të lartë është i lavdërueshëm.<sup>105</sup> Rekomandohet që zbatimi i Normës së Gjyqtarëve të vlerësohet për ta matur efektin në performancën gjyqësore dhe për tu siguruar që ai të mos krijojë pasoja të paqëllimta, si p.sh. "vjelja e qershisë" së rasteve për ta përmbushur normën, në vend të caktimit të rasteve sipas prioritetit.

12

## Rekomandim

**Institucionet gjyqësore duhet që t'i bashkërendojnë më mirë aktivitetet ndërmjet palëve të interesit dhe donatorëve për ta shmangur dyfishimin dhe për t'i vënë sinergjitë në maksimum.**

- i. Institucionet duhet të thërrasin takime të rregullta bashkërenduese për partnerët ndërkombëtarë, organizatat e shoqërisë civile dhe palët tjera të përfshira në zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën e sundimit të ligjit.
- ii. Institucionet duhet të aplikojnë ushtrime periodike të "planit" për ta mbajtur një regjistrim të përditësuar të aktiviteteve që mund të përdoren me qëllim të mbështetjes së bashkërendimit dhe për ta vlerësuar zbatimin dhe ndikimin.

Disa donatorë, partnerë ndërkombëtarë dhe OSHC në Kosovë zbatojnë projekte dhe aktivitete për sundimin e ligjit në mbështetje të institucioneve të sektorit

të drejtësisë. Aktivitetet përfshijnë ofrimin e trajnimeve dhe seminareve, mentorimin dhe ofrimin e ekspertizës dhe të burimeve.

<sup>104</sup> Deklarata e Përbashkët e Zotimit, Reforma në Drejtësi, Përmbledhje e raporteve të grupeve të punës (dhjetor 2023), faqe 12. Raportet nuk janë të disponueshme online.

<sup>105</sup> Rregullorja për shkallën e punës së gjyqtarëve, neni 14 (1); Në dispozicion në: <https://www.gjyqesori-rks.org/regulloret/?r=M&legId=295> [qasur më 21 mars 2024]

Për ta siguruar qëndrueshmërinë dhe për t'i shmangur dyfishimet, institucionet gjyqësore duhet ta marrin përgjegjësinë për bashkërendimin e këtyre përpjekjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Institucionet lokale janë në pozitë më të mirë për të krijuar dhe ruajtur iniciativa të përshtatshme për nevojat e tyre specifike, për strategjitë dhe planet e veprimit, duke rezultuar në ndërhyrje që janë më të qëndrueshme dhe më efektive. Institucionet vendore duhet të ndërmarrin hapa për t'i bashkërenduar më mirë projektet dhe aktivitetet që

lidhen me sistemin e drejtësisë.

Së paku, këtu duhet përfshirë mbajtja e "takimeve të bashkërendimit të donatorëve" në baza të rregullta dhe për hartimin e mbështetjes dhe aktiviteteve që po zbatohen duke e përdorur modelin e mirë të ofruar përmes takimeve të rregullta të KGJK-së me donatorët. Përfundimisht, institucionet gjyqësore që e marrin rolin udhëheqës në bashkërendim do të do të kenë mbështetje më të rëndësishme, më efikase dhe më me ndikim, dhe kjo do ta nxis një infrastrukturë më të fortë të sundimit të ligjit.

13

## Rekomandim

### **Vlerësimi i nevojave dhe i performancës së njësive të specializuara që merren me rastet e KOK të nivelit të lartë.**

i.KGJK dhe KPK duhet ta mbikëqyrin, vlerësojnë dhe adresojnë vazhdimisht performancën dhe efikasitetin e departamenteve të specializuara përgjegjëse për rastet e KOK të nivelit të lartë.

Departamenti Special, Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Prokuroria Speciale (PSRK) janë përgjegjëse për shumicën e rasteve të KOK të nivelit të lartë. Megjithatë, rezultatet e rasteve mbeten të paqëndrueshme. Këshillat duhet që t'i vlerësojnë vazhdimisht nevojat e këtyre departamenteve të specializuara dhe të sigurohen lidhur me shpërndarjen proporcionale të burimeve.

Këtu përfshihet sigurimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të kualifikuar për t'i menaxhuar rastet, disponueshmëria e ekspertizave forenzike dhe e stafit mbështetës ligjor; si dhe nxitja e një bashkëpunimi më të fortë me agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit si dhe institucionet e tjera përkatëse.

Duhet të vlerësohen edhe nevojat për trajnime për ofrimin e njohurive të specializuara për tema, siç janë

prokurimi publik, përgjegjësia penale e personave juridikë, hetimet financiare, masat e veçanta hetimore dhe pastrimi i parave.

Fuqizimi i ekspertizës mund të arrihet gjithashtu përmes krijimit të pikave fokale për ofrimin e mentorimit, udhëzimit dhe mësimin nga kolegët për temat kryesore duke përdorur modelin

e ofruar përmes rrjetit të koordinatorëve të Zyrës së Kryeprokurorit për konfiskimin e pasurisë. Sigurimi i burimeve adekuate dhe i aftësive të zgjeruara do të rezultonte në analiza më të sakta ligjore dhe në vendimmarrje më të mirë, duke çuar përfundimisht në rezultatet më të duhura.

14

## Rekomandim

### Përmirësimi i cilësisë së gjykrimeve në rastet e KOK të nivelit të lartë.

i. Gjykata Supreme duhet t'i ndryshojë Udhëzimet e Politikës Ndëshkimore të vitit 2018 për t'i përafuar ato me KPP-në e re. Këto udhëzime të rishikuara duhet që ta trajtojnë gjithashtu çështjen e sanksioneve në rastet komplekse të KOK që përfshijnë të pandehur të shumtë.

ii. Gjyqtarët duhet të nxjerrin gjykime të qarta dhe të arsyetuara mirë. Kur të pandehurit lirohen, duhet të jepen arsyetime specifike. Vendimet e dënimit duhet që t'i trajtojnë veçoritë rënduese dhe lehtësuese pasi ato i përkasin secilit të pandehur.

Që nga fillimi i projektit, ekipi i ka monitoruar 16 raste që kanë marrë vendime përfundimtare dhe detyruese (12 për korrupsion dhe katër për krim të organizuar). Një përqindje e lartë e rasteve të përfunduara kanë rezultuar me aktgjykim lirues.

Konkretisht, 21 nga 26 të pandehurit (81 përqind) që ballafaqoheshin me akuza të lidhura me korrupsionin u liruan ose aktakuza u refuzua.<sup>106</sup>

Tridhjetë e gjashtë nga 48 të pandehur (75 përqind), të akuzuar për vepra të lidhura me krimin e organizuar u liruan nga akuzat.

<sup>106</sup> Lirimet janë regjistruar në nëntë nga 12 rastet e monitoruara (75 përqind)




Tre nga katër rastet e krimit të organizuar, që kishin të bënin me akuza lidhur me trafikun e drogës, rezultuan me dënime.

Vlen të përmendet se një nga katër rastet e finalizuara të krimit të organizuar përfundoi me lirimin e të gjithë të pandehurve (36 të pandehur). Prandaj, numri i ulët i rasteve të monitoruara duhet të merret parasysh

kur vlerësohet rëndësia e shkallës së liritimit nga akuzat në rastet e krimit të organizuar. Në përgjithësi, shkalla e liritimit në rastet e monitoruara të KOK është 76 për qind.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto statistika paraprake janë marrë nga relativisht pak raste (16).


### Raste aktive kundrejt të përfunduar



Grafiku 23 - Rastet aktive kundrejt të finalizuara

Nga 16 lëndët e përfunduara, një ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë në shkallën e parë pasi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, një rast ka përfunduar në rigjykim, nëntë raste kanë marrë vendim të formës së prerë në Gjykatën e Apelit dhe pesë raste janë përfunduar në Gjykatën Supreme pas parashtrimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.


### Rezultati i rasteve të përfunduara



Grafiku 24 - Rezultati i rasteve të përfunduara

Në total, 17 të pandehur u dënuan (një pas pranimit të fajësisë, 16 pas gjykimeve të kontestuara). Zbërthimi i dënimeve është paraqitur në grafikun e mëposhtëm. Vlen të përmendet se 16 nga 17 të pandehur u dënuan me burgim të menjëhershëm. Të 17 të pandehurit morën edhe dënime financiare.

## Dënimet në rastet e përfunduara të KOK



Grafiku 25 - Dënimet në rastet e përfunduara të KOK.

Projekti ka vërejtur se vendimeve të Gjykatës Themelore shpesh u mungon arsyetimi i qartë dhe gjithëpërfshirës për vendime, si për lirime ashtu edhe për dënime. Në disa gjykime, gjetjet e fakteve ishin të paqarta dhe kishin nevojë për vërtetim të mëtejshëm. Disa vendime të dënimit i përmbledhin tiparet rënduese dhe lehtësuese pa e specifikuar se si ato i përkisnin secilit të pandehur. Kjo rezultonte në gjykime jashtëzakonisht të shkurtra duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes dhe numrin e të pandehurve.

Gjyqtarët duhet të sigurohen që vendimet i plotësojnë kriteret e KPP-së. Vendimet e dënimit duhet të jenë plotësisht të arsyetuara dhe individuale, me shpjegimin e veçorive rënduese dhe lehtësuese dhe të asaj se pse dënimi konsiderohet proporcional për çdo të pandehur.

Në vitin 2018, Gjykata e Supreme i publikoi udhëzimet gjithëpërfshirëse të dënimit të cilat synojnë unifikimin e praktikës së dënimit në të gjitha gjykatat.<sup>107</sup> Në vitin 2021 u publikua edhe “Udhëzuesi specifik për korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”.<sup>108</sup> Edhe pse është krijuar një komision për monitorimin e udhëzimeve të vitit 2018, ka pasur monitorim dhe vlerësim të pamjaftueshëm të zbatimit të udhëzimeve.

Gjykatat shpesh nuk u përmbahen rregullisht udhëzimeve të dënimit. Udhëzimet nuk janë të detyrueshme dhe prandaj trupat gjykues e ruajnë lirinë e konsiderueshme kur i dënojnë të pandehurit. Megjithatë, zbatimi i udhëzimeve mund ta përmirësojë konsistencën në vendimet e dënimit

<sup>107</sup> Gjykata Supreme, Udhëzimet e Dënimit, Botimi 1, 2018, gjithashtu i disponueshëm në: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing%20Guidelines\\_February%202018.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/Sentencing%20Guidelines_February%202018.pdf) [qasur më 24 mars 2024]

<sup>108</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Udhëzues specifik, qershor 2021, gjithashtu i disponueshëm në: [https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/5884\\_Corruption%20Specific%20Guidelines-%20qershor%202010.pdf](https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/5884_Corruption%20Specific%20Guidelines-%20qershor%202010.pdf) [qasur më 21 mars 2024]

dhe ta zvogëlojë numrin e apeleve kundër dënimeve. Prandaj, gjyqtarët duhet të inkurajohen që t'u referohen udhëzimeve në gjykimet e tyre.<sup>109</sup>

Duke e ditur se ka pasur ndryshime të rëndësishme legislative që nga viti 2018,<sup>110</sup> Gjykata Supreme duhet t'i përditësojë udhëzimet aktuale për të mbuluar këto ndryshime.

## Mjetet Juridike

15

### Rekomandim

#### **Sigurimi që hetimet financiare dhe konfiskimi i aseteve të zbatohen në mënyrë sistematike në rastet e KOK.**

- i. Nxitja e përdorimit efektiv të mjeteve hetimore, duke përfshirë masat e veçanta hetimore (MVH) dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar.
- ii. Zbatimi i udhëzimeve për sekuestrimin dhe konfiskimin për prokurorët të publikuara në vitin 2023 dhe marrja parasysh nëse nevojiten udhëzime shtesë për hetimet financiare.
- iii. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të sigurohen që vlerësimet dhe barra e punës gjyqësore dhe prokuroriale t'i pasqyrojnë përpjekjet e nevojshme për procedurat e konfiskimit.
- iv. AKD duhet të sigurohet që ngritja e kapaciteteve për hetimet financiare dhe konfiskimin e pasurisë është e mjaftueshme, efektive dhe e dedikuar për ata për të cilët është më e rëndësishme.

Projekti i ka shqyrtuar të dhënat mbi hetimet financiare në rastet e monitoruara dhe vuri re se prokurorët zbatuan hetime financiare vetëm në 32 nga 52 rastet e monitoruara (62

përqind). Pavarësisht rasteve të monitoruara që përfshinin shuma të konsiderueshme të pretenduara të dëmeve ose të përfitimit, konfiskimi i pasurisë ishte i rrallë.

<sup>109</sup> Një opsion mund të jetë detyrimi i gjyqtarëve që të japin arsyetimin nëse ata largohen nga udhëzimet.

<sup>110</sup> Përfshirë Kodin Penal 2019 dhe Kodin e Procedurës Penale 2023.

Disa faktorë kontribuojnë në aplikimin e ulët të hetimeve financiare dhe të konfiskimit të aseteve në Kosovë. Së pari, ka mungesë vlerësimi dhe aftësie si nga policia ashtu edhe nga prokurorët lidhur me rëndësinë e konfiskimit dhe mënyrën e kryerjes së hetimeve efektive financiare. Për më tepër, monitoruesit kanë vënë re aplikim të pamjaftueshëm të mjeteve të tilla si Masat e Veçanta Hetimore (MVH) dhe të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar (BJN) për t'i gjurmuar përfitimet e krimeve.

Posa që një rast i nivelit të lartë të KOK përfundon me në një dënim, prokurorët priren të zhvendosin fokusin e tyre në rastet e tjera në vend që ta nisin procedurën e përcaktuar të konfiskimit të zgjeruar. Ky ndryshim mund të rrjedhë nga kufizimet e burimeve, prioritetet konkurruese ose nga mungesa e theksit tek rikuperimet e aseteve në vlerësimet e performancës.

Një rritje e numrit të konfiskimit përfundimtar të aseteve në vitin 2023, krahasuar me vitet e mëparshme, e paraqet një zhvillim pozitiv.<sup>111</sup> Megjithatë, rritja i atribuohet një numri të vogël të rasteve ku janë sekuestruar pasuri me vlerë të lartë dhe për këtë arsye ajo nuk e prezanton një përdorim më të gjerë/sistematik të konfiskimit pas shqiptimit të dënimit.

Procedurat e konfiskimit kërkojnë përpjekje dhe ekspertizë të

konsiderueshme nga ana e autoriteteve gjyqësore dhe prokuroriale. KGJK dhe KPK duhet ta marrin parasysh kompleksitetin e rasteve të tilla në vlerësimin e performancës dhe në barrën e punës. Kjo qasje do të garantonte që gjyqtarëve dhe prokurorëve t'u sigurohen burimet dhe koha e duhur për t'i kryer hetimet financiare gjithëpërfshirëse dhe për t'i trajtuar në mënyrë efektive procedurat e konfiskimit të pasurisë.

Miratimi i udhëzimeve për konfiskimin e pasurisë të nxjerra nga Kryeprokuroria në tetor të vitit 2023 është një tjetër ndryshim pozitiv.<sup>112</sup> Tani përpjekjet duhet të përqendrohen në rritjen e ndërgjegjësimit për udhëzimet, promovimin dhe monitorimin e përdorimit të tyre. Raportohet se keqkuptimi i theksuar rreth Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë e ka penguar përdorimin e sekuestrimit dhe konfiskimit. Këto çështje vazhdojnë pavarësisht nga numri i madh i trajnimeve të ofruara për këto tema.

Për t'i adresuar me sukses këto sfida nevojitet një qasje e shumë anshme. Së paku, autoritetet përkatëse duhet t'i trajtojnë boshllëqet në njohuritë dhe aftësitë e zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe juristëve, të sigurojnë stimuj për përdorimin e rikuperimit të aseteve duke i rishikuar kriteret e vlerësimit të performancës.

<sup>111</sup> Raportuar gjatë konsultimeve

<sup>112</sup> Kjo pasoi rekomandimet e mëparshme për të ofruar udhëzime shtesë për këtë temë.

### **Përmirësimi i qasjes në informacionet financiare për organet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duke i respektuar të drejtat e privatësisë**

- i. Zyrës së Prokurorisë Speciale t'i ofrohet qasja në të dhënat e regjistrave zyrtarë në të njëjtin nivel me Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës (p.sh., bazat e të dhënave të policisë, kadastrës dhe administratës tatimore).
- ii. Ofrimi i udhëzimeve për sektorin privat për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion/shpalosje nga autoritetet gjyqësore.
- iii. Sigurimi që ekspertët e foreznikës financiare të kenë aftësi dhe ekspertizë të mjaftueshme dhe se puna e tyre mund të vlerësohet siç duhet.

Sigurimi i hetimit dhe ndjekjes penale efektive të rasteve të KOK, veçanërisht të pastrimit të parave, kërkon qasje më të madhe në informacionet financiare për organet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duke i respektuar të drejtat e privatësisë. Zyra e Prokurorisë Speciale aktualisht mbështetet në Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF) për hetime financiare, po përballlet me pengesa në qasjen në të dhëna thelbësore nga bazat e të dhënave ekzistuese. Për më tepër, prokurorëve shpesh u mungon një pasqyrë e qartë e të dhënave të mbledhura, gjë që e pengon analizën faktike dhe ligjore.

Ofrimi i qasjes së Zyrës së Prokurorisë Speciale në të dhënat nga regjistrat zyrtarë në mënyrë të barabartë me NJIF do ta rriste ndjeshëm kapacitetin e tyre

për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht rastet. Megjithatë, duhet të aplikohen masa mbrojtëse të forta për t'i mbrojtur të drejtat e privatësisë, duke përfshirë protokollet e rrepta të mbrojtjes së të dhënave, kontrollet e qasjes dhe përdorimit të të dhënave anonime të grumbulluara kur është e mundur.

Për sa i përket sektorit privat, sigurimi i udhëzimeve të qarta për institucionet kryesore financiare private, si bankat dhe kompanitë e sigurimeve, për detyrimet e tyre kur u përgjigjen kërkesave nga autoritetet gjyqësore është thelbësore. Ky udhëzues duhet ta mbulojë kornizën ligjore, llojet e kërkesave, procedurat e trajtimit dhe masat e konfidencialitetit, duke e theksuar bashkëpunimin dhe pajtueshmërinë dhe duke i mbrojtur të drejtat e privatësisë.

Lidhur me aftësitë dhe ekspertizën e ekspertëve financiarë ligjorë, duhet të krijohet një mekanizëm gjithëpërfshirës vlerësimi për t'i vlerësuar kualifikimet, kompetencën dhe integritetin e ekspertëve financiarë. Ky mekanizëm vlerësimi duhet të përmbaj kritere të rrepta përzgjedhjeje, vlerësime të rregullta të performancës dhe kërkesa të vazhdueshme për zhvillim profesional. Duke u siguruar që ekspertët e foreznikës financiare t'u përmbahen standardeve rigoroze, mund të ruhet efikasiteti dhe besueshmëria e

hetimeve financiare. Në zbatimin e këtyre masave, duhet të ketë ekuilibër të duhur ndërmjet lehtësisë të qasjes në informacionin financiar për organet e zbatimit të ligjit dhe për prokurorët, dhe mbrojtjes së të drejtave të privatësisë së individëve. Masat e fuqishme të mbrojtjes së të dhënave, udhëzimet e qarta dhe mekanizmat e rreptë të vlerësimit mund të ndihmojnë në arritjen e këtij ekuilibri dhe të sigurojnë që qasja në informacionin financiar të jetë sa efektive po aq e ligjshme.

17

## Rekomandim

### Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal në trajtimin e rasteve të KOK

- i. Përdorimi i rrjeteve ekzistuese jo formale dhe grupeve rajonale, të tilla si CARIN,<sup>113</sup> për shkëmbimin e informacioneve.
- ii. Inkurajimi i përgjigjeve të menjëhershme ndaj kërkesave për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, duke përfshirë:
  - Udhëzime të qarta dhe procedura standarde operative për trajtimin në kohë dhe efikas të kërkesave për bashkëpunim juridik ndërkombëtar nga ana e autoriteteve.
  - Caktimi i pikave të kontaktit brenda autoriteteve gjyqësore për ta përshpejtuar përpunimin e kërkesave.
  - Sigurimi i programeve të trajnimit për ta përmirësuar të kuptuarit e kornizave ligjore ndërkombëtare.

<sup>113</sup> CARIN është një rrjet jo formal i praktikuesve të zbatimit të ligjit dhe gjyqësorit në fushën e gjurmimit, ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive. Është një rrjet ndërinstitucional. Çdo shtet anëtar përfaqësohet nga një oficer i zbatimit të ligjit dhe një ekspert gjyqësor (prokuror, gjyqtar hetues, etj. në varësi të sistemit ligjor). CARIN aktualisht ka 54 juridiksione anëtare të regjistruara, duke përfshirë Kosovën, 27 shtete anëtare të BE-së dhe nëntë organizata ndërkombëtare. Në dispozicion në <https://www.carin.network/> [qasur më 21 mars 2024]

Projekti i ka monitoruar katër raste në të cilat procedurat janë zgjatur për shkak të vonesave në bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Periudha më e shkurtër që është vënë re për marrjen e ndihmës juridike ishte dy muaj.<sup>114</sup> Praktikuesit ligjorë kosovarë e konfirmuan se kërkesat formale për ndihmë të ndërsjellë juridike mund të zgjasin deri në 12 muaj dhe në disa raste kërkesat mbeten pa përgjigje.

Për të minimizuar ndikimin e këtyre vonesave dhe për ta përmirësuar më tej bashkëpunimin gjyqësor rajonal dhe ndërkombëtar, duhet të përdoren rrjetet ekzistuese jo formale dhe grupet

rajonale. Rrjetet joformale, si CARIN, (Rrjeti Ndër-Agjensor i Rikuperimit të Aseteve të Camden<sup>115</sup>), mund ta lehtësojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe ta rrisin besimin dhe bashkëpunimin reciprok në ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike.

Rekomandohet zbatimi i udhëzimeve dhe i procedurave standarde të funksionimit, së bashku me trajnimet praktike për zbatimin e BJN dhe kornizave ligjore ndërkombëtare për ta rritur besimin e praktikantëve në zbatimin e këtyre masave.

<sup>114</sup> Ekzaminimi i një personi të ndaluar në një juridiksion fqinj në cilësi të dëshmitarit.

<sup>115</sup> <https://www.carin.network/>

# VIII. Mali i Zi

## Hyrje

Gjatë tre viteve të fundit, trajtimi gjyqësor i rasteve të rënda të KOK në Mal të Zi e ka shënuar një përparim të kufizuar. Funkcionimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor është ndikuar negativisht nga përbërja jo e plotë e organeve të rëndësishme gjyqësore dhe e posteve vendimtare që janë zënë në mënyrë të përkohshme. Megjithatë, Mali i Zi ka ndërmarrë disa hapa pozitivë për zgjidhjen e krizës gjyqësore.

Në mars 2022 u emërua Kryeprokurori i ri Special. Që kur ai mori detyrën, ka pasur përparim të konsiderueshëm në numrin e aktakuzave të ngritura kundër të pandehurve të profilit të lartë që janë me interes të veçantë publik.

Për më tepër, Parlamenti e ka emëruar gjyqtarin e fundit të Gjykatës Kushtetuese në nëntor 2023, tre anëtarët e mbetur laik të Këshillit Gjyqësor në dhjetor 2023 dhe Prokurorin e Lartë të Shtetit në janar 2024. Në momentin e shkrimit të këtij raporti, Kryetari i Gjykatës Supreme nuk është emëruar ende, edhe pse pozicioni është plotësuar në mënyrë të përkohshme që nga dhjetori i vitit 2020.

Duke pasur parasysh që rastet e nivelit të lartë – gjithashtu sipas Metodologjisë së Projektit – zakonisht kanë implikime politike, shqyrtimi i pavarësisë së gjyqësorit ka qenë pjesë e analizës së ekipit të projektit.

Projekti ka vëzhguar vazhdimisht politikanë që i komentojnë në mënyrë të papërshtatshme procedimet penale që janë duke u zhvilluar të rasteve që janë nën monitorim.

Nëpërmjet monitorimit të tij mediatik, Projekti ka gjetur gjithashtu prova rreth mediave të cilat e përkeqësojnë dhe fuqizojnë efektin e lartpërmendur të cilat i ri-publikojnë dhe shpërndajnë gjerësisht deklaratat problematike.

Për më tepër, disa akuza të fundit kundër ish-përfaqësuesve të nivelit të lartë ose në detyrë të gjyqësorit dhe administratës publike e demonstrojnë faktin se krimi i organizuar u përpoq të ushtronte ndikim në institucionet kryesore, përfshirë agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorin, në një masë dhe me pasoja të cilat në një masë ende duhet të përcaktohen.

Në anën tjetër, Projekti gjithashtu e pranon faktin se gjykatat kanë filluar ta rrisin transparencën e punës së tyre duke i përshtatur disa praktika të mira si publikimi më i rregullt i orareve të seancave në faqet e tyre zyrtare.

Duke u fokusuar në çështjen e përshtatshmërisë, Projekti ka vënë re mungesën e efikasitetit në procedura si një nga mangësitë më të mëdha në përpunimin e rasteve të KOK në Mal të Zi.



Nga 59 rastet nën monitorim, vetëm dy janë përfunduar. Njëra rezultoi me lirim, ndërsa tjetra u finalizua në fazën paraprake pasi aktakuza nuk u konfirmua. Vetëm tetë raste u përfunduan në gjykimin e shkallës së parë gjatë periudhës së zbatimit të Projektit.

Projekti gjithashtu ka vënë re se akteve gjyqësore – përfshirë aktgjykimet, aktakuzat dhe vendimet për paraburgim – shpesh u mungojnë arsyetimet e qarta dhe të mjaftueshme.

Për më tepër, paraburgimi gjatë procedurës nuk dukej të trajtohej si masë e fundit, ndërkohë që vendimet që caktonin paraburgimin shpesh karakterizoheshin nga arsyetimi joadekuat, siç përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila konstatoi se e drejta e lirisë së të pandehurve ishte shkelur në ato raste.

Për më tepër, butësia e tepruar në praktikën e sanksionimit e paraqet një shqetësim. Në rastet nën monitorim, gjykata ka zbatuar dënimin minimal ose pak më lartë së minimumi të parashikuar nga vepra përkatëse në Kodin Penal për pesë të pandehur dhe ka aplikuar sanksione nën minimumin ligjor për 55 të pandehur.

Duke pasur parasysh se këto shifra bazohen kryesisht në dënimet që rezultojnë nga vendimet e MPF-së, është pozitive që Gjykata Supreme dhe Zyra e Prokurorisë së Lartë të Shtetit (ZPLSH) kanë nxjerrë udhëzime për përdorimin e MPF-ve. Shpresohet që problemi i lehtësimit në MPF-të do të adresohet nëpërmjet zbatimit të duhur të këtyre udhëzimeve.

Mangësi të theksuara janë vërejtur edhe në lidhje me konfiskimin e pasurisë në rastet e KOK. Pamundësia për t'i gjetur pasuritë për t'u sekuestruar ose për t'i ngrirë ato me qëllim të konfiskimit të drejtpërdrejtë ose të zgjeruar të produkteve të krimit tregon se metodat e hetimit financiar që janë aktualisht në përdorim nuk janë efektive.

Me qëllim të korigjimit të sfidave që lidhen me pavarësinë e gjyqësorit, menaxhimin e gjykimeve, politikën sanksionuese, cilësinë e akteve gjyqësore, hetimet financiare dhe konfiskimin e asetëve, në kapitullin vijues është dhënë një grup gjithëpërfshirës prej 19 rekomandimesh të synuara dhe të zbatueshme bazuar në gjetjet e monitorimit të gjykimeve nga ana e Projektit.

## Paanshmëria

1

### Rekomandim

**Publikimi i informacionit mbi trajtimin e rasteve të KOK me kohë, në mënyrë të saktë dhe të qëndrueshme, duke përfshirë publikimin e orareve të gjykimeve, aktakuzave dhe vendimeve. Veçanërisht:**

i. Kryetarët e gjykatave dhe kryetarët e prokurorive të shtetit duhet që të sigurojnë uniformitetin në praktikën në publikimin e akteve gjyqësore dhe informacioneve të tjera që kanë të bëjnë me procedurat penale, duke përfshirë orarin e seancave.

ii. Qendra për Trajnim në Shërbimin e Gjyqësorit dhe të Prokurorisë së Shtetit duhet të zhvillojë dhe të ofrojë kurse trajnimi të specializuara për marrëdhëniet me publikun (MP) për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët që merren me rastet e KOK, veçanërisht drejtuesit e institucioneve dhe përfaqësuesit e MP, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë në raportimin e rasteve të KOK dhe rasteve me interes të lartë publik.

iii. Gjykata Supreme dhe ZPLSH duhet t'i përditësojnë strategjitë e tyre të komunikimit me udhëzime të qarta se si gjyqtarët dhe prokurorët duhet të raportojnë për rastet e KOK me interes të lartë publik.

iv. Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Supreme duhet të nisin programe informuese për ta mundësuar një kuptim më të mirë të rolit të gjyqësorit në ruajtjen e shtetit të së drejtës.

Ekipi i Projektit ka vënë re se oraret e seancave si dhe aktet përkatëse gjyqësore, nuk publikohen rregullisht në faqet e internetit të Gjykatës së Lartë në Podgoricë dhe të Prokurorisë Speciale (ZPS). Në faqen e internetit të

gjykatës mungonin të dhënat për të paktën 229 seanca në 42 raste nën monitorim. Pjesa më e madhe e seancave të paparalajmëruara ishin seanca për kontrollin e aktakuzës dhe për shqyrtimin e MPF-ve.

Sa i përket akteve gjyqësore, së paku 24 aktakuza nuk janë publikuar në 21 raste, dhe 71 aktgjykime të MPF-së në 11 raste. Gjatë konsultimeve, disa bashkëbisedues e theksuan rëndësinë e disponimit të një mjeti specifik për komunikimin me publikun për rastet e KOK, pasi kultura e marrëdhënieve me publikun brenda gjyqësorit, veçanërisht gjykatave, kishte vend për përmirësim.

Gjithashtu, trajnimi mbetet i nevojshëm për ti ndihmuar akterët gjyqësorë në identifikimin e rasteve për të cilat ia vlen të raportohen dhe të mësojnë për standardet e transparencës dhe raportimit në çështjet penale. Zhvillimi i strategjive të komunikimit dhe

përfshirja e zyrtarëve të marrëdhënieve me publikun dhe drejtuesve të institucioneve është një mënyrë efektive për vendosjen e një ekuilibra midis transparencës dhe mbrojtjes së akterëve gjyqësorë. Ekipi i Projektit e propozon gjithashtu zhvillimin e programeve të informimit për ta forcuar lidhjen ndërmjet gjykatave dhe komuniteteve të tyre.

Këto programe mund të përfshijnë aktivitete të tilla si ngjarje të hapura gjyqësore, debate publike, prezantime dhe shpërndarje të materialeve informuese ose përmbajtjeve të tjera që do t'i nxisnin marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe publikut.<sup>116</sup>

## 2

### Rekomandim

#### **Fuqizimi i kapaciteteve të medias për t'iu përmbajtur standardeve ndërkombëtare dhe Kodit të Sjelljes së Gazetarëve në raportimin e rasteve të KOK:**

i. Organet vetë-rregullatore të medias duhet që ta zhvillojnë një fjalor të terminologjisë ligjore për gazetarët të cilët i mbulojnë rastet e KOK për ta mundësuar raportimin adekuat dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe vet prezumimin e pafajësisë.

ii. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të ofrojnë trajnime për gazetarët lidhur me terminologjinë ligjore dhe procedurat për t'i ngritur kapacitetet e gazetarëve për mbulimin e rasteve të KOK në

<sup>116</sup> KKGJE, Opinioni nr. 23(2020) mbi rolin e shoqatave të gjyqtarëve në mbështetjen e pavarësisë së gjyqësorit, faqe 9, në dispozicion në Strasburg, 27 shtator 2012 (coe.int)

mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë pavarësinë e gjyqësorit dhe prezumimin e pafajësisë. Kjo do të kontribuonte gjithashtu në ndërtimin e besimit midis dy palëve.

Ekipi i Projektit i ka identifikuar të paktën 42 artikuj mediatikë me përmbajtje të cilat e cenonin pavarësinë e gjyqësorit dhe prezumimin e pafajësisë së të pandehurve.

Shembujt më të zakonshëm e përfshinin përdorimin e papërshtatshëm të terminologjisë ligjore që i portretizonte të pandehurit si të dënuar tashmë; publikimi i fotografive të të pandehurve në pranga; promovimi i deklaratave paragjyquese të politikanëve ose të personave të tjerë me ndikim në llogaritë e tyre në mediat sociale ose gjetkë; dhe publikimi i artikujve që kritikojnë në mënyrë të papërshtatshme sjelljen e gjyqtarëve në çështjet penale që janë duke u trajtuar. Gjithashtu u zbuluan dhe u publikuan disa prova nga çështjet penale nën hetim, duke përfshirë transkriptet e mesazheve të koduara.

Sipas informacioneve të marra nga të gjithë akterët gjyqësorë, mënyra se si media në Mal të Zi raporton për rastet penale është shpesh e papërshtatshme dhe mund të jetë e dizajnuar për të ushtruar presion mbi gjyqtarët dhe prokurorët dhe për ta minuar besimin e publikut në gjyqësor. Disa nga gazetarët

që morën pjesë në ngjarjen e OSHC-ve të organizuar nga Projekti ranë dakord, duke vënë në dukje se media u dha shumë hapësirë deklaratave të papërshtatshme të politikanëve, veçanërisht atyre në ekzekutiv, të cilët duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm që të mos i cenojnë të drejtat e të pandehurve dhe pavarësinë e gjyqtarëve.

Për të ndihmuar gazetarët që të raportojnë në një mënyrë më profesionale dhe më etike, një hap i parë i vlefshëm do të ishte një fjalor i terminologjisë ligjore që do të hartohej nga organet vetërregulluese të medias me ndihmën e Gjykatës Supreme ose të Këshillit Gjyqësor. Ai do t'ua siguronte gazetarëve njohuritë e nevojshme ligjore kur raportojnë për çështjet penale. Përveç kësaj, në bashkëpunim me organet gjyqësore, mund të ofrohen trajnime që mund të përshtaten me nevojat e reporterëve dhe të bëhen tërheqës për ata përmes përfshirjes së shembujve tallës dhe të vërtetë. Anëtarët e konsultuar të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial gjithashtu mendojnë se gazetarët do të përfitonin nga trajnimi i organizuar nga anëtarët e sistemit gjyqësor.

### **Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të forcojnë besimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke:**

- i. Siguruar përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe autonomisë së prokurorëve, dhe më pas adresimin e çdo shqetësimi në lidhje me sigurinë personale të prokurorëve dhe gjyqtarëve.
- ii. Këshilli Gjyqësor ta formojë një organ të brendshëm për t'i trajtuar çështjet që lidhen me pavarësinë dhe sigurinë e gjyqtarëve në një mënyrë më të plotë.
- iii. Organizuar takime dhe forume të rregullta ku gjyqtarët dhe prokurorët mund t'i ngrisin shqetësimet dhe t'i parashtronin pyetjet.

Siç u përmend më herët, monitorimi i medias nga ekipi i Projektit regjistroi raste në të cilat politikanë, persona me ndikim dhe gazetarë komentuan në mënyrë të papërshtatshme për rastet në zhvillim e sipër.

Në katër raste të korrupsionit të nivelit të lartë dhe në tre raste të krimit të organizuar të nivelit të lartë, zyrtarët publikë i komentuan në mënyrë të papërshtatshme procedurat penale në zhvillim. Për shembull, në një nga këto raste, politikanët e kritikuan ashpër një lirim jo-përfundimtar nga gjykata e shkallës së parë. Në tre raste janë bërë vërejtje të padrejta në lidhje me lirimin nga burgu të disa të pandehurve, disa prej tyre me status të Lartë+ përse i përket metodologjisë së monitorimit

të gjykimit të Projektit. Të dy gjyqtarët dhe prokurorët ranë dakord me përfundimin e Projektit dhe shprehën shqetësime të ngjashme gjatë konsultimeve.

Konsultimet konfirmuan gjithashtu se mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e pavarësisë dhe autonomisë janë të pamjaftueshëm. Sipas nenit 27 (6) të Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe për Gjyqtarët, dhe nenit 37 (9) të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, gjyqtarët dhe prokurorët mund të ankohen në këshillat e tyre përkatëse nëse konsiderojnë se pavarësia e tyre është dëmtuar, ndërsa Këshillat janë të obliguara që të mbajnë qëndrim për këto ankesa.

Megjithatë, edhe pse disa anëtarë të gjyqësorit i'u ankuan ekipit të Projektit për presionin që u bëhet nga raportimet e mediave dhe komentet e politikanëve, anëtarët e këshilluar të këshillave deklaruan se gjyqtarët dhe prokurorët nuk i kishin paraqitur

asnjëherë këto lloj ankesash. Ata gjithashtu ranë dakord me Projektin që këto mekanizma duhet të forcohen, pasi reagimet adekuate ndaj komenteve të papërshtatshme mund t'i pengojnë komentet e panevojshme në të ardhmen.

## Efikasiteti

### 4

#### Rekomandim

**Gjykata Supreme duhet që ta krijojë një grup pune për zhvillimin e një sistemi të peshimit të rasteve në mënyrë që të sigurojë burime të përshtatshme dhe gjykim efikas të rasteve të KOK:**

i. Grupi punues duhet që t'i zhvillojë kriteret e nevojshme për krijimin e një sistemi të peshimit të rasteve. Kjo do ta përfshinte marrjen në konsideratë të disa faktorëve, duke përfshirë llojin e veprave penale, numrin e të pandehurve, rrethanat specifike të secilit rast, kohën e nevojshme për ta studiuar çdo rast, barrën e gjyqtarëve dhe burimet në dispozicion, siç është stafi i gjykatës.

ii. Sistemi i peshimit të rasteve duhet të integrohet në proceset vendimmarrëse nga Këshilli Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur merren vendime për ndarjen e burimeve, përfshirë burimet njerëzore dhe buxhetore, për Gjykatën e Lartë në Podgoricë. Sistemi duhet të jetë mjaft fleksibël për t'iu përshtatur procesit të vazhdueshëm të vendosjes së një sistemi të rishikuar elektronik të menaxhimit të rasteve në gjykata.

iii. Për ta nxitur vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm, pasi që sistemi të jetë vënë në jetë, duhet të ketë vlerësime dhe përditësime të rregullta për ta siguruar rëndësinë dhe efektivitetin

e tij të vazhdueshëm. Kjo duhet të përfshijë mbajtjen e sistemit në përputhje me zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm informacioni në gjyqësor.

Gjetjet e ekipit të projektit tregojnë se kohëzgjatja e procedurave gjyqësore është një nga çështjet kryesore që e minon efikasitetin e drejtësisë. Një nga arsyet e proceseve të gjata, siç konfirmohet nga gjyqtarët e konsultuar, është barra e tepërt e gjyqtarëve në Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë, e përkeqësuar nga kompleksiteti i çështjeve. Sipas standardeve të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), peshimi i rasteve është një sistem që u mundëson akterëve gjyqësorë ta vlerësojnë kompleksitetin e llojeve të ndryshme të rasteve.<sup>117</sup>

Ky vlerësim u nënkupton të kuptuarit se çdo lloj rasti ndryshon për sa i përket sasisë së kohës dhe përpjekjes gjyqësore që kërkohet për ta trajtuar atë. Prandaj, grupi punues duhet të marrë në konsideratë të gjitha “ngjarjet e lidhura me rastin” për ta përcaktuar kohën aktuale të punës që kërkohet për përfundimin e një rasti dhe jo kohën e disponimit. Në këtë drejtim, ai duhet ta përshtat metodën Delphi<sup>118</sup> për të marrë vlerësime në kohë reale të kohës së shpenzuar në një rast. Kjo do të përfshinte një vetëvlerësim të kohës së nevojshme për të punuar në një çështje

nga gjyqtarët pjesëmarrës në grupin punues. Në bazë të këtyre kriterëve, çdo çështje duhet të kategorizohet në mënyrë të përshtatshme qysh me formimin e saj në gjykatë.

Sistemi i peshimit të rasteve do ta lehtësonte më mirë një shpërndarje të barabartë të rasteve dhe do të kontribuonte në një vlerësim më të drejtë të gjyqtarëve. Ai do të shërbente gjithashtu për një sërë qëllimesh të tjera, duke përfshirë ndihmën në përcaktimin më efektiv të numrit të kërkuar të gjyqtarëve dhe ndihmësve gjyqësorë në Departamentin e Specializuar në Gjykatën e Lartë në Podgoricë. Grupi punues duhet t'i marrë parasysh mësimet e nxjerra nga përpjekjet e mëparshme të Malit të Zi për peshimin e rasteve në vitin 2015 në mënyrë që të shmangen gabimet e së kaluarës dhe për t'i përmirësuar përpjekjet e mëparshme. Për më tepër, Projekti e rekomandon fuqimisht rishikimin gjithëpërfshirës të përdorimit të sistemeve të peshimit të rasteve në vende të tjera, si në Austri, Danimarkë, Estoni, Gjermani, Holandë dhe Rumani<sup>119</sup>, në mënyrë që të krahasohet në mënyrë efektive dhe të sigurohet pronësia e rrugës para nesh.

<sup>117</sup> CEPEJ, Peshimi i rasteve në sistemet gjyqësore, faqe 4, në dispozicion në: [16809ede97 \(coe.int\)](#)

<sup>118</sup> Metoda Delphi është një nga modelet e peshimit të rasteve që përdoret për të mbledhur vlerësime të sasisë mesatare të kohës së punës që kërkohet për rast bazuar në vetë-raportimin e gjyqtarëve.

<sup>119</sup> CCEPEJ, Peshimi i rasteve në sistemet gjyqësore, faqe 18, në dispozicion në: [16809ede97 \(coe.int\)](#)

**Sigurimi i procedurave me kohë përmes përcaktimit të afateve kohore të parapara për përpunimin e rasteve të KOK dhe përmes forcimit të rolit menaxhues të kryetarëve të gjykatave:**

- i. Gjykata Supreme duhet që ta krijojë një grup pune për krijimin e standardeve optimale të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore në rastet e KOK. Këto standarde duhet që ta përfshijnë një mekanizëm monitorues, i cili do ta mundësonte mbledhjen e të dhënave për kohëzgjatjen e procedurave për qëllime të politikëbërjes dhe të rivlerësimit. Kjo do të ishte thelbësore për politikëbërjen dhe rivlerësimin e standardeve me kalimin e kohës.
- ii. Kryetarët e gjykatave, siç sugjerohet nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) dhe CEPEJ, duhet që ta monitorojnë kohëzgjatjen e procedurave dhe të mbledhin të dhëna për hapat e rëndësishëm në procesin gjyqësor.

Në kohën e shkrimit të këtij raporti, kohëzgjatja mesatare e rasteve në zhvillim e sipër që janë monitoruar nga Projekti ishte 39 muaj, duke filluar nga konfirmimi i aktakuzës.

Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në zhvillim, 10 janë në fazën paraprake, 39 në fazën e shqyrtimit kryesor, gjashtë janë në fazën e ankesës dhe dy janë në fazën e rigjyimit. Në një rast, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar për 121 muaj. Kohëzgjatja mesatare e provave të përfunduara të shkallës së parë është 37 muaj.

I njëjti grup punues i ngarkuar me krijimin e sistemit të peshimit të rasteve mund ta përcaktojë gjithashtu kohëzgjatjen e pranueshme të procedimeve në rastet e KOK. Duke vepruar kështu, grupi i punës duhet ta marrë parasysh peshën e një kategorie të caktuar rastesh, si dhe standardet e GJEDNJ-së në lidhje me të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Grupi mund të mësojë nga juridiksionet tjera me sisteme të ngjashme gjyqësore në këtë drejtim, si Finlanda, Letonia, Norvegjia dhe Sllovenia.<sup>120</sup>

<sup>120</sup> CEPEJ, Përmbledhje e praktikave më të mira për menaxhimin e kohës së procedurave gjyqësore, 2006, në dispozicion [Compendium \(coe.int\)](http://coe.int).



Projekti konsideron se kryetarët e gjykatave e kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit të procedurave. Kjo është në përputhje me standardet ndërkombëtare, pasi si KKGJE ashtu edhe CEPEJ i inkurajojnë kryetarët e gjykatave që ta monitorojnë kohëzgjatjen e procedimit, të mbledhin informacione lidhur me hapat më të rëndësishëm dhe ta regjistrojnë kohëzgjatjen e çdo faze individuale të procesit gjyqësor.<sup>121</sup>

Megjithatë, gjetjet e mbledhura nga monitorimi i rasteve si dhe nga konsultimet me palët përkatëse të interesit, sugjerojnë se kryetarët e gjykatave duket se nuk i përdorin të dhënat e disponueshme për

kohëzgjatjen e procedurave për qëllime analitike dhe vendimmarrëse. Kryetarët e gjykatave ose administratorët përkatës të menaxhimit të rasteve duhet gjithashtu t'i monitorojnë të dhënat rreth shpërndarjes së barrës së punës për këshilltarët gjyqësorë. Kjo do të ndihmonte në matjen e efikasitetit duke e vlerësuar raportin ndërmjet personelit të punësuar dhe rasteve të proceduara.

Përveç kësaj, kryetarët e gjykatave mund ta caktojnë një person përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave në lidhje me rrjedhën e lëndëve. Ky administrator i caktuar do t'i ofronte informata të përditësuara kryetarit të gjykatës në faza të veçanta të procesit.

## 6

### Rekomandim

#### **Miratimi i standardeve të menaxhimit të proceseve gjyqësore për t'i ndihmuar gjyqtarët në përgatitjen dhe trajtimin e rasteve të KOK:**

i. Gjykata Supreme duhet të zhvillojë udhëzime mbi praktikën më të mira të menaxhimit të proceseve gjyqësore për t'i ndihmuar gjyqtarët në përgatitjen dhe drejtimin e rasteve të KOK. Këto duhet t'i mbulojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të gjykimit nga gjyqtarët, me një fokus të veçantë në udhëzimin e gjyqtarëve se si ta zhvillojnë një konferencë për statusin, të arrijnë një marrëveshje me palët për kalendarin procedural të gjykimeve dhe të minimizojnë devijimet nga kalendari i dakorduar. Udhëzimet duhet të përmbajnë instruksione se si të veprohet kur lindin disa nga pengesat procedurale më të shpeshta, duke përfshirë,

<sup>121</sup> KKGJE, Opinion mbi Rolin e Kryetarëve të Gjykatave, faqe 4, në dispozicion në CCJE(2016)2REV2 (coe.int); CEPEJ, Udhëzimet e rishikuara të Saturnit për Menaxhimin e Kohës Gjyqësore, faqe 7, në dispozicion në TE0801648 (coe.int).

## Rekomandim

për shembull, mungesën e të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës, kërkesat për shtyrje, taktikat tjera zvarritëse dhe mungesën e sallave të gjyqit.

ii. Këshilli Gjyqësor dhe organet e tij duhet të sigurohen që procesi i vlerësimit të gjyqtarëve ta përfshijë dhe vlerësojë në mënyrë adekuate aftësinë e gjyqtarëve për t'i përgatitur dhe planifikuar gjykimet, duke marrë parasysh udhëzimet e Gjykatës Supreme.

Siç është theksuar në rekomandimet 4 dhe 5, ekipi i projektit ka parë shtyrje të shpeshta të seancave në rastet e KOK. Për shembull, nga shtatori 2021 deri në mars 2024 ka pasur vetëm shtatë seanca produktive mesatarisht në muaj në të gjitha rastet që janë monitoruar. Arsyet kryesore të shtyrjes ishin mungesa e të pandehurve në 152 seanca, nga të cilat 72 seanca u shtynë për arsye shëndetësore, mungesës së avokatëve mbrojtës në 78 seanca dhe mungesës së gjyqtarëve në 51 seanca.

Përveç mungesës së burimeve njerëzore dhe materiale, duke përfshirë sallat e gjyqit, qasjet pasive të gjyqtarëve gjithashtu kontribuuan në shumë shtyrje. Kjo mund të zbutet duke e planifikuar zhvillimin e procedimeve, veçanërisht duke e përcaktuar një plan gjykimi, një afati kohor dhe listës së veprimeve procedurale që duhet të ndërmerren.

Megjithatë, ekipi i projektit arriti në përfundimin se gjyqtarët nuk i ndërmarrin këto veprime. Në të vërtetë, konferencat e statusit nuk u organizuan në asnjë nga rastet që janë monitoruar edhe pse KPP e parashikon atë si një mjet për planifikimin e gjykimeve.

Ekipi i Projektit i ka vëzhguar disa raste në të cilat gjyqtarët mund t'i kishin shmangur shtyrjet nëse do ta kishin marrë një qasje më proaktive dhe po ta kishin planifikuar rrjedhën e gjykimet. Për shembull, në të paktën pesë raste, gjyqtari nuk ishte i përgatitur të vazhdonte me shqyrtimin e provave të tjera edhe pse koha e caktuar për seancën do ta kishte lejuar këtë.

Në dy raste, seanca është dashur të shtyhet për shkak se gjykata nuk ia ka dorëzuar aktakuzën të pandehurve, edhe pse kanë kaluar disa muaj nga ngritja e aktakuzës.

Në të paktën dy raste, gjyqtarët e shtynë seancën me kërkesë të avokatëve, edhe pse ishin plotësuar kërkesat procedurale për mbajtjen e seancës.

Në raste tjera, Projekti gjithashtu vuri re se sëmundja e vazhdueshme e të pandehurve në tre raste të ndryshme e pengoi edhe fillimin e gjykimeve, por gjyqtarët nuk morën masa efektive për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Në rrethana të tilla, gjyqtarët mund ta sigurojnë praninë e të pandehurve nëpërmjet videokonferencës.<sup>122</sup>

Gjatë periudhës raportuese, avokatët mbrojtës i kanë paraqitur të paktën 18 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke shkaktuar shtyrje të seancave.

Për këtë arsye, udhëzimet e sipërpërmendura për menaxhimin e gjykimit duhet ta trajtojnë mënyrën se si gjyqtarët mund ta trajtojnë këtë çështje në mënyrë më efikase, duke i parandaluar kështu shtyrjet e panevojshme dhe taktikat zvarritëse të avokatëve mbrojtës.

Vonesat e panevojshme po kontribuojnë në gjykime tepër të gjata, duke pasur implikime të mëdha në administrimin e drejtësisë. Në një rast të monitoruar, gjykimi është zhvilluar në mënyrë joefikase, duke rezultuar në pushimin e akuzës për shkak të parashkrimit absolut.

Në një rast tjetër, i pandehuri u lirua nga paraburgimi pasi kishte kaluar në paraburgim maksimumin e paraparë me ligj prej tre vitesh. Që nga lirimi i tyre, ata kanë munguar në seanca gjyqësore.

Duke i pasur parasysh këta faktorë, Projekti e rekomandon standardizimin e caktimit të seancave dëgjimore në rastet e KOK për ta siguruar angazhimin e palëve dhe përshtatshmërinë e procedurave.

Meqenëse rekomandimi 6 i plotëson përpjekjet e rekomanduara sipas rekomandimit 4, Gjykata Supreme mund ta shqyrtojë delegimin e hartimit të udhëzimeve të grupi i punës i krijuar me qëllim të krijimit të sistemit të peshimit të rasteve.

<sup>122</sup> Vendimi i GJEDNJ në rastin e Marcello Viola kundër Italisë, aplikimi 45106/04, para.67, i disponueshëm në MARCELLO VIOLA kundër ITALY [Ekstrakte] (coe.int); CEPEJ, Udhëzime për videokonferencat në procedurat gjyqësore, në dispozicion në <https://edoc.coe.int/en/efficiency-of-justice/10706-guidelines-on-videoconferencing-in-judicial-proceedings.html>

**Për ta rritur efikasitetin, juridiksioni lëndor i ZPS-së dhe i Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë duhet të ngushtohet. Veçanërisht:**

i. Ministria e Drejtësisë duhet të vendos se si ta kufizojë juridiksionin lëndor në lidhje me rastet e korrupsionit. Për këtë qëllim, ky grup pune duhet ta shqyrtojë rishikimin e përkufizimit aktual ligjor të “zyrtarit publik” për t’i identifikuar dhe kuptuar mangësitë e tij. Gjithashtu duhet të konsiderojë përfshirjen e një termi të ri (p.sh., zyrtar publik i nivelit të lartë) në Ligjin për Prokurorinë Speciale.

Gjatë konsultimeve të ekipit të projektit, shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve e identifikuan ngarkesën e rasteve si një nga shkaqet kryesore të vonesave në procedurat gjyqësore. Në këtë aspekt, ata ranë dakord që ngushtimi i juridiksionit lëndor të ZPS-së dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë mund ta rriste efikasitetin e punës së tyre.

Një mënyrë e qartë për ta reduktuar numrin e rasteve nën juridiksionin e organeve të specializuara do të ishte rishikimi i përkufizimit të zyrtarit publik, pasi ky term lidhet me juridiksionin lëndor në çështjet e korrupsionit të ZPS-së dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë. Përkufizimi, siç është aktualisht, është shumë i gjerë dhe i paqartë, veçanërisht pasi duket se e përfshin një gamë të gjerë personash që punojnë në sektorin

publik. Aktualisht, nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi se cila kategori e zyrtarëve publikë hyn në përkufizimin e korrupsionit të lartë në nenin 3 (2) të Ligjit për Prokurorinë Speciale dhe nenin 16 (2) pika 2 të Ligjit për Gjykatat.

Në fakt, është e vështirë të vlerësohet nëse çështja duhet të jetë nën juridiksionin e ZPS-së dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë të Podgoricës.

Kjo paqartësi krijon dy çështje. Së pari, ndonjëherë çon në konflikte ndërmjet juridiksioneve të gjykatave, siç vërehet në dy raste që janë nën monitorim. Së dyti, e shkakton një fluks të lartë rastesh për këto organe të specializuara, të cilat kanë burime njerëzore të kufizuara, veçanërisht pasi jo të gjitha këto raste kërkojnë

kualifikim dhe specializim të lartë për t'u ndjekur dhe gjykuar. Duke e reduktuar numrin e rasteve që prokurorët dhe gjyqtarët duhet t'i trajtojnë në organet e tyre përkatëse të specializuara, cilësia

e punës së tyre do të rritet, pasi ata mund të fokusohen në disa raste të përzgjedhura në vend të rasteve të shumta me kompleksitet dhe "urgjencë" të ndryshme

8

Rekomandim

**Qeveria e Malit të Zi duhet të sigurojë ambiente të përshtatshme për ZPS-në dhe Gjykatën e Lartë në Podgoricë dhe t'i sigurojë dhe pajis ato në mënyrë adekuate.**

Gjatë konsultimeve me gjyqtarët, ata e identifikuan mungesën e sallave të gjyqit si një nga arsyet kryesore të mosrespektimit të afateve të Kodit të Procedurës Penale.

Ekipi i Projektit gjithashtu zbuloi se mungesa e sallave të gjyqit po e dëmton efikasitetin e gjyqësorit në lidhje me rastet e KOK.

Shumë shpesh, ekipi ka vënë re se gjyqtarët ishin të detyruar t'i caktonin seancat shumë përtej afateve procedurale, sepse ata nuk mund të gjenin një sallë gjyqi të disponueshme më herët. Janë në dispozicion vetëm dy salla gjyqi, dhe që të dy sallat përdoren

nga Departamenti i Specializuar dhe Departamenti i rregullt Penal i Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

Përveç kësaj, ZPS-së duhet gjithashtu t'i sigurohen ambiente të përshtatshme dhe të sigurta në mënyrë që të sigurohet që prokurorët janë të sigurt kur i hetojnë dhe ndjekin penalisht grupet e organizuara kriminale. Duke qenë se ndërtimi i objekteve të reja do të marrë kohë, Projekti i kërkon Qeverisë që t'i zgjidhë këto çështje sa më shpejt që të jetë e mundur duke dalë me një zgjidhje të përkohshme por të menjëhershme për t'i adresuar nevojat e ZPS-së dhe Gjykatës së Lartë në Podgoricë.

**Autoritetet kombëtare duhet t'i përcaktojnë dhe tu japin përparësi rasteve të KOK të nivelit të lartë, përkatësisht:**

i. Ministria e Drejtësisë duhet të miratojë akte nënligjore për t'i përcaktuar rastet e KOK për qëllime statistikore dhe politikëbërëse. Për të njëjtat qëllime, ata duhet të miratojnë kriteret shtesë për t'i dalluar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar nga korrupsioni "standard" dhe rastet e organizuara.

ii. Bazuar në këtë sistem kategorizimi, ZPS dhe Gjykata e Lartë në Podgoricë duhet të marrin në konsideratë:

- Ti jap prioritet ndjekjes penale dhe gjyqimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë miratimin e planeve të punës për trajtimin e rasteve të tilla.
- T'i hartoj rastet e KOK të nivelit të lartë për t'i ndarë burimet e duhura për ZPS dhe Gjykatën e Lartë, të cilat janë më të përfshira në trajtimin e tyre.
- Të sigurohen që kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve t'i pasqyrojnë në mënyrë adekuate sfidat specifike të paraqitura nga trajtimi i rasteve të KOK të nivelit të lartë.

Në Strategjinë e tij për Ballkanin Perëndimor 2018, Komisioni Evropian nënvizoi se rruga drejt zgjerimit kërkon krijimin, si çështje urgjente, të "një historiku konkret dhe të qëndrueshëm lidhur me trajtimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimin të organizuar".<sup>123</sup>

Parakushti për krijimin e këtij historiku është krijimi i një sistemi kategorizimi të përshtatur mirë dhe të besueshëm

për t'i identifikuar rastet e KOK dhe rastet e KOK të nivelit të lartë.

Kategorizimi i rasteve të KOK dhe rasteve të KOK të nivelit të lartë, së paku, do t'u mundësonte institucioneve vendase të prodhojnë statistika solide për përpunimin e rasteve të tilla, duke e lehtësuar në këtë mënyrë matjen e progresit ose regresionit në krijimin e historikut të sipërpërmendur.

<sup>123</sup> [Balkans BorchureA5 V7.indd \(europa.eu\)](#), faqe 5.

Ligjet të cilat e përcaktojnë juridiksionin lëndor të ZPS-së dhe Departamentit të Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë nuk ofrojnë përkufizime adekuate të asaj që duhet të konsiderohet si krim i organizuar ose korrupsion i nivelit të lartë.

Në fakt, ai juridiksion e mbulon çdo lloj rasti të krimit të organizuar, pavarësisht nga serioziteti i tij si dhe veprat penale të lidhura me korrupsionin të kryera nga çdo zyrtar publik, pavarësisht nga gradat e autorit dhe nga shuma e fitimit ose e dëmit të tepërt.

Si rezultat, statistikat e bazuara në numrin e rasteve të trajtuara nga organet speciale nuk e pasqyrojnë numrin real të rasteve të KOK të nivelit të lartë të trajtuara në Mal të Zi. Për këto arsye, autoritetet kombëtare duhet të miratojnë kritere ad-hoc për përcaktimin e rasteve të tilla në mënyrë të pavarur nga korniza e ligjit penal dhe veçanërisht për qëllime të politikëbërjes. Kriteret në fjalë duhet t'i përfshijnë tiparet thelbësore të një rasti

të nivelit të lartë për sa i përket seriozitetit dhe kompleksitetit të tij, duke qenë në të njëjtën kohë mjaftueshëm të qarta dhe të lehta për t'u zbatuar.<sup>124</sup>

Ky sistem kategorizimi mund të përdoret për t'i dhënë përparësi ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë dhe për t'i rialokuar burimet njerëzore dhe materiale aty ku nevojiten më shumë.

Në planet vjetore të punës së Gjykatës së Lartë në Podgoricë dhe ZPS-së mund të parashikohen synime specifike lidhur me procedimin e këtij lloji të rasteve.

Së fundi, kriteret e vlerësimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët duhet ta pasqyrojnë punën dhe sfidat shtesë që kërkohen nga rastet e KOK të nivelit të lartë, duke pasur parasysh se këto raste i vënë gjyqtarët nën presion më të madh, kërkojnë njohuri të specializuara dhe shpesh janë komplekse dhe përfshijnë një numër të madh të pandehurish.

<sup>124</sup> Kriteret e miratuara nga gjyqësori në Bosnje dhe Hercegovinë për këtë qëllim mund të përbëjnë një model të mirë nga Ballkani Perëndimor; shih UasXoWOPUpr7dDuta69ZNpWy9RHHOZvfFMN4glwl.pdf (usaidjaca.ba)

## Kapaciteti

10

### Rekomandim

**Të fuqizohen kapacitetet e prokurorëve dhe gjyqtarëve lidhur me procedimin e rasteve të pastrimit të parave në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në veçanti:**

i. Gjykata Supreme dhe ZPLSH duhet që ta krijojnë një grup pune për të përpiluar udhëzime për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave të pastrimit të parave. Udhëzimet duhet ta sqarojnë çdo paqartësi në zbatimin e dispozitave, veçanërisht nëse pastrimi i parave mund të ndiqet penalisht si një vepër më vete (d.m.th., pa e ndjekur penalisht veprën kryesore), duke marrë parasysh gjithashtu qëndrimin ligjor eventual të Gjykatës Supreme të sugjeruar sipas rekomandimit 14 më poshtë.

ii. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Shtetit, në bashkëpunim me ZPS-në dhe Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë, duhet që ta zhvillojë një program të specializuar për prokurorët e përfshirë në procedimin e rasteve të pastrimit të parave.

iii. ZPS, së bashku me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF), duhet që ta prezantojnë një regjistër të përditësuar për tipologjitë e pastrimit të parave. Regjistri duhet të mbajë të dhënat e tipologjive dhe raporteve të rasteve të pastrimit të parave, duke ndihmuar në kuptimin dhe zbulimin më të mirë të aktiviteteve që e zbulojnë pastrimin e parasë. Ai mund të frymëzohet nga praktikat më të mira të zhvilluara nga Misioni i OSBE-së në Serbi. Në këtë aspekt mund të kërkohet edhe ndihma ndërkombëtare.

iv. Autoritetet kombëtare duhet që ta shfrytëzojnë anëtarësimin e tyre në rrjetet e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Për shembull, NJIF e Malit të Zi duhet që ta përdorë në tërësi anëtarësimin e tij në Grupin Egmont të Njërive të Inteligjencës Financiare (EGMONT) për një shkëmbim efektiv informacionesh me NJIF të vendeve të tjera.



Gjithashtu, krijimi i Ekipeve të Përbashkëta Hetimore (EPH), të mbështetura nga Eurojust dhe/ose Europol, duhet që të përdoret më shpesh.

Ekipi i Projektit vuri re se shumica e rasteve të monitoruara me akuza për pastrim parash u ndoqën penalisht njëkohësisht me një vepër kryesore. Gjatë konsultimeve, prokurorët e konfirmuan se ata nuk ndoqën penalisht vepra të pavarura të pastrimit të parave, pasi duhej të dinin saktësisht se cila vepër kryesore e gjeneronte fitimin. Ata gjithashtu e pranuan se nuk ekziston një kuptim i përbashkët i termit "veprimtari kriminale" në nenin 268 të Kodit Penal.

Duhet të theksohet se, sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare, veçanërisht rekomandimeve të Task Forcës së Veprimit Financiar (TFVF) dhe Konventës së Varshavës, një dënim paraprak ose i njëkohshëm për veprën penale kryesore nuk duhet të jetë parakusht për një dënim për pastrim parash. Prandaj, për ta vërtetuar se prona i përfaqëson të ardhurat nga një vepër penale, nuk është e nevojshme që prokurorët ta përcaktojnë saktësisht se cila vepër penale e ka krijuar pasurinë.<sup>125</sup> Në pajtim me rrethanat, Gjykata Supreme e Spanjës vendosi se nuk është e nevojshme të vërtetohen të gjithë elementët faktikë të veprës

penale kryesore në rastet e pastrimit të parave, duke i lejuar dëshmitë nëpërmjet provave indirekte ose rrethanore.<sup>126</sup> Për këtë provë u krijuan tre kërkesa: rritja e pashpjegueshme e pasurisë ose transaksione të pazakonta, mungesa e aktiviteteve ligjore të cilat i shpjegojnë rritjet e tilla dhe lidhja me aktivitetin kriminal (siç është një lidhje me hetimet kriminale ose regjistrimet e pazakonta kontabël). Në mënyrë të ngjashme, Gjykata e Apelit të Amsterdimit e krijoi një plan hap pas hapi për vërtetimin e pastrimit të parave nëse vepra kryesore është e panjohur, e mbështetur nga një tipologji e NJIF e cila përmban aktivitete indikuese të pastrimit të parave.<sup>127</sup> Deri më tani, Projekti e ka identifikuar një rast të vetëm me akuza të pavarura për pastrim parash – dhe asnjë vepër penale kryesore – për tu monitoruar.

Edhe pse ende pioniere në aspektin e praktikës gjyqësore malazeze, aktakuza u konfirmua dhe kështu do ta ofrojë një mundësi për ta shqyrtuar ndjekjen dhe gjykimin e kësaj vepre në Mal të Zi me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe me praktikat më të mira nga jashtë.

<sup>125</sup> GJEDNJ vendosi në çështjen Zschüschen kundër Belgjikës (aplikacioni 23572/07, i disponueshëm në <https://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=002-11638>) se dënimi për pastrim parash pa një vepër të njohur kryesore është i pranueshëm, sipas Konventës së Varshavës. Gjykata e gjeti të drejtë që të dyshuarit janë të detyruar të japin shpjegime të besueshme për pasuritë e tyre dhe pohoi se barra e provës nuk i është bartur të akuzuarit, dhe kështu nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të KEDNJ.

<sup>126</sup> Gjykata Supreme e Spanjës, STS 1509/2016 - ECLI:ES:TS:2016:1509, 29.03.2016., në dispozicion në [Consejo General del Poder Judicial: Buscador de contenidos](#).

<sup>127</sup> Gjykata e Apelit në Amsterdam, ECLI:NL:GHAMS:2013:BY8481, 11.03. 2013, disponohet në [Rechtspraak.nl - Search in rulings \(uitspraken-rechtspraak-nl.translate.google\)](#).

**Ngritja e cilësisë së aktakuzave, në veçanti:**

- i. ZPLSH duhet që ta krijojë një grup pune për përpilimin e udhëzimeve lidhur me cilësinë e aktakuzave. Udhëzimet duhet të jenë drejtuese, të përmbajnë shembuj të mirë ose praktika më të mira dhe ta ofrojnë një strukturë ose model të rekomanduar për t'i mësuar prokurorët në paraqitjen e rasteve të tyre në aktakuzë. Përveç kësaj, ZPLSH duhet që ta krijojë një Depozit Aktakuzash të aktakuzave të shkruara mirë për të shërbyer si shembuj për referencë në të ardhmen, e cila do të përditësohet rregullisht.
- ii. Paneli për Kontrollin e Aktakuzës duhet të sigurohet që aktakuzat që nuk janë në përputhje me kërkesat e nevojshme ligjore, të mos konfirmohen.
- iii. Qendra për Trajnime në Shërimin Gjyqësor dhe Shërbimin Prokurorial duhet që ta bëjë një program trajnimi efektiv për shkrimin ligjor për prokurorët. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet formës dhe arsytimit të aktakuzave.
- iv. Këshilli Prokurorial duhet që t'i rishikojë treguesit e performancës në lidhje me cilësinë e vendimeve me shkrim në sistemet e menaxhimit të performancës së prokurorëve në mënyrë që të krijojë stimuj shtesë për aktakuza të cilësisë së lartë.

Ekipi i Projektit ka vërejtur mangësi të ndryshme në aktakuzat e shqyrtuara në të paktën 26 raste. Ato përfshijnë akuza të pavërtetuara, shpjegim të pamjaftueshëm të lidhjes ndërmjet provave dhe akuzave, arsyetim të mangët në lidhje me secilin element të veprës penale dhe mungesë të

lexueshmërisë dhe koncizitetit. Për më tepër, niveli i arsytimit dhe stili i të shkruarit ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme, ndërkohë që arsytimit shpesh i mungon një pasqyrë analitike e akuzave dhe e konkluzionit të prokurorit. Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, gjykata shpesh u përpoq t'i

vërtetonte disa nga faktet kyçe të rastit, ndërsa prokuroria në mënyrë të rregullt nuk arriti të demonstrojë se si ato fakte lidhen me akuzat e përcaktuara në aktakuzë.

Përpjekjet për të shtjelluar elemente të veçanta të veprës penale, veçanërisht elementin e saj mendor, rezultuan sfiduese edhe në rastet e korrupsionit. Sa i përket aktakuzave me akuzat për krim të organizuar, ekipi i Projektit ka vërejtur në të paktën dhjetë aktakuza që prokurorët neglizhojnë të arsyetojnë se si një grup i supozuar kriminal i ka përmbushur kërkesat nga neni 401a i KPP-së.

Disa nga gjyqtarët e konsultuar nga Projekti e konfirmuan këtë dhe deklaruan se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet kualifikimit të veprës penale nga neni 401a i KPP-së, sepse neglizhimi për t'i provuar të gjitha elementet e saj mund të rezultojë në tërheqjen e akuzave ose në lirim. Në tre raste me vendime liruese të shkallës së parë, Projekti i vërejti mangësitë e listuara më sipër, të cilat mund të kenë kontribuar në rezultat.

Për këto arsye, udhëzimet për cilësinë e aktakuzave mund t'i ndihmojnë prokurorët në hartimin e aktakuzave më cilësore. Udhëzimet duhet ta theksojnë rëndësinë e deklarimit të arsyeve si një element thelbësor i një aktakuze dhe të ofrojnë këshilla se si të

arrihet kjo gjë më së miri. Ato gjithashtu duhet ta ndihmojnë kryesisht prokurorin në lidhjen e provave me akuzat të veçanta, në mënyrë që të mundësohet që paraqitja e akuzave të jetë sa më e saktë që është e mundur.<sup>128</sup>

Për më tepër, trupi gjykues për kontrollin e aktakuzës duhet të jetë më efektiv në shqyrtimin e tij gjyqësor. Gjatë periudhës raportuese, trupi gjykues në disa raste nuk ka vendosur për pranueshmërinë e provave të caktuara në rastet nën monitorim, edhe pse mbrojtja e ka theksuar papranueshmërinë e tyre.

Ky problem ishte veçanërisht i dukshëm në rastet në të cilat aktakuza bazohej kryesisht në të dhënat e marra nga aplikacionet e koduara të mesazheve. Në disa raste, një pjesë e provave ishte shpallur e papranueshme në një fazë të vonshme gjatë gjykimit, edhe pse mbrojtja kishte theksuar papranueshmërinë e saj gjatë kontrollit të fazës së aktakuzës.

Kjo çështje u ngrit edhe nga prokurorët dhe avokatët e konsultuar nga ekipi i Projektit. Të dy palët pretenduan se ishte me rëndësi të madhe që gjyqtarët ta kontrollonin ligjshmërinë e provave në fazën e kontrollit të aktakuzës për ta shmangur konfirmimin e aktakuzave të gabuara. Për të sqaruar se kjo është detyrë e trupit gjykues për kontrollin e aktakuzës, Gjykata Supreme duhet të marrë qëndrim, siç propozohet në rekomandimin 14.

<sup>128</sup> Shih një shembull këtu: <https://www.osce.org/files/f/documents/f/d/528222.pdf>, faqet 93-94.

Aktakuza me cilësi më të lartë do të mund të arrihej edhe me ndryshimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së punës së prokurorëve. Në këtë drejtim, ekipi i projektit vërejti se të gjithë treguesit ekzistues janë të natyrës sasiore, që do të thotë se prokurorët vlerësohen në bazë të përqindjes së aktakuzave të konfirmuara dhe aktgjykimeve dënuese.

Për ta arritur një vlerësim sa më thelbësor të punës së tyre, Këshilli Prokurorial duhet të hartojë kriterë objektive në bazë të të cilave do ta vlerësonte cilësinë e arsytimit në aktakuza dhe në aktet tjera. Domosdoshmëria e një ndryshimi të tillë u pranua edhe nga prokurorët dhe anëtarët e Këshillit Prokurorial gjatë konsultimeve.

12

## Rekomandim

### **Rritja e cilësisë së arsytimit të vendimeve gjyqësore, veçanërisht gjykimeve dhe vendimeve që e urdhërojnë dhe e zgjasin paraburgimin:**

i. Gjykata Supreme duhet që ta krijojë një grup pune për përpilimin e udhëzimeve lidhur me cilësinë e gjykimeve dhe vendimeve të tjera gjyqësore, veçanërisht në lidhje me paraburgimin ose masat alternative. Udhëzimet duhet të jenë drejtuese, të përmbajnë shembuj të mirë ose praktika më të mira dhe ta ofrojnë një strukturë ose model të rekomanduar për të mësuar gjyqtarët lidhur me paraqitjen e arsytimit të tyre në gjykime/vendime gjyqësore.

ii. Këshilli Gjyqësor duhet t'i rishikojë treguesit e performancës në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore në menaxhimin e performancës për gjyqtarët, duke i integruar udhëzimet e reja në procesin e vlerësimit. Përveç kësaj, sigurimi i trajnimit adekuat të komisionit vlerësues për zbatimin e këtyre standardeve të reja është gjithashtu i rëndësishëm.

iii. Qendra për Trajnime në Shërbimin Gjyqësor dhe duhet ta vendosë një program trajnimi efektiv lidhur me shkrimin ligjor për gjyqtarët. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet formës dhe arsytimit të vendimeve.

Projekti ka vënë re arsyetime të pamjaftueshme në vendimet gjyqësore për një sërë rastesh që janë monitoruar. Në të paktën tre aktgjykime të analizuara, gjyqtarët kryesisht i transkriptuan provat me shkrim, deklaratat e dëshmitarëve ose mendimet e ekspertëve pa ofruar një pasqyrë adekuate, analitike të tyre.<sup>129</sup>

Përveç kësaj, shpesh mbetet e paqartë pse gjykata ka zgjedhur të mbështetet në disa prova në kurriz të tjetrës. Gjithashtu, në të paktën katër aktgjykime të shqyrtuara gjatë periudhës raportuese, gjykata hasi në sfida në arsyetimin e mens rea (elementit mendor) si një nga elementët e detyrueshëm të veprës penale. Në të paktën 61 vendime të dhëna për MPF-të, gjykata është mbështetur tej mase në rrethanat veçanërisht lehtësuese, të deklaruara nga prokuroria, pa u përfshirë në një reflektim kritik. Gjykatat i konfirmuan MPF-të me sanksione të buta pa e arsyetuar se si janë ato në përputhje me "interesin e drejtësisë", siç kërkohet nga neni 302 (8) pika 5 e KPP. Mangësitë e vërejtura në arsyetimin e vendimeve nuk ishin të kufizuara vetëm në vendime. Gjykatat gjithashtu përballëshin me sfida kur i arsyetonin vendimet në lidhje me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit, vendimet për lirimin me kusht dhe vendimet për gjykim në mungesë. Vendimeve të ndërlidhura me paraburgimin u mungonte shqyrtimi kritik i secilit prej arsyeve të paraburgimit, veçanërisht kur bëhej

fjalë për zgjatjen e tij. Gjatë periudhës raportuese, ekipi i Projektit vërejti një rritje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi që vërtetonin shkelje të së drejtës së lirisë së të pandehurve. Të paktën 12 vendime të këtij lloji janë identifikuar në shtatë raste.

Në përgjithësi, janë konstatuar shkelje për shkak se vendimet për paraburgim dhe refuzim të liritimit me kusht nuk ishin arsyetuar në mënyrë adekuate. Në shumicën e rasteve, Gjykata Kushtetuese e konsideroi arsyetimin të pamjaftueshëm për shkak se gjykatat e rregullta nuk kishin specifikuar rrethanat konkrete që e tregonin rrezikun e arratisjes së të pandehurve. Gjithashtu, shkeljet janë identifikuar për shkak se gjykatat e rregullta nuk e kishin arsyetuar në mënyrë adekuate ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm. Veçanërisht alarmante ishte konstatimi se Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të së drejtës së lirisë të të paktën pesë të pandehurve në katër raste më shumë se një herë.

Një nga masat e propozuara për ta korrigjuar këtë çështje është vlerësimi i aftësive të gjyqtarëve për t'i arsyetuar vendimet e tyre. Aktualisht, nuk ka standarde apo udhëzime të qarta për ta vlerësuar gjithpërfshirjen e argumentimit në vendimet gjyqësore. Prandaj, Këshilli Gjyqësor duhet që të zhvillojë tregues të besueshëm dhe të saktë për ta vlerësuar cilësinë e arsyetimit gjatë vlerësimit të performancës së gjyqtarëve.

<sup>129</sup> Neni 379 (7) i KPP kërkon që gjykata të tregojë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte konsiderohen të vërtetuara ose jo dhe pse, me theks të veçantë në besueshmërinë e provave kontradiktore.

### **Ngritja e kapaciteteve gjyqësore duke i fuqizuar aftësitë e këshilltarëve gjyqësorë. Veçanërisht:**

i. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe Prokurorial duhet t'i zgjerojë programet e saj për këshilltarët gjyqësorë dhe të përfshijë trajnime të specializuara lidhur me KOK për këshilltarët gjyqësorë që punojnë me gjyqtarët në Departamentin e Specializuar për t'i zhvilluar kapacitetet e tyre dhe për të ofruar ndihmë efektive për këta gjyqtarë.

ii. Gjykata e Lartë në Podgoricë duhet t'i mbledhë dhe analizojë të dhënat për punën e secilit këshilltar gjyqësor. Përveç kësaj, ajo duhet t'i rivlerësojë nevojat e saj organizative dhe t'i marrë parasysh kërkesat e gjyqtarëve individualë lidhur me barrën e punës. Bazuar në këtë vlerësim, gjykata mund ta përcaktojë numrin e nevojshëm të këshilltarëve, duke e inkorporuar këtë informacion në planin e saj të hershëm të punës.

Gjatë konsultimeve, ekipi i Projektit mësoi se kishte një nevojë urgjente për ta rritur numrin e këshilltarëve gjyqësorë në Departamentin e Specializuar të Gjykatës së Lartë në Podgoricë. Sipas vendimeve të publikuara të Gjykatës së Lartë në Podgoricë për rishpërndarjen e stafit, asnjë këshilltar gjyqësor nuk u transferua në Departamentin e Specializuar të saj në vitin 2023, pavarësisht se gjyqtarët gjatë konsultimeve konfirmuan se barra e Departamentit ishte në nivelin më të lartë në atë kohë. Për ta adresuar këtë

çështje, masat si emërimi dhe rialokimi i stafit të gjykatës në përputhje me nevojat e vlerësuara mund të jenë efektive. Duhet të ndërmerren gjithashtu hapa për ta fuqizuar ekspertizën e bashkëpunëtorëve gjyqësorë, pasi vetëm një ka përfituar nga trajnimi i specializuar (KOK) në 2022.<sup>130</sup>

Për më tepër, aftësia e gjyqtarëve për t'i organizuar dhe bashkërenduar punonjësit e gjykatës është një nga kriteret në vlerësimin e performancës së tyre. Kjo aftësi vlerësohet bazuar në të dhënat e mbledhura nga sistemi i

<sup>130</sup> Raporti vjetor i Qendrës për Trajnim në Gjyqësor dhe Shërbimin Prokurorial për vitin 2022, faqe 15, në dispozicion në: Godisnji-izvjestaj-o-radu-Centra-za-obuku-u-sudstvu-i-drzavnomo-tuzilastvu-za-2022.- godinu.pdf (cosdt.me)

menaxhimit të rasteve (PRIS), i cili e gjurmon barrën e punës që u delegohet këshilltarëve.

Ky vlerësim duhet që ta informojë menaxhmentin e performancës

së këshilltarëve duke përdorur të njëjtat të dhëna, pasi do ta mundësonte një kontribut më të përshtatshëm nga ana e gjyqtarëve dhe një pasqyrim më të mirë të këtyre të dhënave në PRIS.

14

## Rekomandim

**Gjykata Supreme duhet që ta harmonizojë interpretimin e dispozitave penale kur praktikat kontradiktore e minojnë sigurinë juridike; ky është rasti me:**

- i. Dispozitat për fushën e kontrollit gjyqësor të aktakuzave.
- ii. Dispozitat për gjykimet "në mungesë".
- iii. Termi "veprimtari kriminale" në veprën penale të pastrimit të parave.
- iv. Termi dhe kriteret për "rrethanat veçanërisht lehtësuese" të cilat lejojnë dënime nën minimumin ligjor.

Sipas nenit 124 të Kushtetutës së Malit të Zi, Gjykata Supreme do ta sigurojë zbatimin e unifikuar të ligjeve nga gjykatat. Neni 26 i Ligjit për Gjykatat parasheh që Gjykata Supreme duhet të vendosë për çështjet juridike kontestimore që kanë dalë nga praktika gjyqësore, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të gjykatave të shkallës më të ulët. Gjatë periudhës raportuese, ekipi i projektit vërejti se disa norma ligjore u interpretuan dhe zbatoheshin në mënyrë jokonsistente nga prokurorët dhe gjyqtarët, duke çuar në pasiguri ligjore. Për shembull, projekti zbuloi se gjyqtarët nuk e kanë një kuptim të unifikuar të kushteve për gjykimet në mungesë. Kjo çështje ishte veçanërisht e

dukshme në rastet kur ekstradimi i personit të akuzuar ishte në pritje, pasi gjyqtarët kishin qasje të ndryshme për të përcaktuar nëse ishin plotësuar kushtet për gjykim në mungesë në lidhje me këta persona të akuzuar. Gjatë konsultimeve, gjyqtarët e pranuan sfidën dhe theksuan se sqarimi në këtë drejtim do të ishte i rëndësishëm dhe i nevojshëm. E njëjta gjë vlen edhe për çështjen e ndërprerjes së hetimeve ndaj të pandehurve që janë larguar nga vendi. Projekti vuri në dukje se ndërsa disa prokurorë i ndërprejnë hetimet kundër të pandehurve që ishin në arrati, të tjerët ngritën aktakuzë dhe propozuan gjykime në mungesë. Kjo qasje jokonsistente u konfirmua

gjatë konsultimeve, ku disa prokurorë e pranuan se nuk i kishin ndërprerë hetimet pavarësisht dispozitës së nenit 286 të KPP-së. Ata theksuan se dispozita e mësipërme nuk ishte e qartë dhe mund ta rrezikonte çështjen për shkak të pasigurisë së parashkrimit. Për arsyetimin që qëndron pas leximit jokonsistent ligjor të dispozitave për fushën e kontrollit gjyqësor të

aktakuzave, ju lutemi referojuni rekomandimit 11. Për arsyetimin që qëndron pas leximit jokonsistent ligjor të termit “veprimtari kriminale” në Kodin Penal, ju lutemi referojuni rekomandimit 10 më lart. Për arsyetimin që qëndron pas leximit ligjor jokonsistent të termave “rrethana veçanërisht lehtësuese”, ju lutemi referojuni rekomandimit 16.

15

## Rekomandim

### **Rishikimi i konceptit dhe përdorimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në rastet e KOK. Veçanërisht:**

- i. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet t'u përmbahen udhëzimeve të nxjerra nga Gjykata Supreme dhe PSSP lidhur me përdorimin e MPF-ve.
- ii. i. Ministria e Drejtësisë duhet ta analizojë dhe ta marrë në konsideratë një instrument procedural që do ta lehtësonte bashkëpunimin ndërmjet prokurorëve dhe të pandehurve apo personave të dënuar. Kjo duhet të vendoset në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, për shembull, Marrëveshja për Dëshminë e dhënë nga një Person i Dënuar në Serbi, për t'u siguruar prokurorëve një mjet të besueshëm për mbledhjen e provave nga të pandehurit.

Ekipi i Projektit vuri në dukje se një përparësi e MPF-ve është përsheptimi i përpunimit gjyqësor të KOK. Nga ana tjetër, ka vërejtur edhe raste në të cilat të pandehurit me role kyçe në grupet e organizuara kriminale janë dënuar me dënime shumë të lehta duke pranuar MPF, ndërsa të pandehurit e tjerë që kanë luajtur role të vogla në grupe kriminale kanë vazhduar gjykimet dhe shpesh kanë qëndruar në paraburgim për periudha të gjata kohore.

Ky fakt u pranua edhe nga disa gjyqtarë gjatë konsultimeve, të cilët, në fakt, argumentuan kundër përfitimeve të efikasitetit. Efekti i butë sanksionues dhe shkalla shumë e ulët e konfiskimeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta si rezultat i MPF -ve u theksuan si një tjetër shqetësim që lind nga marrëveshjet për pranimin e fajësisë. Për këto arsye, është pozitive që janë miratuar udhëzime për përdorimin e kësaj praktike dhe shpresohet se



zbatimi i tyre do të rezultojë në një përdorim më efektiv të MPF-ve. Ekipi i Projektit gjithashtu konsideron se prokurorët do të përfitonin nga disponimi i një instrumenti procedural që do t'u mundësonte atyre të merrnin informacione përkatëse për rastin nga

të pandehurit ose personat e tjerë të dënuar. Prokurorët e konsultuar ranë dakord se futja e një mekanizmi të ngjashëm me Marrëveshjen për Dëshminë nga Personi i Dënuar do të ishte i dobishëm në zbulimin, vërtetimin dhe parandalimin e rasteve të KOK.

16

## Rekomandim

### **Krijimi i një politike dhe praktike më të fuqishme parandaluese për KOK. Drejt këtij qëllimi:**

i. Gjykata Supreme duhet që të miratojë udhëzime për praktikën e dënimit dhe individualizimin e dënimeve, duke ofruar udhëzime se çfarë do të konsiderohej një interval standard i mesëm dënimi për shkeljet e KOK dhe në cilat rrethana ai interval mund të ulet në minimum ose të rritet deri në maksimum të dënimit ligjor të parashikuar në Kodin Penal.

ii. Prokurorët e shtetit duhet që gjithmonë ta propozojnë llojin dhe peshën e dënimit në fjalën përfundimtare dhe t'i paraqesin arsyet që i kanë shtyrë ata që ta përcaktojnë atë dënim specifik para gjykatës.

Ekipi i Projektit e ka vërejtur trendin e një praktike të sanksionimit më të butë në Mal të Zi, e cila u confirmua nga gjyqtarët dhe prokurorët gjatë konsultimeve. Përfundimi i një politike të butë sanksionuese rrjedh kryesisht nga vendimet e MPF. Mirëpo, siç thuhet në arsyetimin e këtyre aktgjykimeve dhe është confirmuar nga gjyqtarët gjatë konsultimeve, politika e butë sanksionuese në MPF udhëhiqet nga politika e përgjithshme sanksionuese e butë në procedurat e rregullta penale.

Projekti gjithashtu vuri në dukje se gjykatat priren që ta mbitheksojnë rëndësinë e rrethanave lehtësuese për dënimin, ndërkohë që e zvogëlojnë ndikimin e rrethanave rënduese, pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm në të dyja rastet. Kjo është confirmuar edhe gjatë konsultimeve me përfaqësues të shoqërisë civile të cilët e monitorojnë punën e gjyqësorit.

Udhëzimet e rekomanduara duhet që ta përfshijnë parandalimin në sanksionet

për KOK.<sup>131</sup> Për më tepër, udhëzimet duhet t'i udhëzojnë gjyqtarët që të japin arsye specifike si për rrethanat lehtësuese ashtu edhe për rrethanat rënduese,<sup>132</sup> veçanërisht në rastet kur rrethanat janë veçanërisht lehtësuese. Përveç kësaj, qëndrimi ligjor mund t'i udhëzojë gjyqtarët për masat përkatëse të sigurisë të vendosura sipas detyrës zyrtare së bashku me sanksionet. Një rol të rëndësishëm në krijimin e praktikave sanksionuese e kanë edhe prokurorët. Gjatë periudhës raportuese, Projekti ka vërejtur se prokurorët rregullisht i neglizhonin propozimet për

llojin dhe ashpërsinë specifike të dënimit në vërejtjet e tyre përmbyllëse. Gjithashtu, ata nuk i kanë shpjeguar rrethanat rënduese dhe lehtësuese që gjykata duhet t'i ketë parasysh me rastin e caktimit të dënimit, e cila është detyrë e tyre siç parashikohet në nenin 362 të KPP.<sup>133</sup> Në vend të kësaj, prokurorët ia lanë gjykatës të vlerësonte se cili ishte dënimi i duhur, duke kontribuar potencialisht në politikën ekzistuese të sanksionimit të butë. Disa prokurorë të konsultuar e pranuan se ata rrallë e propozonin ashpërsinë e dënimit dhe e pranuan se kjo praktikë duhej ndryshuar.

17

## Rekomandim

**Këshilli Gjyqësor dhe ai i Prokurorisë duhet që ta rivlerësojnë sistemin e menaxhimit të performancës për gjyqtarët dhe prokurorët. Qëllimi është që të sigurohet që Treguesit Kryesorë të cilësisë së Performancës (TKP) ta pasqyrojnë saktë thelbin e punës prokuroriale/gjyqësore dhe të ofrojnë qartësi gjatë vlerësimit. Konkretisht:**

- i. Treguesit për vlerësimin e cilësisë së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të ndryshohen në mënyrë që të përfshihen kriteret cilësore, krahas atyre sasiore ekzistuese.
- ii. Qartësia e procesit të vlerësimit duhet të rritet duke e përcaktuar qartë se si duhet të vlerëson kriteret dhe treguesit në praktikë.

<sup>131</sup> Shih Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional, Neni 11, dhe Udhëzuesi Legjislativ për Zbatimin e Konventës, para. 304-310, në dispozicion në:

[https://www.unodc.org/documents/treaties/Legislative\\_Guide\\_2017/Legislative\\_Guide\\_E.pdf](https://www.unodc.org/documents/treaties/Legislative_Guide_2017/Legislative_Guide_E.pdf)

<sup>132</sup> "Faktorët kryesorë rëndues dhe lehtësues duhet të sqarohen në ligj ose praktikë ligjore. Kudo që është e mundur, ligji ose praktika duhet gjithashtu të përpqet të përcaktojë ata faktorë që nuk duhet të konsiderohen të rëndësishëm në lidhje me disa vepra penale", Këshilli i Evropës Rec. Nr (92) 17 në lidhje me konsistencën në dënimin, 1992, në dispozicion në:

<https://rm.coe.int/16804d6ac8>

<sup>133</sup> Neni 362 (2) përcakton se prokurori në fjalën përfundimtare propozon llojin dhe peshën e dënimit.

Për ta siguruar një përgjigje efektive gjyqësore në rastet komplekse, vlerësimi i performancës dhe promovimi duhet të mbështetet në një qasje të bazuar në merita dhe ta kultivojë kreativitetin dhe shkathtësinë për t'i stimuluar akterët gjyqësorë që të bëjnë më të mirën.

Sistemi i menaxhimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në Mal të Zi mbështetet kryesisht në tregues sasiore (statistikorë) të punës (p.sh., një përqindje e aktakuzave të konfirmuara për prokurorët, ose një përqindje e vendimeve të konfirmuara për gjyqtarët).

Nuk ka vlerësim cilësor substancial të përmbajtjes së këtyre vendimeve, d.m.th., nuk shqyrtohet cilësia e arsyetimit në aktakuzë apo në aktgjykim, siç shpjegohet në rekomandimet 11, 12 dhe 15.

Të gjithë bashkëbiseduesit ranë dakord për rëndësinë e prezantimit të idesë së treguesit të performancës specifike cilësore për ta lehtësuar një proces

vlerësimi më efektiv dhe për t'i stimuluar gjyqtarët dhe prokurorët. Nga ana tjetër, përshtatshmëria e kriterëve sasiore të bazuara në shkallën e vendimeve të anuluar për gjyqtarët, ose të ankesave të refuzuara për prokurorët, duhet të vlerësohet me kujdes me qëllim që të sigurohet që ato të mos e cenojnë pavarësinë e brendshme të gjyqtarëve dhe rolin e prokurorisë në sigurimin e llogaridhënies për krimet.

Për më tepër, procesi i vlerësimit nuk duket të jetë mjaft i qartë. Gjatë konsultimeve, anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial, si dhe gjyqtarët dhe prokurorët, ishin të pasigurt se si po vlerësoheshin individualisht për secilin tregues.

Për ta kapërcyer çdo paqartësi, si Këshilli Gjyqësor ashtu edhe ai i Prokurorisë duhet që të zhvillojnë standarde konkrete se si të vlerësohet secili tregues në praktikë.

## Përdorimi i Mjeteve Gjyqësore

18

Rekomndim

**Qeveria e Malit të Zi duhet t'ia sigurojë ZPS-së qasjen në të dhëna në të gjithë regjistrat shtetërorë**

Aktualisht, të dhënat e nevojshme për hetime efektive financiare dhe ndjekje penale të pastrimit të parave janë të fragmentuara në Mal të Zi, nëpër organe të ndryshme shtetërore që kanë qasje ekskluzive në baza të caktuara të të dhënave.

Prokurorët kanë qasje të drejtpërdrejtë vetëm në bazat e të dhënave të disa institucioneve shtetërore. Edhe atëherë, ndonjëherë ata duhet që ende të bëjnë kërkesa formale për të marrë të dhëna në formën e provave, pavarësisht nga qasja e tyre e drejtpërdrejtë.

Konsultimet e ekipit të projektit nxorën në pah se prokurorët përballen me sfida të shumta dhe shpesh nuk janë në gjendje të marrin ose të analizojnë informacione të rëndësishme.

Meqenëse bazat ekzistuese të të dhënave janë të shpërndara nëpër platforma të ndryshme elektronike dhe bashkimi i të gjitha të dhënave në një

bazë të dhënash të vetme nuk duket të jetë i realizueshëm në afat të shkurtër, Qeveria e Malit të Zi duhet t'u sigurojë qasje në informacionin e nevojshëm të gjithë prokurorëve nga ZPS e gjithashtu edhe hetuesve të tyre financiarë. Kjo qasje duhet të jetë e plotë, shteruese dhe e pakufizuar, duke e mundësuar një hetim dhe analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave.

Në planin afatgjatë, Qeveria e Malit të Zi duhet që t'i unifikojë bazat e të dhënave ekzistuese në një sistem. Gjatë konsultimeve, palët e interesuara e informuan Projektin se ishin ndërmarrë hapat fillestarë drejt arritjes së këtij objekti; megjithatë, prokurimi publik i shërbimeve të tilla nuk kishte dhënë rezultate.

Në këtë drejtim mund të kërkohet asistencë ndërkombëtare, pasi ZPS-së duhet t'ia sigurohet qasja në bazat e të dhënave të unifikuara.

### Fuqizimi i kapaciteteve të prokurorëve për të bërë hetime financiare në rastet e KOK

- i. Qendra për Trajnim në Shërbimin Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të zhvillojë dhe të ofrojë trajnime efektive për prokurorët e specializuar për kryerjen e hetimeve financiare.
- ii. Këshilli Prokurorial duhet ta zhvillojë një plan strategjik për t'u siguruar që stafi ekspert i aftë për të kryer hetime komplekse financiare të jetë në dispozicion të Shërbimit Prokurorial, veçanërisht në ZPS.
- iii. Këshilli Prokurorial duhet ta marr parasysh përfshirjen e rezultateve në lidhje me konfiskimin e zgjeruar në mesin e kriterëve për vlerësimin e prokurorëve.

Ekipi i Projektit i ka analizuar të dhënat statistikore lidhur me hetimet financiare dhe rezultatet e tyre në rastet që janë monitoruar dhe ka zbuluar se hetimet financiare ishin nisur në shumicën e rasteve. Megjithatë, rastet e ngrirjes apo sekuestrimit të aseteve ishin shumë të kufizuara, edhe pse dëmi apo fitimi në disa raste të monitoruara arrinte në miliona euro

Duke pasur parasysh shkallën e lartë të hetimeve financiare nga njëra anë dhe numrin e ulët të rasteve rasteve të sekuestrimit të pasurisë nga ana tjetër,

ekzistojnë shqetësime lidhur me kapacitetet e prokurorëve për t'i filluar dhe kryer në mënyrë efektive hetimet financiare, me qëllimin përfundimtar të aplikimit të konfiskimit të zgjeruar.

Pas konsultimeve me prokurorët dhe hetuesit financiarë, ekipi i projektit arriti në përfundimin se arsyeja e shkallës së ulët të konfiskimit të aseteve ishte cilësia e dobët e hetimeve financiare dhe sasia shumë e kufizuar e hetuesve financiarë të kualifikuar në ZPS, ndërsa autorët e supozuar shpesh duken shumë të aftë në maskimin e përfitimeve të tyre të

paligjshme. Për shembull, prokurorët deklaruan vazhdimisht se ekspertët e kualifikuar financiarë nuk mund të motivohen nga pagat aktuale për t'u bashkuar me shërbimin prokurorial ose për t'i ofruar shërbimet e tyre për një periudhë të gjatë.

Kështu, Këshilli Prokurorial duhet ta konsiderojë krijimin e kushteve më të favorshme dhe tërheqëse të punës për hetuesit financiarë.

Gjatë konsultimeve, prokurorët e pranuan gjithashtu se trajnimi që kishin kaluar mbi hetimet financiare dhe konfiskimin e aseteve e kishte kufizuar dobishmërinë e zbulimit të pasurisë së paligjshme të kriminelëve të maskuar mirë. Prandaj, trajnimi i ardhshëm duhet të marrë formën e një ushtrimi simulues dhe të përshtatet për ta përfshirë zbatimin e praktikave më të mira në kontekstin malazez.

Përveç kësaj, ZPS duhet ta shqyrtojë organizimin e një grupi të brendshëm pune për t'i nxjerrë në pah mangësitë në hetimet financiare dhe konfiskimin e

aseteve dhe ta zhvillojë një skemë të standardizuar për rrjedhën e hetimeve financiare, përkatësisht një udhëzues hap pas hapi për konfiskimin, duke filluar nga momenti i identifikimit të një asemi gjatë hetimeve financiare.

Elaborimi i të gjitha mënyrave dhe mjeteve të disponueshme për ta identifikuar burimin e fundit (të paligjshëm) të aseteve (përfshirë analizimin e zinxhirit të konvertimeve dhe transferimeve) do të kontribuonte në sigurimin e një konfiskimi efektiv eventual. ZPS duhet të fillojë që t'i përdorë në mënyrë aktive rrjetet ekzistuese joformale për të shkëmbyer hetime financiare dhe rikuperim të aseteve.

Projekti është gjithashtu i mendimit se prokurorët do të ishin më të stimuluar për ta pasuar konfiskimin e zgjeruar nëse rezultatet e arritura do të merreshin parasysh gjatë vlerësimit të tyre. Disa anëtarë të konsultuar të Këshillit Prokurorial ranë dakord se një ndryshim i tillë i kriterëve të vlerësimit mund të ishte i dobishëm.

# IX. Maqedonia e Veriut

## Hyrje

Maqedonia e Veriut i ka bërë disa përparime në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të KOK. Ndryshimet e nevojshme ligjore që do t'i korrigjonin problemet praktike që dalin në proceset gjyqësore janë thelbësore për gjykimin efektiv të rasteve të KOK.

Misioni i OSBE-së në Shkup e mbështet Grupin Punues të themeluar nga Ministria e Drejtësisë për hartimin e amendamenteve ligjore shumë të nevojshme për KPP-në që duhet të ndihmojnë në përpunimin më të mirë të rasteve të KOK. Këto draft-amendamente përputhen me gjetjet e Projektit dhe do të ndihmojnë në korrigjimin e disa prej çështjeve të diskutuara në rekomandimet e mëposhtme. Në mënyrë të ngjashme, zhvillimet e fundit pozitive në kuadrin rregullator në lidhje me rikuperimin e asetëve duhet t'i inkurajojnë të gjitha institucionet kompetente që të bëjnë përpjekje më serioze për t'i rritur normat e konfiskimit.

Megjithatë, besimi i ulët i publikut tek gjyqësori vazhdon, ndër të tjera, për shkak të gjykimeve të zgjatura, mungesës së përgjegjësisë së akterëve gjyqësorë dhe konfiskimeve të kufizuara të përfitimeve nga krimet. Fushat kyçe të shqetësimit janë çështjet sistematike si kapacitetet dhe burimet e kufizuara,

menaxhimi joefikas i rasteve, vonesat në zgjedhjet gjyqësore ose ngritjet në detyrë, boshllëqet në shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional dhe menaxhimi joadekuat i performancës. Këto sfida ndikojnë ndjeshëm në efektivitetin e përgjithshëm të gjyqësorit, i ngadalësojnë rastet e KOK të nivelit të lartë dhe kontribuojnë në perceptimet rreth pavarësisë dhe paanësisë.

Për më tepër, shumica e këtyre çështjeve kryqëzohen dhe fuqizojnë njëra-tjetrën. Për shembull, menaxhimi i dobët i rasteve, i cili çon në gjykime të zgjatura, ngre pyetje në lidhje me drejtësinë e gjykimin.

Çështjet e kapaciteteve tek prokurorët publikë – veçanërisht aktakuzat me cilësi të dobët, hetimet e pamjaftueshme financiare dhe normat e ulëta të konfiskimit – mund të ngrenë shqetësime për paanshmërinë.

Për më tepër, Zyra e Prokurorisë Themelore Publike për ndjekjen e KOK (ZPTHB KOK) i mungojnë burimet njerëzore dhe financiare – veçanërisht stafi administrativ dhe ekspertët financiarë – si dhe softueri i integruar për menaxhimin e rrjedhës së çështjeve, duke e penguar kështu logaridhënien në rastet e KOK të nivelit të lartë.

Ndërsa mungesa e efikasitetit – veçanërisht kohëzgjatja e gjykimeve – mbetet një shqetësim, Projekti i ka vënë re disa përmirësime, të tilla si seancat më të shpeshta dhe prezantimet e përmirësuara të provave dokumentare nga të dyja palët.

Për më tepër, Gjykata Themelore Penale Shkup (GJTHP në Shkup) vazhdon ta nxisë transparencën duke publikuar njoftime të rregullta në uebsajtin e saj dhe duke ofruar qasje të lehtë në informatat relevante për rastet e KOK të nivelit të lartë.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gjykata Supreme) gjithashtu e ka nxjerrë një qëndrim parimor juridik që gjykatat duhet t'i publikojnë aktgjykimet dhe vendimet jo të formës së prerë, veçanërisht në rastet e interesit publik.

Kjo nga ana tjetër e shtyu GJTHP në Shkup dhe Gjykatën e Apelit në Shkup që të fillojnë me publikimin anonim të

vendimeve jo-përfundimtare në rastet e KOK të nivelit të lartë. Megjithatë, ndryshimet e fundit të KP-së çuan në përfundimin e shumë prej rasteve të KOK të nivelit të lartë, të cilat e përkeqësuan perceptimin e shoqërisë për mosndëshkimin.

Prandaj, të gjitha institucionet e përfshira në përpunimin e rasteve të KOK duhet t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për ta siguruar llogaridhënien dhe administrimin efektiv të drejtësisë.

Progresi real e kërkon një angazhim afatgjatë nga palët e interesuara për t'i adresuar joefikasitetet sistematike që aktualisht po e bëjnë të paefektshëm përpunimin e rasteve të rënda të KOK.

Në këtë sfond, Projekti i propozon 12 rekomandime në lidhje me drejtësinë, efikasitetin, kapacitetin dhe konfiskimin, për të shërbyer si bazë për veprim të menjëhershëm dhe si mbështetje për politikat institucionale.



## Paanshmëria

1

### Rekomandim

**Rritja e nivelit të transparencës në sistemin gjyqësor, veçanërisht në administrimin e drejtësisë për rastet e KOK të nivelit të lartë:**

- i. Ministria e Drejtësisë duhet t'i iniciojë ndryshimet për harmonizimin e Ligjit për Menaxhimin e Rrjedhës së Lëndëve të KPP-në, veçanërisht në lidhje me mundësinë e publikimit të vendimeve gjyqësore jo të formës së prerë.
- ii. Prokuroritë publike duhet t'i publikojnë aktakuzat e konfirmuara në rastet e KOK të nivelit të lartë me të gjitha të dhënat personale anonime.
- iii. Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike e Shtetit duhet ta mbështesin zhvillimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe sistematike për ruajtjen e anonimitetit të menjëhershëm të akteve gjyqësore.
- iv. Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata Supreme, në koordinim me kryetarët e gjykatave, duhet që t'i përmirësojnë aftësitë teknike të sistemit ekzistues të orarit të seancave gjyqësore për të siguruar përditësime në kohë dhe për të ofruar informacion të saktë për publikun.
- v. Kryetarët e gjykatave, në bashkëpunim me OSHC-të përkatëse dhe me Këshillin Gjyqësor për Media, duhet të publikojnë gazeta (njoftime) të rregullta që përmbajnë informacione për rastet me interes publik, e po ashtu edhe dhe punime tematike dhe analitike.
- vi. Kryetarët e gjykatave dhe kryetarët e prokurorive publike duhet ta sigurojnë shpërndarjen në kohë dhe transparente të informacionit duke e ruajtur funksionin e mirë të zyrave për marrëdhënie me publikun.

vii. Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë si dhe Këshilli Gjyqësor i Mediave duhet të vazhdojnë me zbatimin efektiv të trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin tjetër gjyqësor mbi atë se si të komunikojnë në mënyrë efektive me publikun në lidhje me rastet e tyre.

Projekti vuri re pengesa të cilat e pengojnë transparencën, veçanërisht që kanë të bëjnë me publikimin e akteve gjyqësore, seancave dëgjimore dhe me shkëmbimin e informacionit të bazuar në të dhëna.

Sigurimi i vendimeve me shkrim është sfidues për shkak të dispozitave ligjore kontradiktore. Konkretisht, sipas Ligjit për Gjykatat dhe Ligjit për Menaxhimin e Rrjedhës së Lëndëve, gjykatave u ndalohet që t'i publikojnë aktgjykimet me shkrim, përveç nëse ato janë të formës së prerë.

Kjo është në kundërshtim me KPP, i cili urdhëron që të gjitha vendimet gjyqësore të bëhen publike në formë elektronike ose të shtypur.<sup>134</sup>

Mospërputhja midis dy ligjeve u trajtua pjesërisht nga qëndrimi parimor ligjor i Gjykatës Supreme në dhjetor 2022, duke e lejuar publikimin e vendimeve dhe vendimeve jo të formës së prerë, veçanërisht në rastet me interes publik.<sup>135</sup>

Megjithatë, ai i referohet rasteve me interes publik si një kategori që nuk përcaktohet me ligj apo akte të tjera ligjore të institucioneve të drejtësisë. Kjo u lejon gjykatave që ta interpretojnë dhe zbatojnë vendimin për interesin publik sipas kuptimit të tyre, i cili jo gjithmonë përputhet me interesin aktual të publikut.

Sa i përket prokurorisë, është e rëndësishme të theksohet se ajo e informon publikun rregullisht për aktakuzat e ngritura në rastet me interes publik duke e publikuar një përmbledhje të akuzave në faqen e saj të internetit. Megjithatë, ky informacion nuk është i mjaftueshëm për gazetarët, përfaqësuesit e OSHC-ve dhe ekspertët ligjorë për ta kryer një analizë të plotë ose për t'ia ofruar medias një bazë për raportim objektiv.

Duke pasur parasysh se prokuroria publike e pranon rëndësinë e informimit të publikut duke ofruar detaje menjëherë pas ngritjes së aktakuzës, Projekti rekomandon

<sup>134</sup> Neni 126 i KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18).

<sup>135</sup> Sipas Ligjit për gjykata (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 58/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/18, 198/18 dhe 96/19), një nga kompetencat e Gjykatës së Lartë duhet të përcaktojë pikëpamjet e përgjithshme dhe mendimet juridike për çështjet me rëndësi për sigurimin e zbatimit uniform të ligjeve nga gjykatat, të miratuara nga Seanca e Përgjithshme e saj. Shih: Начелен+став+-+објавување+на+неправосилни+одлуки.pdf (vsrm.mk)

publikimin e tekstit të plotë të aktakuzave të konfirmuara në rastet e KOK të nivelit të lartë. Kjo masë synon ta parandalojë keqinterpretimin dhe abuzimin e informacionit. Megjithatë, Meqenëse gjykimet janë publike, dhe ndiqen me vëmendje nga ana e medias dhe janë subjekt i monitorimit nga ana e OSHC-ve kjo do ta cenonte të drejtën e prezumimit të pafajësisë.

Gjykatat dhe prokuroritë publike gjithashtu përballen me vështirësi në përpunimin e akteve gjyqësore për t'i vënë ato në dispozicion të publikut për shkak të burimeve të pamjaftueshme të personelit të nevojshëm për publikimin e tyre pa emra.

Kjo situatë rrjedh nga respektimi i rregulloreve ligjore që synojnë mbrojtjen e të dhënave personale. Projekti siguroi aktakuza pas kërkesave në prokurori, por vetëm pasi ato ishin anonimizuar, gjë që mori një kohë të konsiderueshme. Vlen të përmendet, GJTHP në Shkup varej nga anonimizimi pjesërisht i jashtëm përmes një projekti të mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Shkup në bashkëpunim me OSHC-në "Koalicioni Të gjithë për Gjykim të Drejtë".

Për këto arsye, është e qartë se Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike Shtetërore – në përputhje me kompetencat e tyre – duhet ta rivlerësojnë ndarjen e burimeve për personelin adekuat për anonimizim në mënyrë që të sigurojnë qëndrueshmëri.

Oraret aktuale të seancave gjyqësore publikohen në një pjesë të dedikuar të faqeve të internetit të gjykatave. Megjithatë, informacioni e përmban vetëm numrin e lëndës dhe kryetarin e trupit gjykues, gjë që e bën të vështirë për publikun të mësojë për një rast specifik pa e ditur numrin e lëndës. Kjo do të mund të zgjidhej lehtësisht nëse emri(at) e të pandehurit(ve), inicialet e tyre dhe vepra(t) penale do të tregoheshin në orarin e seancave. Përveç kësaj, Projekti vuri në dukje se ndryshimet e mëvonshme në orare nuk u përditësuan.

Edhe pse të dyja çështjet kërkojnë vetëm rregullime të vogla teknike në sistemin e informacionit të gjykatave, ato do të kontribuonin ndjeshëm në transparencën e gjyqësorit.

Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata Supreme janë përgjegjëse për sigurimin e kushteve të nevojshme teknike për përmirësimin e sistemit të publikimit të grafikut gjyqësor dhe për funksionimin e përgjithshëm të portalit gjyqësor. Përveç kësaj, ata duhet të sigurohen që platforma e përdorur për publikimin e vendimeve ta ketë kapacitetin e nevojshëm teknik për t'i akomoduar ato.

Përderisa GJTHP në Shkup publikon rregullisht informacione të rëndësishme rreth procedurave gjyqësore me interes publik, Gjykata e Apelit në Shkup publikon një numër të kufizuar njoftimesh me përmbajtje të paqartë.

Roli i kryetarëve të gjykatave është gjithashtu vendimtar në këtë drejtim dhe duhet të fuqizohet më tej, sipas Opinione Nr.19 (2016) të KKGJE-së.<sup>136</sup>

Për më tepër, rritja e bashkëpunimit me OSHC-të në lidhje me përgatitjen dhe publikimin e të dhënave analitike për çështjet me interes publik, përfshirë vendimet në këto raste, do të kontribuonte ndjeshëm në rritjen e besimit të gjykatat. Kjo mund të bëhet pa burime të rëndësishme, duke përfshirë publikimin e buletineve periodike dhe raporteve të shkurtra analitike si dhe të grafikëve ndërsa

Këshilli Gjyqësor i Mediave mund ta luajë një rol në promovimin e tyre.

Gjatë konsultimeve të Projektit, gjyqtarët e theksuan nevojën për t'i zhvilluar më tej aftësitë e marrëdhënieve me publikun.

Edhe pse Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë ofron trajnime bazë në këtë fushë si pjesë e programit të saj të rregullt të trajnimit, ekziston një mundësi e rëndësishme për t'i shtuar më tej njohuritë mbi këto tema përmes bashkëpunimit të vendosur me Këshillin Gjyqësor të Mediave.

## 2

### Rekomandim

**Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet që së bashku t'i mbrojnë gjyqtarët dhe prokurorët publikë nga të gjitha format e presionit politik dhe ndërhyrjeve të tjera, duke e mbrojtur në këtë mënyrë pavarësinë e gjyqësorit, duke e garantuar llogaridhënien e tij. Ata duhet ta bëjnë këtë përmes:**

- i. Përpilimit të procedurave standarde për monitorimin, raportimin dhe për dënimin publik të çdo shkeljeje apo tentative për ndërhyrje në pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.
- ii. Nxjerrjes së konkluzioneve të vetëvlerësimit për ta përmirësuar drejtësinë dhe për ta rritur transparencën në lidhje me zgjedhjet, ngritjet në detyrë dhe rezultatet e procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë. Gjithashtu, duhet të publikojë vendime që ofrojnë arsytim të detajuar.

<sup>136</sup> KKGJE (2016)2REV2 (coe.int) thekson se "...në marrëdhëniet e tyre me median, kryetarët e gjykatave duhet të kenë parasysh se interesat e shoqërisë kërkojnë që medias t'i jepet informacioni i nevojshëm për të informuar publikun mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë".

iii. Informimi i menjëhershëm i publikut lidhur me seancat e ardhshme të këshillit dhe me të gjitha konkluzionet dhe vendimet.

Projekti i ka vërejtur disa raste të figurave të njohura politike që i shprehin pakënaqësinë publike dhe i kritikonin vendimet e gjykatave në rastet që përfshijnë zyrtarë të lartë, duke sinjalizuar ndërhyrje të mundshme politike; megjithatë, Këshilli Gjyqësor nuk i dënoi këto sulme verbale ndaj gjyqësorit duke lëshuar deklarata zyrtare apo duke ndërmarrë hapa të tjerë konkretë për t'i mbrojtur gjyqtarët.

Sipas Opinionit 24 (2021) të KKGJE-së, "Këshilli duhet ta kundërshtojë me vendosmëri çdo përpjekje për t'i sulmuar ose për të ushtruar presion ndaj gjyqtarëve individualë ose gjyqësorit në tërësi".<sup>137</sup>

Projekti e ka vërejtur një rast kur një prokuror kritikoi publikisht Këshillin e Prokurorëve Publikë dhe theksoi nevojën për ta reformuar atë. Kjo ka rezultuar me atë që Këshilli i Prokurorëve Publik të kërkojë nga Këshilli Etik i Prokurorëve Publikë që të

përcaktojë nëse kjo deklaratë ishte shkelje e Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë.<sup>138</sup> Deri më sot, nuk mund të gjendet asnjë informacion i disponueshëm publikisht për rezultatin e nismës. OShC-të që e monitorojnë punën e Këshillave kritikuan si thelbin e kësaj nisme, ashtu edhe mungesën e transparencës në seancën e Këshillit të Prokurorëve Publikë gjatë së cilës u konstatua nevoja për një kërkesë të tillë. Kur merr rolin e tij për ruajtjen e autonomisë së prokurorëve, Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet ta respektojë Opinionin e miratuar së fundi nr. 18 (2023) të Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Publikë.<sup>139</sup>

Kushtetuta, ligji(et) dhe legjislacioni tjetër e garantojnë pavarësinë e Këshillave dhe i pozicionojnë ato si organe përgjegjëse për garantimin e pavarësisë së gjyqtarëve dhe autonomisë së prokurorëve publikë, si dhe për ruajtjen e reputacionit të tyre dhe ruajtjen e besimit publik.<sup>140</sup>

<sup>137</sup> [1680a47604 \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/e/turkey/2021031680a47604.aspx).

<sup>138</sup> Në korrik të vitit 2021, Këshilli i Prokurorëve Publikë miratoi një Kod të ri të Etikës për Prokurorët Publikë i cili përfshinte një nen sipas të cilit prokurorët publikë nuk duhet të komentojnë në publik vendimet e Këshillit të Prokurorëve Publikë. Shih: [etichki-kodeks-na-javnite-obviniteli-2021.pdf \(jorm.gov.mk\)](https://www.jorm.gov.mk/etichki-kodeks-na-javnite-obviniteli-2021.pdf). Ky nen u ndryshua në nëntor 2023 dhe tani thotë se prokurorët publikë duhet të sigurohen që të mos cenojnë reputacionin e prokurorisë publike dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në paraqitjet e tyre publike. Shih: [Етички-кодекс-за-изменување-и-дополнување-на-Етичкиот-кодекс-на-јавните-обвинители-на-Република-Северна-Македонија-1.doc \(live.com\)](https://www.live.com/na-Република-Северна-Македонија-1.doc)

<sup>139</sup> [1680ad1b36 \(coe.int\)](https://www.coe.int/t/e/turkey/2023011680ad1b36.aspx).

<sup>140</sup> Neni 104 i Kushtetutës, neni 2, 36 (1) i.16 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 102/19), Kodi i Etikës së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, Programi për punë të Këshillit Gjyqësor për vitin 2024, neni 2 i Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/07, 100/11 dhe 42/20).

Megjithatë, Këshillave aktualisht u mungojnë procedurat e standardizuara për mënyrën e realizimit të këtij objekti, pasi duket se legjislacioni e thekson në radhë të parë rolin e tyre në sanksionimin e sjelljeve të pahijshme. Projekti ka vënë re se Këshilli Gjyqësor i ka ndërmarrë disa veprime individuale për ta adresuar efikasitetin e procedurave, por nuk arriti ta miratojë një qasje sistematike në identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve në vazhdim. Gjatë konsultimeve dhe forumeve të diskutimit të Projektit, gjyqtarët dhe prokurorët publikë e shprehën hapur pakënaqësinë e tyre me punën e Këshillave. Ata gjithashtu e theksuan nevojën për procedura më transparente për zgjedhjet dhe ngritjet në detyrë, duke përfshirë shpjegime më të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse për vendimet. Duke i rivlerësuar praktikën e tyre të votimit, Këshillat mund të përpiqen të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë kandidatëve, si dhe aplikim transparent të sistemit të bazuar në merita. Për sa i përket rezultateve të procedurave disiplinore, shkelja dhe arsyetimi i shkurtër i vendimeve duhet të bëhen gjithmonë publike pa frikën e ndërhyrjes në të drejtat e privatësisë.

Siç vërehet te “Vlerësimi i rrezikut nga korrupsioni i gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut”, botuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, “pothuajse tre të katërtat e gjyqtarëve nuk besojnë se Këshilli Gjyqësor e

mbron me sukses pavarësinë e gjyqësorit dhe ata nuk besojnë se ngritja në detyrë e gjyqtarëve bëhet sipas kriterëve objektive, të matshme dhe të drejta.” Në mënyrë të ngjashme, më shumë se gjysma e prokurorëve publikë “nuk besojnë se Këshilli i Prokurorëve Publikë merr vendime në mënyrë autonome dhe të pavarur dhe nuk besojnë se ngritja në detyrë e prokurorëve publik bëhet sipas kriterëve ekzistuese legislative”.<sup>141</sup> Megjithatë, në një hap pozitiv, Këshilli Gjyqësor i ka zbuluar gjithashtu disa nga këto mangësi dhe në Planin e tij Strategjik për periudhën 2023-2024 ka parashikuar aktivitete që do të çonin në mbrojtje të shtuar të reputacionit të gjyqtarëve dhe në rritje të transparencës.<sup>142</sup> E njëjta gjë është pasqyruar edhe në Programin dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Vlerësimin e Korrupsionit në Gjyqësor për periudhën 2022-2025<sup>143</sup> dhe në Planin e Punës së Këshillit Gjyqësor për vitin 2024, ku mbrojtja e gjyqtarëve nga ndikimi i padrejtë është një prej prioritetëve.<sup>144</sup>

Përmirësimi i procesit të zgjedhjeve, i emërimeve dhe i procedurave disiplinore, si dhe rritja e transparencës është një pjesë thelbësore e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve nga Misioni Gjyqësor i BE-së për Këshillin Gjyqësor, i miratuar në mars 2024.<sup>145</sup> Niveli i zbatimit i këtyre dokumenteve mbetet për t'u parë.

<sup>141</sup> [osce.org/files/f/documents/9/d/545929\\_0.pdf](https://osce.org/files/f/documents/9/d/545929_0.pdf), p.38.

<sup>142</sup> [Y2023-SDN-\(GD\)0455.pdf \(sud.mk\)](#)

<sup>143</sup> [Програма и акционен план за превенција и следење на корупцијата во судството 2022 - 2025 \(sud.mk\)](#)

<sup>144</sup> [Y2024-SDN-\(GD\)2600.pdf \(sud.mk\)](#)

<sup>145</sup> [Y2024-SDN-\(GD\)0545.pdf \(sud.mk\)](#)

**Përmirësimi i standardeve të drejtësisë për gjykimin e rasteve të KOK për ta theksuar paanshmërinë gjyqësore së bashku me barazinë e palëve.**

- i. Gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave duhet ta respektojnë plotësisht përgjegjësinë e tyre jo vetëm për të qëndruar të paanshëm, por edhe për t'u dukur të paanshëm gjatë procesit gjyqësor dhe t'i zbatojnë standardet më të larta për vendimet që marrin dhe proceset përmes të cilave arrihen këto vendime.
- ii. Drejtuesit e departamenteve penale në gjykata duhet t'i mundësojnë diskutimet e rregullta dhe t'i shkëmbejnë praktikatat më të mira mes gjyqtarëve.
- iii. Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë duhet të sigurohet që çështjet e drejtësisë të jenë qendrore në kurrikulën e trajnimit dhe t'i paraqesin rezultatet e arritura në mënyrë të matshme.

Në disa raste, Projekti vuri në dukje çështje në lidhje me drejtësinë, me sjelljen e disa gjyqtarëve që ngrenë shqetësime për paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre ndaj parimit të barazisë së palëve.

Për shembull, në të paktën dy raste – dhe në disa rrethana – Projekti vërejti si vijon: gjyqtarët e dytë profesionistë si anëtarë të trupit gjykues dolën nga salla e gjyqit gjatë seancës pa dhënë pushim, gjyqtarët morën përsipër marrjen në pyetje të dëshmitarit nga palët, treguan padurim ose i kritikuan dëshmitarët që dëshmuan. Një sjellje e tillë duhet të adresohet dhe korrigjohet për ta ruajtur besimin e publikut në paanshmërinë gjyqësore.

Në fund të fundit, gjyqtarët duhet ta respektojnë gjithmonë përgjegjësinë e tyre jo vetëm për të vepruar në mënyrë të paanshme, por edhe për t'u dukur të paanshëm.

Lidhur me të drejtën për një gjykim publik, Projekti vërejti në disa raste se gjyqtarët nuk i shpallën vendimet publikisht, në vend të kësaj thjesht i udhëzuan të pandehurit që ata të njoftoheshin për vendimin e tyre me shkrim në kohën e duhur.

Shpallja publike e aktgjykimeve është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur arsyetimi me shkrim i aktgjykimeve nuk është publikisht i disponueshëm.

Lidhur me barazinë e palëve, Projekti vërejti në disa raste që gjyqtarët i kufizuan të drejtat e palëve. Në mënyrë të veçantë, ata e kufizuan aftësinë e palëve për t'i kundërshtuar provat e kundërta; për t'i sfiduar dëshmitarët duke iu referuar deklaratave të dhëna më parë gjatë hetimit, ose para se seanca të fillojë përsëri; dhe që t'i paraqesin provat e tyre, të cilat ndonjëherë janë refuzuar pa arsyetim të mjaftueshëm. Duhet theksuar se çështjet e vërejtura fillimisht nga Projekti në lidhje me shkëmbimin e provave të prokurorisë me mbrojtjen, aktualisht janë zbuluar shumë rrallë në gjykimet e rasteve të KOK. Projekti vlerëson se kjo çështje do të zgjidhej më tej me ndryshimet e planifikuara në KPP, pasi ato e imponojnë shpalosjen e

detyrueshme dhe në kohë të provave nga prokuroria.

Kryetarët e gjykatave dhe drejtuesit e departamenteve penale mund ta luajnë një rol vendimtar në organizimin e takimeve, në lehtësimin e komunikimit ndërmjet gjyqtarëve dhe inkurajimin e tyre që të jenë vetëkritikë dhe që t'i shkëmbejnë praktikën më të mira në mënyrë që të përmirësohet imazhi i përgjithshëm i gjykatave. Për më tepër, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë duhet t'i adresojë këto çështje që kanë të bëjnë me drejtësinë në trajnimin fillestar dhe atë të vazhdueshëm. Ajo gjithashtu duhet të kryejë një vlerësim të bazuar në të dhëna të rezultateve të arritura, të raportojë mbi to dhe t'i pasqyrojë ato në aktivitetet e ardhshme.

## Efikasiteti

4

### Rekomandim

**Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike Shtetërore duhet t'i dallojnë dhe kategorizojnë rastet e KOK të nivelit të lartë me qëllim të rritjes së efikasitetit në trajtimin e tyre. Ata duhet ta bëjnë këtë përmes:**

- i. Miratimit të metodologjive për t'i dalluar rastet e KOK për qëllime statistikore dhe politikëbërëse, në koordinim me gjykatat dhe prokuroritë publike.
- ii. Për të njëjtat qëllime, përmes miratimit të kriterëve shtesë për t'i dalluar dhe kategorizuar rastet e nivelit të lartë nga rastet "standarde" të KOK.



## Rekomandim

iii. Ndjekjes së trajtimit efikas të rasteve të KOK të nivelit të lartë, duke përfshirë miratimin e planeve të punës dhe metodologjive për trajtimin e rasteve të tilla nga prokuroritë publike dhe gjykatat.

iv. Hartimit të rasteve të KOK të nivelit të lartë për t'i ndarë burimet e duhura për prokuroritë publike dhe gjykatat që janë më të përfshira në përpunimin e tyre.

v. Sigurimit që kriteret për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë i pasqyrojnë në mënyrë adekuate sfidat specifike të hasura në përpunimin e rasteve të KOK të nivelit të lartë.

Për të krijuar një histori të qëndrueshme në adresimin e KOK, është thelbësore të krijohet një sistem dallimi dhe kategorizimi i përshtatur dhe i besueshëm. Ky sistem do të ndihmonte në identifikimin e rasteve të KOK dhe rasteve të KOK të nivelit të lartë. Duke vepruar kështu, institucionet vendase mund të gjenerojnë statistika të besueshme për përpunimin e rasteve, duke e lehtësuar matjen e progresit ose regresionit me kalimin e kohës. Veçanërisht, në nëntor 2023, Projekti mori informacion nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me Metodologjinë për Sistemin Statistikor Përkates për Monitorimin e Politikës Kundër Korrupsionit të miratuar nga Qeveria në vitin 2013. Sipas Ministrisë, Metodologjia është e integruar në Sistemin e AKstats, e cila mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave. AKstats ka funksionuar që nga prilli i vitit 2019.

Kriteret për përcaktimin e rasteve të korrupsionit të profilit të lartë janë përpiluar nga një grup punues për rishikim dhe përditësim të Metodologjisë së lartpërmendur dhe ato janë pranuar nga Prokuroria Publike e Shtetit në vitin 2015, siç theksohet nga Ministria.

Duke marrë parasysh sa më sipër, Projekti beson se kjo është një bazë solide për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorinë Publike të Shtetit që në bashkëpunim t'i përpilojnë kriteret e tyre të sinkronizuara për identifikimin dhe kategorizimin e rasteve të KOK për qëllimet e tyre. Për më tepër, këto kriteret, së bashku me analizën e të dhënave statistikore, mund të shërbejnë si mjete të vlefshme për zhvillimin e politikave, metodologjive dhe strategjive të qëndrueshme, si dhe për vënien e prioriteteve në përpunimin e rasteve dhe planifikimit të punës. Ato gjithashtu mund të ndihmojnë në shpërndarjen efikase të burimeve të nevojshme.

Një sistem adekuat kategorizimi për qëllime statistikore dhe politikëbërëse, nëse hartohet siç duhet, mund të jetë një mjet thelbësor në formësimin dhe zbatimin e masave kyçe të cilat e synojnë përmirësimin e reagimit gjyqësor ndaj KOK, veçanërisht në lidhje me rastet e nivelit të lartë.

Përveç krijimit të të dhënave sasiore të besueshme për përpunimin e rasteve të tilla, ky sistem mund të përdoret për t'i dhënë përparësi ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të nivelit të lartë të KOK nga prokuroritë publike përkatësisht nga gjykatat; gjegjësisht, në planet vjetore të punës së gjykatave dhe prokurorive publike do të mund të parashiheshin synime specifike lidhur me procedimin e këtyre lëndëve.

Për më tepër, hartimi i rasteve aktuale dhe të ardhshme të nivelit të lartë nëpër prokuroritë dhe gjykatat e ndryshme publike në sistemin vendorë mund të përdoret për t'i rialokuar burimet njerëzore dhe materiale aty ku ato janë më të nevojshme.

Së fundi, kriteret e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë duhet ta pasqyrojnë punën shtesë dhe sfidat e kërkuara nga rastet e KOK, veçanërisht ato të nivelit të lartë. Shpërblimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që punojnë në ato raste me pikë shtesë vlerësimi do të ishte një mjet efektiv për ta nxitur një përgjigje më efektive gjyqësore ndaj KOK.

5

## Rekomandim

**Gjyqtarët në Departamentin për KOK në Gjykatën Themelore Penale në Shkup duhet t'i miratojnë dhe zhvillojnë më tej standardet dhe teknikat për menaxhimin e gjykimeve të lëndëve komplekse, bazuar në praktikat e mira, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të gjykimeve. Ata duhet ta bëjnë këtë përmes:**

- i. Qasjes strategjike në çdo rast specifik duke e zhvilluar një orar për seancat, duke e marrë parasysh numrin e të pandehurve, vëllimin e provave, mandatin e gjyqtarëve laik dhe oraret e anëtarëve të trupit gjykues dhe të palëve.
- ii. Ftesës së palëve që t'i konsolidojnë listat e tyre të provave dhe të bien dakord për faktet e pakontestueshme, si dhe ta kërkojnë paraqitjen efektive të provave materiale.

## Rekomandim

iii. Caktimi i seancave të njëpasnjëshme "të përditshme" dhe, nëse kjo nuk është e mundur për arsye teknike ose të tjera, caktimi i të paktën një seancë në javë.


iv. Delegimit – kur është e përshtatshme – thirrjes së dëshmitarëve tek palët duke i ruajtur mekanizmat e kontrollit për ta siguruar praninë e dëshmitarëve.

v. Kërkesës që palët ta informojnë me kohë gjykatën për mungesat që ndërlidhen me shëndetin dhe ta vlerësojnë vazhdimisht vlefshmërinë e të gjithë dokumentacionit mjekësor të dorëzuar

Emëruesi më i zakonshëm në shumicën e rasteve të monitoruara ishte kohëzgjatja e përgjithshme e gjykimit – nga 50 lëndë, 18 lëndë janë përfunduar. Megjithatë, tetë prej tyre u mbyllën për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit si rezultat i ndryshimeve të fundit në KP.

Kohëzgjatja e gjykimit të shkallës së parë është mesatarisht 2 vjet, me procesin më të gjatë gjyqësorë në kohëzgjatje prej 2127 ditësh dhe me procesin më të shkurt gjyqësorë prej nëntë ditësh.

### Kohëzgjatja mesatare e procedurës deri në vendimin e shkallës së parë



**Grafiku 26** - Kohëzgjatja mesatare e procedurës deri në vendimin e shkallës së parë

Në disa raste kur vendimi i shkallës së parë është marrë brenda një kohe të arsyeshme, gjyqtarët kanë përdorur teknika të menaxhimit të gjykimit që kanë kontribuar në procedimin me kohë të çështjes. Për shembull, në fillim të gjykimit, gjyqtarët e caktuan paraprakisht një numër të konsiderueshëm seancash, duke marrë në konsideratë angazhimet kontradiktore të palëve dhe anëtarëve të trupit gjykues. Veçanërisht, në një rast korrupsioni të nivelit të lartë me shumë të pandehur, gjykimi i shkallës së parë përfundoi në më pak se një vit, sepse seancat dëgjimore ishin caktuar rregullisht, të paktën një herë në javë. Duke e pasur parasysh qasjen aktuale proaktive të gjyqtarëve në Departamentin e KOK për të caktuar seanca më të shpeshta, së bashku me gatishmërinë e tyre për të përshtatur praktika më efikase të menaxhimit të gjykimeve, Projekti rekomandon caktimin e seancave dëgjimore të përditshme, kur është e mundur, ose të paktën një seancë për javë.<sup>146</sup> Respektimi i të ashtuquajturit parim i përqendrimit të seancës kryesore në rastet e KOK mund të kontribuojë në ofrimin efikase të drejtësisë dhe rrjedhimisht ta rrisë besimin e publikut në sistemin gjyqësor.

Për më tepër, Projekti vërejti se ritmi dhe dinamika e seancave vareshin nga vëllimi i provave materiale dhe numri i dëshmitarëve të propozuar.

Të dyja palët ndonjëherë paraqitën prova të përsëritura materiale ose propozuan dëshmitarë të shumtë për të dëshmuar për të njëjtat rrethana. Megjithatë, rishqyrtimi dhe konsolidimi i listave të provave të të dyja palëve u vu re në rastet kur gjykimet po rifillonin ose në fillim të një rigjykimi; kjo praktikë duhet dhe mund të zbatohet që në fillim të çdo prove për të kursyer kohë dhe burime.<sup>147</sup>


Një tjetër praktikë e mirë e prezantuar nga gjyqtarët ishte delegimi i thirrjes së dëshmitarëve tek pala që i propozoi, në marrëveshje me palët. Ndonëse nuk parashikohej me ligj, kjo kontribuoi ndjeshëm në shmangien e vonesave për shkak të mungesës së dëshmitarëve.

Projekti vuri re se arsyeja më e shpeshtë për shtyrjen e seancave ishte mungesa e të pandehurit, kryesisht për shkak të problemeve shëndetësore. Praktika të mira u vunë re kur gjyqtarët e urdhëruan inspektimin e fletëve të pushimit mjekësor të lëshuar nga mjekët dhe paralajmëruan palët se ishin të detyruara që ta informonin gjykatën për mos disponueshmërinë e tyre për të marrë pjesë në seancë sapo të lindte arsyeja e mungesës së tyre. Në këtë mënyrë, gjykata do të mund t'i informonte palët e tjera dhe ta ricaktonte seancën në vend që ta shtynte atë, duke shmangur vonesat dhe shpenzimet e panevojshme.

<sup>146</sup> Baza ligjore për këtë është përcaktuar qartë në nenin 359 (1) të KPP-së (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18), i cili parasheh se shqyrtimi kryesor mbahet pa ndërprerje dhe nëse nuk është e mundur të kryhet shqyrtimi kryesor në një seancë të vetme, kryetari i trupit gjykues e shtyn seancën për ditën e ardhshme të punës

<sup>147</sup> Neni 358 (2) i KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18) e detyron kryetarin e trupit gjykues të eliminojë çdo gjë që mund të vonojë procedurën dhe nuk i shërben qëllim të sqarimit të çështjeve.

## Arsyet për shtyrje



Grafiku 27 - Arsyet për shtyrje

Projekti zbuloi vonesa të shkaktuara nga rifillimi i gjykimeve për shkak të një ndryshimi në përbërjen e trupit gjykes. Përkatësisht, mbrojtja e abuzoi/shfrytëzoi të drejtën e saj procedurale për ta kërkuar riprezantimin e të gjitha provave të paraqitura më parë.<sup>148</sup>

Draft-amendamentet aktuale të KPP-së do ta zgjidhin këtë çështje duke i lejuar anëtarët e rinj të panelit që të njihen me

dosjen e lëndës në vend që të përsërisin të gjithë procedurën nga fillimi.

Në të ardhmen, ndryshimet në KPP të cilat e caktojnë afatin për shqyrtimin e aktakuzës do t'i trajtonin çështjet e efikasitetit të shkaktuar nga procedurat e gjata për shqyrtimin e aktakuzave, e cila në 13 nga 50 lëndët e monitoruara zgjati më shumë se 90 ditë, në tre raste më shumë se 180 ditë dhe në një rast e arriti gati një vit.

<sup>148</sup> Sipas nenit 371 (2) të KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18), shqyrtimi kryesor fillon përsëri nëse gjyqtari individual ose përbërja i trupit gjykes ka ndryshuar. Me pëlqimin e palëve, trupi gjykes mund të vendosë që të mos merren sërish në pyetje disa dëshmitarë dhe ekspertë, por të lexohen deklaratat e tyre që janë regjistruar gjatë seancës së mëparshme kryesore.

**Gjyqësori duhet që t'i dyfishojë përpjekjet e tij për t'i proceduar dhe finalizuar në mënyrë efikase rastet e KOK të nivelit të lartë në fazën e apelit.**

i. Këshilli Gjyqësor duhet të sigurojë numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve dhe plotësimin me kohë të të gjitha pozitave të lira të ardhshme në Gjykatën e Apelit në Shkup.

ii. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit në Shkup duhet t'i zbatojnë në vazhdimësi dispozitat e KPP-së të cilat e rregullojnë mbajtjen e seancës ose prishjen e aktgjykimit dhe të vendosin sipas meritës, veçanërisht kur shkeljet janë çështje që mund të zgjidhen pa e urdhëruar rigjykimin.

iii. Kryetari i Gjykatës së Apelit në Shkup, në koordinim me shefin e Departamentit Penal në këtë gjykatë, duhet që ta lehtësojë diskutimin ndërmjet gjyqtarëve të shkallës së dytë dhe të shkallës së parë për sfidat me të cilat ballafaqohen të dyja shkallët, në rastet kur urdhërohet rigjykimi.

Për ta lehtësuar shqyrtimin e lëndëve të nivelit të lartë, Këshilli Gjyqësor duhet të sigurohet që vendet e zbrazëta në Gjykatën e Apelit në Shkup të plotësohen sa më shpejt që të jetë e mundur, sipas sistematizimit të brendshëm në gjykatë, veçanërisht duke pasur parasysh barrën aktuale. Zgjedhja e fundit e gjyqtarëve ka ndodhur në nëntor 2023, pasi një proces rekrutimi për katër gjyqtarë penalë (40% e totalit) u hap në korrik të vitit 2021.

Bazuar në vlerësimet e parashikueshme si pensionimet, ata duhet të përpiqen ta nisin procedurën e rekrutimit para se pozitat të mbeten vakante për ta parandaluar prolongimin e vendeve boshe.<sup>149</sup> Sipas gjetjeve të monitorimit të procedurave gjyqësore nga ana e Projektit, Gjykatës së Apelit në Shkup iu deshën mesatarisht 101 ditë nga pranimi i propozimit të Prokurorisë së Lartë Publike për ta caktuar një seancë publike.<sup>150</sup>

<sup>149</sup> Neni 105 i Kushtetutës; Neni 36 dhe 46 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 102/19).

<sup>150</sup> Të dhënat dalin nga vendimet e Gjykatës së Apelit Shkup që janë publikuar në ueb-faqen, në rastet e monitoruara në të cilat është mbajtur seanca publike.

Në pesë raste, kjo zgjati më shumë se 150 ditë. Mesatarisht, vendimi i shkallës së dytë është marrë 60 ditë pas mbajtjes së seancës publike. Megjithatë, në rastet e nivelit të lartë, vendimi i shkallës së dytë është marrë mesatarisht 101 ditë pas seancës publike, ku dy prej tyre kanë arritur më shumë se 210 ditë.


Aktualisht, 12 lëndë janë në shqyrtim apeli, nga të cilat pesë janë në rigjykim. Që nga fillimi i projektit, Gjykata e Apelit në Shkup ka nxjerrë vendime për 17 lëndë të monitoruara, 11 prej të cilave të nivelit të lartë. Në tre prej këtyre rasteve të nivelit të lartë është dhënë aktgjykim refuzues për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit si rezultat i ndryshimeve të KP dhe në tre të tjera Gjykata e Apelit i ka prishur vendimet e shkallës së parë në pjesët e

vendimeve për sanksionet penale.

Në pesë rastet tjerat, aktgjykimi i shkallës së parë u anulua dhe u urdhërua rigjykimi. Në shumicën e rasteve të dërguara për rigjykim, Gjykata e Apelit i'u referua vendimeve të paqarta dhe kontradiktore, apo aktgjykimeve që nuk i përmbanin arsyet për faktet apo provat vendimtare të paraqitura, si bazë për rigjykim.<sup>151</sup>

Është e rëndësishme të theksohet se rigjykimet kontribuojnë në vonimin e procedurave dhe mund të çojnë në skadimin e statutit të kufizimeve. Ato shoqërohen gjithashtu nga shumë probleme të tjera të mundshme, si krijimi i pasigurisë për të pandehurit, viktimat, madje edhe dëshmitarët, cenimi i së drejtës për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme dhe i rregullit kundër rrezikut të dyfishtë.

### Kohëzgjatja mesatare e procedurës deri në vendimin përfundimtar dhe detyruës



**Grafiku 28** - Kohëzgjatja mesatare e procedurës deri në vendimin përfundimtar dhe detyruës

Prandaj, Projekti rekomandon që Gjykata e Apelit t'i shmangë interpretimet e ngushta të dispozitave

që i lejojnë asaj të zhvillojë seanca dhe të marrë vendime sipas meritës. Në vend të kësaj, ata duhet t'i përdorin

<sup>151</sup> Neni 415 (1) pika 11 KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18).

plotësisht këto dispozita në përputhje me ligjin.<sup>152</sup> Veçanërisht, që nga fillimi i projektit, nuk është mbajtur asnjë seancë dëgjimore për asnjë nga rastet e monitoruara në fazën e ankesës

Rrjedhimisht, Kryetari i Gjykatës së Apelit, në dakordim me Shefin e Departamentit Penal në këtë gjykatë – në kuadër të kompetencave të tyre – duhet t'i lehtësojë diskutimet ndërmjet

gjyqtarëve për tu siguruar që çështjet e nivelit të lartë të procedohen brenda një afati të arsyeshëm dhe të marrin vendimin përfundimtar sa më shpejt të jetë e mundur.

Ndryshimet e ardhshme të KPP-së e parashohin një afat për caktimin e seancës publike. Kjo do të kontribuojë ndjeshëm në përshejtimin e procedurave në shkallë të dytë.

7

## Rekomandim

### **Shfrytëzimi i proceseve të vendimmarrjes të bazuar në të dhëna për ta siguruar shpërndarjen efikase të burimeve për trajtimin e rasteve të KOK:**

i. Kryetari(ët) e gjykatës dhe shefat e Prokurorive Publike duhet t'i përdorin në mënyrë proaktive raportet zyrtare vjetore të institucioneve për të bërë vlerësime të vazhdueshme të nevojave dhe të avokojnë për burime shtesë bazuar në të dhënat e përfshira në to.

ii. Kryetari(ët) e gjykatës dhe Këshilli Gjyqësor duhet t'i lehtësojnë transferimet e përkohshme të gjyqtarëve sipas nevojave specifike të gjykatave apo departamenteve të caktuara dhe ta diskutojnë mundësinë e emërimit të gjyqtarëve të veçantë të cilët do të vendosin vetëm në fazën e shqyrtimit të aktakuzës.

iii. Këshilli i Prokurorëve Publik duhet t'i plotësojë rregullisht pozitat e zbrazëta në Prokurorinë Themelore Publike për KOK.

iv. Pushteti ekzekutiv duhet ta respektojë ndarjen e parashikuar buxhetore për gjyqësorin dhe ta mundësojë punësimin e stafit administrativ shtesë për ta mbështetur punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

<sup>152</sup> Neni 424 (1) i KPP (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 150/10, 100/12, 142/16 dhe 198/18).



Bazuar në monitorimin e gjykimeve nga ana e Projektit, dhe në konsultimet si me gjyqtarët ashtu edhe me prokurorët publikë, burimet njerëzore në gjykata dhe në KOK të ZPPTH-së mungojnë seriozisht.

Edhe pse numri i përgjithshëm i gjyqtarëve i ndjek standardet evropiane,<sup>153</sup> barra e punës në Departamentin e KOK-së në GJTHP në Shkup tregon se numri i lëndëve në këtë departament në krahasim me numrin e lëndëve të përpunuara çdo vit është joproportional. Kjo u konfirmua gjatë konsultimeve me gjyqtarët, të cilët thanë se numri i lëndëve të përfunduara prej tyre ishte më shumë se dyfishi i numrit orientues të parashikuar të lëndëve. Projekti vërejti se gjyqtarët nga departamentet e tjera të GJTHP-së në Shkup me më pak barrë pune caktoheshin herë pas here si gjyqtarë të dytë profesionistë në panelet e lëndëve të KOK të nivelit të lartë. Projekti e vlerëson këtë praktikë, pasi riorganizimi sistematik dhe i bazuar në të dhëna të gjyqtarëve do të mundësonte gjykime më efikase. Një zgjidhje e mundshme për përmirësimin e efikasitetit përmes rishpërndarjes së burimeve mund të jetë emërimi i gjyqtarëve të veçantë për të vendosur vetëm në fazën e shqyrtimit të aktakuzës, së bashku me një sistem adekuat vlerësimi për vlerësimin e tyre në përputhje me rrethanat.

Kjo do të fuqizonte këtë fazë të rëndësishme të procedurës penale, e cila aktualisht nuk është mjaft funksionale, siç e pranojnë edhe gjyqtarët, por edhe Këshilli Gjyqësor. Që kjo të arrihet, Këshilli Gjyqësor, në koordinim me kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët penalë nga të gjitha instancat, do të mund ta bënte një analizë për zbulimin e dobësive të fazës së shqyrtimit të aktakuzës. Rezultatet nga një analizë e tillë duhet që ta ofrojnë një zgjidhje praktike për çështjet e procedurës penale të shkaktuara nga vonesat dhe vendimet jocilësore në fazën e shqyrtimit të aktakuzës.

Në fund të fundit, Këshilli Gjyqësor duhet që ta mbështesë transferimin e përkohshëm të nevojshëm të gjyqtarëve nga gjykatat më pak të ngarkuara tek ato me ngarkesë më të madhe pune, duke analizuar në të njëjtën kohë arsyet e ngecjes së lëndëve. Më pas, bazuar në këtë analizë, ajo duhet ta ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme sistematike. Vlen të përmendet se kjo çështje është përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Burimet Njerëzore në Rrjetin e Gjyqësorit.<sup>154</sup> Në mënyrë të ngjashme, Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin Prokurorial vëren se rrjeti aktual i prokurorive publike duhet të ridizajnohet sipas vlerësimit dhe kriterëve të matshme, si dhe në përputhje me ridizajnimin e rrjetit gjyqësor.<sup>155</sup>

<sup>153</sup> Shihni Raportin e Vlerësimit të CEPEJ për sistemet gjyqësore evropiane 2022 Cikli i vlerësimit (të dhënat e 2020):1680a86279 (coe.int)

<sup>154</sup> [Konecen+narativen+del+Strategjia+za+covecki+resursi+sud+mreza+za+objava+3.pdf \(vsrm.mk\)](#)

<sup>155</sup> [strategjia-na-chovecki-resursi-za-javnoobvinitelskata-mrezha-.pdf \(jorm.gov.mk\)](#)

Sipas Raportit Vjetor të Prokurorisë Publike të Shtetit, numri i përgjithshëm i prokurorëve në KOP të ZPPTH -së gjatë vitit 2022 ishte 11 nga 18 që ishin paraparë me sistematizim, ndërsa një e treta e pozitive të parapara në mbarë vendin nuk janë plotësuar.<sup>156</sup> Në korrik të vitit 2023, Këshilli i Prokurorëve Publikë nxori një vendim për përcaktimin e numrit të prokurorëve në të gjitha prokuroritë publike, me të cilin përsëri u caktua numri i prokurorëve në KOK të PPTH-së në 18. Prokurorët në KOK të PPTH zgjidhen me mandat prej katër vjet, dhe vonesat në zgjedhjen apo rizgjedhjen e tyre kanë ndikim në procedimin e rasteve të KOK, veçanërisht duke qenë se hetimet në këto raste janë komplekse dhe gjykimet janë të gjata. Në shumë raste, Projekti vërejtë se seancat shtyeshin ose ricaktoheshin për shkak se mandati i prokurorit drejtues kishte skaduar dhe procedura për zgjedhje nuk ishte përfunduar në kohë.

Prokuroria Publike e Shtetit dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet ta vendosin një praktikë të rivlerësimit të vazhdueshëm të numrit të prokurorëve në bazë të vlerësimit të nevojave të barrës së punës së të gjitha prokurorive publike. Kjo do të fuqizonte ndjekjen penale efektive të rasteve të KOK dhe do ta përshpejtonte ritmin e gjykimeve, veçanërisht pasi Projekti ka vërejtur vazhdimisht vështirësi në caktimin e seancave për shkak të angazhimeve kontradiktore midis prokurorëve

përgjegjës të rastit. Gjatë konsultimeve të Projektit, gjyqtarët dhe prokurorët iu referuan nevojës për staf administrativ shtesë si parakusht për përfundimin me sukses dhe me kohë të rasteve. Kjo çështje është ngritur në Raportin Vjetor për Punën e Gjykatave për vitin 2022 të Këshillit Gjyqësor<sup>157</sup> dhe në Raportin vjetor të lartpërmendur të Prokurorisë së Shtetit për vitin 2022.

Megjithatë, këto raporte nuk përmbajnë analiza specifike të pasojave aktuale të numrit të stafit të pamjaftueshëm për punën e institucioneve. Gjithashtu, nevoja për burime njerëzore shtesë në sektorin e drejtësisë u theksua në Strategjinë Kombëtare për Reformën e Sektorit Gjyqësor për periudhën 2017-2022.<sup>158</sup> Sipas Strategjisë së sapo miratuar për Zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë 2024–2028,<sup>159</sup> një nga arsyet kryesore për realizimin jo të plotë të Strategjisë së mëparshme ishte mungesa e mbështetjes financiare për masat që lidhen me burimet njerëzore në sistemin gjyqësor dhe me modernizimin e saj. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk u respektua ndarja minimale prej 0.8% e PBV-së për pushtetin gjyqësor, e që në fakt ishte diku ndërmjet 0.26% dhe 0.3%. Në mënyrë të ngjashme, Prokuroria Publike e Shtetit raportoi se buxheti i miratuar në vitin 2022 ishte gjysma e 0.4 % të parashikuar nga Buxheti i Shtetit.

Në anën tjetër duhet theksuar se për qëllime të ofrimit të zgjidhjeve afatgjata

<sup>156</sup> [izveshtaj-za-rabotata-na-javnite-obvinitelsta 2022 2 mail-2-3.pdf \(jorm.gov.mk\)](#)

<sup>157</sup> [Годишен+извештај+за+работата+на+судовите+во+2022+година.pdf \(sud.mk\)](#)

<sup>158</sup> [16808c4384 \(coe.int\)](#)

<sup>159</sup> [Предлог Развојна Секторска Стратегија за Правосудство 2024 - 2027.pdf \(pravda.gov.mk\)](#)

të bazuara në të dhëna të besueshme, siç rekomandohet këtu, duhet që të

fuqizohen departamentet e analitikës në institucionet gjyqësore.

## Kapaciteti

8

### Rekomandim

**Fuqizimi i kapaciteteve të prokurorëve publikë për të përgatitur aktakuza dhe për ta përmirësuar performancën e tyre në gjykatë:**

i. Prokuroria Publike e Shtetit duhet ta sigurojë miratimin dhe zbatimin efektiv të udhëzimeve për shkrimin e aktakuzave që aktualisht janë në fazën e miratimit.

ii. Shefi i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit duhet që:

- Ta rris frekuencën e takimeve ndërmjet prokurorëve publikë për të trajtuar tema me rëndësi për cilësinë e punës së tyre, duke përfshirë performancën në gjykatë.
- Të krijojë mekanizma të brendshëm për t'i përmirësuar aktakuzat në rastet e nivelit të lartë të KOK që janë me interes publik përpara përfundimit të tyre.
- Të sigurohet që vlerësimi i cilësisë së aktakuzave si një tregues cilësor në vlerësimin e performancës së prokurorëve të kryhet siç duhet dhe të siguroj reagime konstruktive.

iii. Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë duhet që t'i vlerësojë nevojat për trajnim të prokurorëve që merren me rastet e KOK dhe ta rishikojë kurrikulën në përputhje me rrethanat për performancën në gjykatë.

Analiza gjithëpërfshirëse e projektit e akteve gjyqësore të disponueshme, duke e ndjekur Metodologjinë e Projektit, nxori në pah aktakuza me cilësi të dobët, të cilat gjyqtarët dhe prokurorët publikë i pranuan gjatë forumeve të diskutimit të Projektit.

Çështjet më të shpeshta të zbuluara ishin mungesa e qartësisë,

përcaktimet e paqarta të rolit dhe përgjegjësisë penale të të pandehurve, mospërputhja e përshkrimit faktik të krimin me dispozitat përkatëse, arsyetimi i dobët mbi elementet e krimin dhe provat mbështetëse të papërpunuara mjaftueshëm të cilat nuk i pasqyronte qartë veprimet dhe fajin e secilit të pandehur.

Në Vlerësimin e Rrezikut të Korrupsionit në Sistemin Gjyqësor të vitit 2023 nga ana e OSBE-së, gjyqtarët e identifikuan cilësinë e dobët të aktakuzave si një rrezik të konsiderueshëm korrupsioni.<sup>160</sup> Kjo e nënvizon faktin se boshllëqet në cilësinë e akteve gjyqësore mund të mos vijnë gjithmonë nga problemet thjesht të kapaciteteve dhe mund të paraqesin shenja të ndërhyrjes.

Projekti konsideron se udhëzimet do t'i ndihmonin prokurorët që të prodhonin aktakuza të qarta, gjithëpërfshirëse dhe bindëse. Misioni i OSBE-së në Shkup, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë Publike Shtetërore, e ka mbështetur një grup pune për hartimin e udhëzimeve që, ndër të tjera, do ta përfshinte një përmbledhje të udhëzimeve praktike me shabllone që do t'i ndihmonin prokurorët në përmirësimin e aftësive të tyre të shkrimit. Kur të miratohen dhe nxirren përfundimisht, udhëzimet dhe shabllonet mund të zgjerohen në të ardhmen për t'i mbështetur përpjekjet për krijimin e një depozite të praktikave të mira në kohën e duhur.

Përveç kësaj, takimet e brendshme ndërmjet prokurorëve gjatë të cilave ata mund të trajtonin tema të rëndësishme në lidhje me cilësinë e punës së tyre do të ndihmonin gjithashtu në promovimin e një kulture të vetë-reflektimit dhe të të mësuarit. Gjatë këtyre takimeve, shefi duhet që ta inkurajojë një shkëmbim të hapur dhe autokritik të përvojës dhe

diskutimeve profesionale për ta përmirësuar punën dhe imazhin e përgjithshëm të prokurorisë.

Në këtë drejtim, shefat e Prokurorive Publike mund t'i përdorin kompetencat e tyre menaxheriale për ta rishikuar punën e prokurorëve dhe për të ofruar mbështetje shtesë nëse është e nevojshme. Ky shqyrtim mund të bëhet që në fazën e hetimit dhe gjatë përgatitjes së aktakuzës. Pavarësisht, rishikimi duhet që ta sigurojë një ekuilibër të duhur midis autonomisë së një prokurori individual dhe fuqisë së një mbikëqyrësi për tëa vlerësuar kryerjen e detyrës së tyre. Mekanizmi duhet të mbështetet në një grup specifik udhëzimesh të cilat e përcaktojnë saktësisht procesin e kontrollit të cilësisë për hartimin e aktakuzave. Ky rishikim do ta lehtësonte edhe procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve për mbikëqyrësit, pasi cilësia e aktakuzave dhe e vendimeve të tjera me shkrim është një nga parametrat më të rëndësishëm që cmohet në vlerësim.

Projekti gjithashtu ka vërejtur shqetësime në lidhje me performancën e prokurorëve në gjykatë. Prokurorët shpesh nuk ishin të suksesshëm në sqarimin se si disa prova kontribuuan në vërtetimin e akuzave. Një nga çështjet më të spikatura në këtë drejtim ishte paraqitja e provave materiale nga prokuroria, të cilat shpesh dukeshin të tepërta, të gjata dhe konfuze për publikun.

<sup>160</sup> 545929\_0.pdf (osce.org).

Kjo mund ta demonstroj mungesën e një strategjie të qartë të rastit prokurorial dhe ta dëmtojë teorinë e tyre të çështjes.

Përmirësimi i paraqitjes së provave dokumentare do të rezultonte në gjykime më efikase dhe efektive. Kështu, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë duhet që ta bëjë vlerësimin e nevojave për trajnim, ta

rivlerësojë dhe përshtas kurrikulën dhe të fokusohet në anën praktike të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve për prokurorët.

Ajo gjithashtu mund të përgatisë një anketë mbi nevojat për trajnim të prokurorëve publikë që merren me rastet e KOK dhe ta rregullojë kurrikulën në përputhje me rrethanat.

9

## Rekomandim

**Përmirësimi i kapaciteteve të gjyqtarëve të të gjitha instancave në hartimin e vendimeve dhe aktgjykimeve ligjore, veçanërisht në drejtim të arritjes së arsyetimit ligjor më të qartë dhe më gjithëpërfshirës.**

i. Kryetari i Gjykatës Supreme dhe kryetarët e gjykatave të apelit duhet që ta trajtojnë çështjen se si të përmirësohet cilësia e vendimeve dhe aktgjykimeve gjatë takimeve të punës.

ii. Gjykata Supreme duhet të përpiloj përmbledhje të shembujve të mirë të vendimeve dhe gjykimeve nga gjykatat e të gjitha instancave.

iii. Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë duhet të sigurohet që trajnimi i vazhdueshëm do ta pasqyroj në mënyrë adekuate nevojën për t'i përmirësuar aftësitë e shkrimit ligjor për gjyqtarët e të gjitha instancave që punojnë në rastet e KOK.

Bazuar në analizën e vazhdueshme të vendimeve gjyqësore në dispozicion, Projekti vuri në dukje se ato ishin të përsëritura, të panevojshme të gjata dhe të vështira për t'u kuptuar, veçanërisht vendimet e shkallës së parë. Përpos të qenit të paqarta, aktgjykimet shpesh shpjegojnë prova që

përmbanin fakte të parëndësishme, ndërsa në të njëjtën kohë japin shpjegime shumë të përgjithshme për rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Përveç kësaj, analiza tregoi se disa aktgjykime nuk ia dolën t'i identifikonin dhe vërtetonin qartë, saktë dhe plotësisht të gjitha çështjet faktike, apo

t'i adresonin në mënyrë adekuate të gjitha çështjet e ngritura ligjore dhe procedurale. Në disa raste, gjykata nuk ka dhënë shpjegim të mjaftueshëm për disa prova kontradiktore, ose nuk ka përshkruar pse disa prova nuk janë shqyrtuar në mënyrë specifike. Kjo shpesh ka shërbyer si bazë për anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe urdhërimin e rigjykimit, duke kontribuar në zvarritjen e procedurave.

Gjatë konsultimeve të Projektit, gjyqtarët u pajtuan plotësisht me nevojën për ta përmirësuar mënyrën e shkrimit të vendimeve, por theksuan se në disa raste kishte pasur përpjekje për të hartuar vendime më të shkurtra dhe më të qarta. Disa nga këto vendime nga ana e tyre ishin shfuqizuar më vonë nga gjykatat më të larta për shkak të pretendimit të arsyetimit të pamjaftueshëm ligjor.

Duke i dhënë përparësi përmirësimit të vendimeve dhe gjykimeve gjatë takimeve të punës ndërmjet Gjykatës së Lartë dhe gjykatave të apelit, dhe bazuar në konkluzionet e nxjerra nga këto takime, gjyqtarët e shkallës së parë do të merrnin instruksione të vlefshme nga gjykatat më të larta.

Kjo do t'u mundësonte atyre ta trajtojnë çështjen në një mënyrë më sistematike. Nga ana tjetër, pas nxjerrjes së përmbledhjeve të shembujve të mirë të vendimeve dhe të gjykimeve nga gjykatat e të gjitha instancave, gjyqtarët do të jenë në gjendje t'i përmirësonin aftësitë e tyre të shkruarit dhe t'i përshtatin praktikat e reja.

Përfundimisht, Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë duhet ta marrë një qasje më proaktive për ta adresuar nevojën për trajnim të vazhdueshëm të gjyqtarëve të përfshirë në rastet e KOK.

Ky trajnim duhet të synojë që ta përmirësojë cilësinë e përgjithshme të vendimeve të tyre. Gjithashtu, Akademia duhet ta sigurojë pjesëmarrjen e gjyqtarëve të të gjitha instancave.

Duke u ofruar atyre një mundësi për diskutime vetëkritike dhe duke avokuar për një ndryshim nga vendimet ekzistuese të gjata dhe të përsëritura, Akademia mund të kontribuojë në nxitjen e standardeve të reja dhe në përmirësimin e vendimeve.

**Racionalizimi i procesit të mbajtjes së procesverbaleve në seancat e gjykatave të shkallës së parë duke e përmirësuar cilësinë e regjistrimeve në sallën e gjyqit dhe duke siguruar trajnime të vazhdueshme për nëpunësit e gjykatës:**

i. Qendra për TIK në Gjykatën Supreme dhe Këshilli për TIK në sistemin gjyqësor duhet të punojnë së bashku në rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së sistemeve të regjistrimit audio dhe video në sallën e gjyqit.

ii. Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë duhet të organizojë trajnime të vazhdueshme për nëpunësit e gjykatës lidhur me mbajtjen e procesverbaleve në mënyrë efektive, rëndësinë e mbajtjes së saktë të shënimeve dhe lidhur me mënyrën më të mirë për ta lehtësuar rrjedhën e informacionit gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve.

Në të gjitha rastet e monitoruara, gjyqtarët i urdhëruan nëpunësit e gjykatës që të mbanin procesverbale të daktilografuara në kompjuter, shpesh përveç regjistrimit audio ose video-audio regjistrimit të gjykimit.<sup>161</sup>

Në dukje një çështje teknike, kjo praktikë shpesh rezulton në ndryshimin e përmbajtjes së dëshmisë dhe shkaktimin e pasaktësive në procesverbal. Kjo nuk është vetëm një çështje kapaciteti; ajo gjithashtu e rrezikon integritetin e procesit duke qenë se shpesh shkakton vështirësi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve duke prishur rrjedhën e natyrshme të informacionit. Për të kapërcyer këtë pengesë, Qendra për TIK në Gjykatën Supreme dhe Këshilli për TIK në

sistemin gjyqësor duhet që ta sigurojnë funksionimin e duhur të sistemeve të regjistrimit në të gjitha sallat e gjyqit dhe disponueshmërinë e regjistrimeve me cilësi të lartë dhe të përshtatshme për përdoruesit. Opsioni teknikisht i mundshëm i konvertimit të audios në tekst të shkruar do të ishte një tjetër zgjidhje e shkëlqyer në këtë drejtim.

Në ndërkohë, trajnimi i detyrueshëm dhe i vazhdueshëm i nëpunësve të gjykatës do t'i fuqizonte standardet e tyre profesionale dhe do të siguronte saktësi më të madhe procesverbaleve të shkruara të përdorura nga gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës, veçanërisht ata që punojnë vetëm në Departamentin e KOK-së në GJTHP në Shkup.

<sup>161</sup> Edhe pse KPP parashikon regjistrimin audio ose audio-vizual të gjykimit, funksionimi i duhur i pajisjeve është i diskutueshëm dhe gjyqtarët mbështeten në procesverbalet me shkrim, veçanërisht kur përgatitin vendime me shkrim.



**Këshilli Gjyqësor dhe Prokurori Publik i Shtetit në koordinim të ngushtë me Këshillin për Prokurorë Publikë duhet ta rrisin cilësinë e proceseve të vlerësimit të performancës, duke:**

- i. Rishikuar vazhdimisht metodat e përdorura për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
- ii. I mbledhur komentet nga gjyqtarët dhe prokurorët mbi opinionet e tyre për proceset e vlerësimit.

Në dhjetor 2020, pas miratimit të Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor dhe të Ligjit për Prokurorinë Publike, Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria Publike e Shtetit i miratuan aktet e tyre të brendshme përkatëse për vlerësimin e performancës së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, duke përfshirë kriteret e cilësisë së detajuar dhe kriteret sasiore.<sup>162</sup>

Edhe pse rezultatet e vlerësimit të rregullt katërvjeçar bazuar në aktet e brendshme dhe/ose metodologjitë e reja të hartuara nuk janë ende të disponueshme, disa gjyqtarë dhe prokurorë publikë tashmë janë vlerësuar në bazë të metodologjive të reja si pjesë e vlerësimit të jashtëzakonshëm të paraparë për avancim. Megjithatë, indikacionet e para

nga vlerësimet e jashtëzakonshme nuk kanë qenë inkurajuese; në bazë të konsultimeve me disa gjyqtarë dhe prokurorë publikë, vlerësimet janë bërë kryesisht pa ndonjë vlerësim objektiv të kriterëve cilësore. Kjo nga ana tjetër ka bërë që gjyqtarët dhe prokurorët publikë të vlerësohen duke marrë pikët më të larta të mundshme. Kjo është alarmante, pasi tregon se edhe me kriteret formale sasiore dhe cilësore tashmë të krijuara, vlerësuesve duket se u mungon një kulturë e profesionalizmit. Projekti rekomandon që Këshilli Gjyqësor dhe Prokurori Publik i Shtetit, në koordinim të ngushtë me Këshillin e Prokurorëve Publikë duhet të bëjnë një rishikim të vazhdueshëm të metodave për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe t'i mbledhin komentet e tyre për

<sup>162</sup> Sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 102/19) dhe Ligjit për Prokurorinë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/20), vlerësimi i performancës së të dyjave gjyqtarët dhe prokurorët bazohet në shumën e rezultateve nga kriteret cilësore (60 për qind e notës) dhe kriteret sasiore (40 për qind e notës).



këtë çështje. Një zgjidhje e mundshme për vetëvlerësimin objektiv të Këshillave, si të procesit ashtu edhe të metodave të vlerësimit do të ishte kryerja e një ankete anonime me gjyqtarët dhe prokurorëvt publikë lidhur me kënaqësinë e tyre me procedurat e vlerësimit, duke përfshirë edhe vlerësuesit. Rezultatet nga një sondazh i tillë do t'u mundësonin Këshillave të

marrin informacion më të gjerë dhe më të përshtatshëm, në vend që të mbështeten vetëm në kundërshtimet individuale të ngritura në proceset e vlerësimit.

Duke i përcaktuar dobësitë dhe mangësitë në rregullore dhe zbatimin e tyre në praktikë, Këshillat do të mund të bënin rekrutime dhe avancime objektive dhe të bazuara në merita.

## Përdorimi i Mjeteve Gjyqësore

12

### Rekomandim

#### **Ndërmerrja e veprimeve të menjëhershme brenda kornizës ligjore ekzistues për të rritur shkallën e konfiskimit:**

i. Prokurorët publikë duhet të urdhërojnë rregullisht hetime financiare dhe të kërkojnë sekuestrim të përkohshëm të aseteve, për ta siguruar konfiskimin efektiv, në të gjitha rastet në të cilat është nxjerrë një përfitim i paligjshëm pasuror dhe/ose ka ndodhur ndonjë dëm financiar në Buxhetin e Shtetit.

ii. Gjyqtarët duhet të sigurohen që pjesa ekzekutive e aktgjykimeve e krijojnë një lidhje adekuate ndërmjet masës së konfiskimit dhe vetë dënimit; në veçanti, ato duhet që ta ofrojnë një përshkrim të qartë dhe të detajuar të aseteve që duhet të konfiskohen.

iii. Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë duhet ta përfshijë vazhdimisht trajnimin për hetimet financiare dhe konfiskimin në plan programin e tyre dhe t'i prezantojë rezultatet e arritura në mënyrë të matshme.

iv. Ministria e Drejtësisë, Gjykata Supreme dhe Prokuroria Publike e Shtetit duhet ta bashkërendojnë në mënyrë proaktive ndërveprimin ndërmjet institucioneve kompetente, për qëllime të konfiskimit.

v. Pushteti ekzekutiv duhet:

- Ta bëjë lehtësimin e takimeve të rregullta ndërmjet të gjitha palëve relevante të përfshira në konfiskim, veçanërisht gjykatave, prokurorive publike, Agjencisë për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara, Agjencisë për Kadastrën e Pasurive të Paluajtshme dhe Avokatit të Shtetit.
- Ta bëjë alokimin e burimeve për punësimin e stafit të ekspertëve që do të punonin përkrah prokurorëve në hetimet financiare.
- Ta sigurojë funksionimin e duhur të bazës së të dhënave dhe të sistemit elektronik të përdorur nga Agjencia për menaxhimin e aseteve të konfiskuara, dhe t'i mbështesë përditësimet e nevojshme.
- Ta vlerësojë kapacitetin e Qendrës Kombëtare të Bashkërendimit për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe të bëjë propozime për përmirësime të mundshme.


Që nga fillimi i projektit, sekuestrimi i kufizuar i pasurisë ka mbetur shqetësues, veçanërisht pasi procedimi i rasteve të korrupsionit nuk mund të konsiderohet efektiv pa konfiskimin e fitimeve të pronës së fituar në mënyrë të paligjshme dhe/ose pa kompensimin e dëmit financiar në Buxhetin e Shtetit.

Projekti vuri re një numër shumë të ulët të propozimeve për konfiskim dhe pak ose aspak indikacione se ishte bërë një

hetim financiar. Prokuroria propozoi konfiskimin në vetëm shtatë aktakuza nga 34 rastet e monitoruara nga ana e Projektit në të cilat është nxjerrë përfitim pasuror i kundërligjshëm me veprën(at) e (të supozuara) penale.

Në pesë nga këto raste, prokuroria e propozoi këtë masë në aktakuzën e ndryshuar dhe/ose në fjalën përfundimtare.

## Skema e konfiskimit



Grafiku 29 - Skema e konfiskimit

Projekti ka vërejtur paqartësi në përcaktimin e sasisë së saktë të dëmit aktual (zakonisht kur preket buxheti i shtetit) të shkaktuar nga autorët. Gjithashtu, ekzistojnë pengesa ligjore në zbatimin e masave të konfiskimit për të realizuar kompensimin adekuat të dëmit.

Të gjitha sa u thanë më lartë e tregojnë mungesën e hetimeve efektive financiare për ta siguruar sekuestrin e përkohshëm të aseteve dhe konfiskimin si pasojë të përfitimeve të paligjshme pas vendimit përfundimtar. Gjatë konsultimeve u konstatua se prokurorët nuk i kanë shfrytëzuar siç duhet dispozitat ligjore përkatëse të KP dhe KPP.

Kjo më tutje plotësohet edhe nga mungesa e stafit ekspert të aftë për ta mbështetur punën e prokurorëve në këtë fazë të procedurës.

Kjo gjendje i ngarkon gjyqtarët me një barrë shtesë gjatë hartimit të

vendimeve dhe vendosjes së një lidhjeje të qartë ndërmjet produkteve të veprës penale dhe kallëzimeve penale. Më konkretisht, në rastet me shumë të pandehur, gjyqtarët i theksuan vështirësitë në përcaktimin e vlerës së saktë të aseteve që duhet të konfiskohen për shkak të përshkrimeve të dobëta në aktakuza. Prandaj, hetimet financiare dhe konfiskimi duhet të mbeten një nga prioritetet kryesore të kurrikulës për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

Disa çështje do të zgjidhen me ndryshimet e propozuara të KPP-së. Për shembull, ato e parashikojnë propozimin për konfiskim si element të detyrueshëm të aktakuzës në rastet kur është fituar dobi pasurore e kundërligjshme. Në mënyrë të ngjashme, ndryshimet e kërkojnë një përshkrim të hollësishëm të pronës së konfiskuar në një vendim dënues. Për më tepër, ato ofrojnë udhëzime të sakta për sekuestrin e përkohshëm të

të pasurisë për qëllime të konfiskimit. Ndërkohë, Projekti e konsideron të mjaftueshme kornizën ligjore përkatëse për të siguruar sekuestrim efektiv të aseteve. Megjithatë, kjo do të kërkojë një angazhim më të madh për gjurmimin e pasurive të paligjshme nga prokurorët dhe duhet t'i jepet pesha e duhur komponentit financiar të hetimit. Megjithatë, një pengesë tjetër në këtë drejtim del të jetë fakti se prokurorët publik rrallëherë i marrin të dhënat e nevojshme në kohën e duhur. Në të vërtetë, në këtë drejtim, ata shpesh detyrohen t'i përdorin lidhjet personale në institucionet tjera ose kanale të tjera jo formale komunikimi në vend që të mbështeten në korrespondencën zyrtare.

Për më tepër, roli i Ministrisë së Drejtësisë, i Gjykatës Supreme dhe i Prokurorisë Publike të Shtetit është thelbësor në lehtësimin e ndërveprimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në procedurën e konfiskimit. Krijimi i një modeli për ndërveprim ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në sektorin gjyqësor është parashikuar tashmë si një aktivitet në Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë 2024–2028 të miratuar së fundmi. Në ndërkohë, vështirësitë e lartpërmendura në shkëmbimin e të dhënave mund të zgjidhen duke organizuar takime mujore ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve kompetente, veçanërisht

gjykatave, prokurorive publike, Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Agjencisë së Kadastrit të Patundshmërive.

Një organ tjetër që do të ishte i dobishëm për shkëmbimin e të dhënave dhe bashkëpunimin ndërinstucional është Qendra Kombëtare Koordinuese për Luftën kundër Krimin të Organizuar pranë Ministrisë së Brendshme. Duke i përmirësuar aftësitë e tij dhe duke e lehtësuar shkëmbimin e informacionit në kohë reale, të gjithë aktorët përkatës do të pajisen më mirë për ta thjeshtuar procesin e mbledhjes së të dhënave në lidhje me flukset e mundshme të paligjshme financiare. Kjo do të sigurote që aktivitete të tilla të adresoheshin menjëherë dhe në mënyrë efektive.

Për më tepër, gjurmimi i pasurisë së paligjshme në baza të përhershme, gjatë gjithë procedurës penale dhe pas vendimit përfundimtar, është vendimtar për konfiskimin efektiv.

Një bazë e duhur e të dhënave dhe një sistem elektronik në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara që do të ishte në gjendje ta sinjalizonte çdo ndryshim të mundshëm në asetet në pronësi të individit(ve) që i nënshtrohen konfiskimit do ta mundësonte konfiskimin e shpejtë dhe të suksesshëm të pasurisë.



**REGIONAL TRIAL MONITORING PROJECT**  
COMBATTING ORGANIZED CRIME AND CORRUPTION  
IN THE WESTERN BALKANS



**osce** Organization for Security and  
Co-operation in Europe



Funded by  
the European Union